

Maj 2019
Numri: 134
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Agjërimi i zemrës





revistaetika



progresibotime

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*



Maj 2019

VITI: XIII

NUMRI: 134

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Aradian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Jemi në ditët kur përsëri kemi vënë zemrat tona në rend të ditës dhe i marrim në pëllëmbë të dorës.

Në fakt, zemrat duhet t'i kemi gjithmonë në rend të ditës dhe në pëllëmbë të dorës. Çdo gjë duhet vlerësuar me agjendën e zemrës dhe duhet të kemi një dert të shenjtë, siç është përpunimi i zemrës, mbujta dhe mbajtja gjallë e saj.

"Bëni kujdes! Zemrat qetësohen dhe kënaqen vetëm duke përmendur Allahun."

Kjo është një shprehje Kuranore. Të mbuash zemrën me vetëdijen e të qenit bashkë me Allahun, duke mos e harruar Atë dhe duke vendosur marrëdhënien me Allahun në shpirtin e çdo pune...

Nëse në udhëtimin e namazit nuk na shoqëron shqetësimi për **"të dalë të pastër"**, atëherë nuk është e mundur të shkulum dhe të flakim tutje "paturpësitë dhe të këqijat", prej të cilave Allahu thotë se na ruan namazi. Atëherë, ai namaz s' do të kishte dobi, sepse do të ishte i zbratur. Por, nëse e dimë se do të dalim në një instancë të lartë, atje nuk duhet të gënjejmë, sepse Ai di gjithçka në zemra. Këto ditë do të arrijmë agjërimin, në sajë të të cilit njeriu përjeton një detoks shpirtëror, duke i kufizuar trupit nevojat më të natyrshme me kriteret e vendosura nga Allahu. Detoks, është pastrim i zemrës prej papastërtive të akumuluar dhe barrëve që ajo s' mund t'i mbajë.

Në të vërtetë, agjërimi është për zemrën, dhe, nëse ajo nuk agjëron, nuk agjërojnë as sytë, as veshët dhe as gjuhët, gjë që lind rrezikun e shndërrimit të agjërimin thjesht në një uri padobi, të cilën i Dërguari i Allahut e ka paralajmëruar që në fillim.

Agjërimi erdhi e iku, dhe nuk ndikoi fare tek ne, nuk na përmirësoi dhe nuk na i fashoi plagët... Ne mbetëm në gjendjen tonë të plogësht, ndërkohë që goja jonë ka agjëruar, e zemra jonë ka ngrënë vazhdimisht... Ku është agjërimi?! Nëse zemra agjëron, agjërimi na merr e na çon në Xhenet. Prandaj kemi nevojë për agjërim që na nxjerrin në udhëtimin drejt Xhenetit. Për këtë arsye, në çdo kohë iftari, duhet t'i marrim zemrat tonë në dorë dhe të shohim çfarë ka e nuk ka aty. Natën e Kadrit, në mëngjesin e saj dhe të Bajramit, duhet të arrijmë të kemi zemra të gjalla dhe të pastra, aq sa të mund t'ia ofrojmë Allahut. Zekati është kalibrimi që i bëhet besimtarit në çështjen e dashurisë ndaj pasurisë. *"Edhe pasuria, edhe jeta janë dhunti të Allahut. Mos e harro këtë! Prandaj, edhe kur ta fitosh, edhe kur ta shpenzosh, duhet të marrësh për bazë kriteret e Allahut. Për të mbajtur pastër pasurinë, kërkohet një disiplinë zemre. Brenda pasurisë nuk duhet të mbetet asnjë grimë prej të drejtës së të varfrit, sepse ajo që e përlyen më së shumti pasurinë, është e drejta e të varfrit që nuk është dhënë prej saj."*

A mund të realizohen këto që përmendëm pa u edukuar zemra? Nëse i shkakton dhimbje me gjuhë shpirtit të cilit i ke dhënë me dorë, atëherë ku është zemra? Nëse tjetrit i jep atë që nuk do ta pranoje as vet po të të jepej, ku është zemra? Nëse përjeton ndjenja arrogance kur je i pasur, ku është vetëdija për **"ato që Allahu ka dhënë si furnizim"**? Është një ditë, kur pasuria dhe fëmijët nuk do të bëjnë dobi. Këtë, e thotë Kurani... Agjërimi po troket në derë!.. Zëre se erdhi... Për një ripërpunim zemre.

Allahu mos na e largoftë zemrën prej aktualitetit tonë dhe na e bëftë të mundur që Bajramin ta jetojmë me gëzime të zemrës!

Përmbajtja



14

Ramazani, muaji i Kuranit
Doç. dr. Mustafa Karabaxhak



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34




16

22



Veçoritë e atyre
që garojnë në mirësi
Xhafer Durmush

- 5 Agjërimi i zemrës
Ahmet Tashgetiren
- 8 Marrëdhënia agjërim, zemër dhe nefsi
Prof. dr. Sulejman Derin
- 12 Ramazanë pa bajram
Ali Riza Temel
- 16 Mbartja e Kuranit në jetë brenda linjës
së Ramazanit dhe Furkanit
Prof. dr. Kerim Bulladë
- 18 Thurja e imagjinatave të përhershme
në një botë të përkohshme
Raif Koçak
- 20 Një udhëtim me Sheherazaden
Nuredin Nazarko
- 24 Nevoja për një muaj të veçantë
Romeo Ismailaj
- 26 Ukbe Ibni Amr
Mustafa Erish



44

- Humbja e besimit dhe sigurisë 28
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- Koha për të jetuar esencën e Islamit 30
Rabia Brodbeck
- Një Ajet-Një Hadith 32
- El-Alij El-Kebir 40
Ilir Hoxha
- Gjuha e personalitetit 44
Doç. dr. Adem Ergyl
- I dituri dhe varkëtarë 46
Urtësi
- Dy fjalë 47
Ferudun Ozdemir
- Ti je xheneti im 52
Halime Demireshik
- Fëmija dhe shoqëria 56
Tuba Sokmen


42



Duhet të bëjmë llogarinë
Nuredin Jëlldëz

Nevoja për Zotin
Ferit Piku

48





Agjërimi i zemrës

— Ahmet Tashgetiren —

Jemi në ditët kur përsëri kemi vënë zemrat tona në rend të ditës dhe i marrim në pëllëmbë të dorës.

Në fakt, zemrat duhet t'i kemi gjithmonë në rend të ditës dhe në pëllëmbë të dorës. Çdo gjë duhet vlerësuar me agjendën e zemrës dhe duhet të kemi një dert të shenjtë, siç është përpunimi i zemrës, mbujta dhe mbajtja gjallë e saj.

“Bëni kujdes! Zemrat qetësohen dhe kënaqen vetëm duke përmendur Allahun.”

Kjo është një shprehje Kuranore. Të mbruash zemrën me vetëdijen e të qenit bashkë me Allahun, duke mos e harruar Atë dhe duke vendosur marrëdhënien me Allahun në shpirtin e çdo pune...

“Sillmëni zemër të pastër” kur të dilni në udhëtimin e përjetësisë, thotë Allahu. Në një vend ku pasuria dhe fëmijët e shumë të nuk do të kenë asnjë dobi...

Mund të thuhet se Islami, pra, korniza e jetës, kriteret e së cilës janë përcaktuar nga Allahu, synon mbajtjen gjallë të marrëdhënieve me Allahun, të besimit, adhurimit dhe të gjitha marrëdhënieve njerëzore, ku bëjnë pjesë veprat, dispozitat penale dhe morali.

Nëse marrëdhënia me Allahun është e gjallë, çdo gjë shkon në vendin e vet. Përndryshe, nëse ajo nuk mbahet gjallë, nëse vyshket, harrohet, merr plagë

dhe plogështohet, njeriu përballet me rrezikun e përplasjes nga një botë, në tjetrën.

Në sajë të pesë kohëve të namazeve në ditë, besimtari mëson të dalë para Krijuesit me duar, fytyrë, sy, këmbë, veshë, tru dhe zemër “të pastër”. “Erdha para Teje i pastër O Zot!”-thotë ai.

Nëse në udhëtimin e namazit nuk na shoqëron shqetësimi për **“të dalë të pastër”**, atëherë nuk është e mundur të shkulim dhe të flakim tutje “paturpësitë dhe të këqijat”, prej të cilave Allahu thotë se na ruan namazi. Atëherë, ai namaz s’do të kishte dobi, sepse do të ishte i zbrazur. Por, nëse e dimë se do të dalim në një instancë të lartë, atje nuk duhet të gënjejmë, sepse Ai di gjithçka në zemra. Po ashtu, nëse e dimë se do të dalim në atë instancë të lartë në ditën e tubimit të madh, edhe nëse gjuhët tona heshtin, do të flasin duart, këmbët dhe lëkurët tona... Nëse e dimë, për Krijuesin e Madhërisëm nuk ka asnjë të fshehtë... Atëherë, çdo namaz e mbledhim në kohën e vet dhe kërkojmë devotshmërinë ideale në vetët tona.

Këto ditë do të arrijmë agjërimin, në sajë të të cilit njeriu përjeton një detoks shpirtëror, duke i kufizuar trupit nevojat më të natyrshme me kriteret e vendosura nga Allahu. Detoks, është pastrim i zemrës prej papastërtive të akumuluar dhe barrëve që ajo s’mund t’i mbajë.

Në të vërtetë, agjërimi është për zemrën, dhe, nëse ajo nuk agjëron, nuk agjërojnë as sytë, as veshët dhe as gjuhët, gjë që lind rrezikun e shndërrimit të agjërimin thjesht në një uri padobi, të cilën i Dërguari i Allahut e ka paralajmëruar që në fillim.

Agjërimi erdhi e iku, dhe nuk ndikoi fare tek ne, nuk na përmirësoi dhe nuk na i fashoi plagët... Ne mbetëm në gjendjen tonë të



**TË GJITHA ADHURIMET
E EDUKOJNË ZEMRËN
PËRDITË, PËRJAVË,
E PËRVIT GJATË
GJITHË JETËS, ME
QËLLIM QË NJERIU
TË MBAJË GJALLË
MARRËDHËNIEN E
TIJ ME ALLAHUN. NË
KURAN URDHËROHET:
“UE HUE MEAKUM
EJNE MA KUNTUM /
AI ËSHTË BASHKË ME
JU KUDO QË TË JENI”.
“AI ËSHTË MË AFËR
NJERIUT SE DAMARI I
QAFËS SË TIJ.”**

plogësht, ndërkohë që goja jonë ka agjëruar, e zemra jonë ka ngrënë vazhdimisht... Ku është agjërimi?!

Nëse zemra agjëron, agjërimi na merr e na çon në Xhenet. Prandaj kemi nevojë për agjërim që na nxjerrin në udhëtimin drejt Xhenetit. Për këtë arsye, në çdo kohë iftari, duhet t’i marrim zemrat tonë në dorë dhe të shohim çfarë ka e nuk ka aty. Natën e Kadrit, në mëngjesin e saj dhe të Bajramit, duhet të arrijmë të kemi zemra të gjalla dhe të pastra, aq sa të mund t’ia ofrojmë Allahut.

Zekati është kalibrimi që i bëhet besimtarit në çështjen e dashurisë ndaj pasurisë. *“Edhe pasuria, edhe jeta janë dhunti të Allahut. Mos e harro këtë! Prandaj, edhe kur ta fitosh, edhe kur ta shpenzosh, duhet të marrësh për bazë kriteret e Allahut. Për të mbajtur pastër pasurinë, kërkohet një disiplinë zemre. Brenda pasurisë nuk duhet të mbetet asnjë grimë prej të drejtës së të varfrit, sepse ajo që e përlayen më së shumti pasurinë, është e drejta e të varfrit që nuk është dhënë prej saj.”*

A mund të realizohen këto që përmendëm pa u edukuar zemra? Nëse i shkakton dhimbje me gjuhë shpirtit të cilit i ke dhënë me dorë, atëherë ku është zemra? Nëse tjetrit i jep atë që nuk do ta pranoje as vet po të të jepej, ku është zemra? Nëse përjeton ndjenja arrogante kur je i pasur, ku është vetëdija për **“ato që Allahu ka dhënë si furnizim”**? Është një ditë, kur pasuria dhe fëmijët nuk do të bëjnë dobi. Këtë, e thotë Kurani...

Zekati e pastron pasurinë, por më parë duhet të pastrojë zemrën. “Kujdesi ndaj pastërtisë”, duhet të jetë i gjallë në zemër edhe kur je duke dhënë zekatin. A mund **“t’i japësh diçka në dorë Allahut”** pa e kulluar atë në zemër? “Ju jeni të varfër, e Allahu i pasur”. Nëse shohim këtë të vërtetë absolute, sado i pasur të

jesh, kur të jesh duke dhënë zekat, do ta japësh patjetër në dorën e Pasanikut Absolut. Prandaj bëj kujdes zemrën!

Sa i përket Haxhit... Do të shkosh i zhveshur prej ekzistencës së gjithë botës dhe, i mbuluar me dy copa beze si qefin, do të thuash, *“Lebbejke Allahume lebejk / Të përgjigjem ty, o Allah, të përgjigjem!”*. Këtë e the me gjithë zemër dhe e ke ngulitur në të... E përpunove aq mirë zemrën, sa që u ktheve përsëri në këtë botë si një njeri që ka parë Mahsherin në Arafat, pra i shndërruar në njeri tjetër. Përsëri do të jetosh, por kësaj here, do të jetosh si dikush që ka parë Mahsherin, Ditën e Gjykimit, sikur të kesh shkuar e të jesh kthyer prej asaj bote. Do të jetoje si një njeri që e ka rilexuar Librin e Jetës në instancat e larta hyjnore, ose si ai që sheh filmin e jetës së vet dhe është i detyruar të kuptojë se **“nuk ka askund ku të shkojë”**.

Trupi yt në Arafat, ndërsa ti në vendin e punës... A bën ta bartësh hallin e kësaj bote në Mahsher? Kthehu dhe shih veten! Gjithçka që ke janë dy copa beze. S'ke status, pasuri, prona, pushtet dhe fuqi. Atje vendimi i takon Allahut.

Po umreja?.. Padyshim se nuk është plotësisht, por përsëri është një adhurim që sadopak të shpie e të sjell prej botës së Haxhit. Në daç shih Ramazanin, në daç umren... ihramin! Vishi zemrës ihramin dhe disiplinoje atë, sepse këtu kërkohet një disiplinë hyjnore. Lëre grindjen! Mos e këput barin! Mos e vrit mizën, e as milingonën mos lëndo! Bëhu njeri i delikatesës! Mos të mbetet haxhi në Haxh, e as umreja në Umre. Fito një zemër atje dhe barte atë në të gjithë kapilarët!

Të gjitha adhurimet e edukojnë zemrën përditë, përjavë, e përvit gjatë gjithë jetës, me qëllim që njeriu të mbajë gjallë marrëdhënien e tij me Allahun. Në Kuran urdhërohet: **“*Ue hue meakum ejne ma kuntum / Ai është bashkë me ju kudo që të jeni*”**. **“*Ai është më afër njeriut se damari i qafës së tij*”**.

Me këtë vetëdije e përfshijnë adhurimet njeriun. Vetëm duke vepruar vazhdimisht kështu, jeta e muslimanit bëhet një **“jetë e jetuar sikur është duke e parë Allahun”**. Adhurimet e shkrijnë potencialin e harresës dhe pakujdesisë që gjendet në natyrën e njeriut dhe në vend të tyre ngarkojnë **“vetëdijen e të qenit bashkë me Allahun”**. Nisur nga shprehja Kuranore, **“kur Allahu dhe i Dërguari i Tij ju thërrasin tek ato që ju japin jetë, përgjigjuni!”**, mund të themi, se ne jemi të gjallë, aq sa u përgjigjemi thirrjeve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Ne duhet ta njohim vdekjen e zemrës, sëmundjen, verbërinë dhe Zoti na ruajt, vulosjen e saj! E më pas, duhet të marrim masa kundër këtyre, duke krijuar mekanizma mbrojtjeje. Ashtu siç marrim masat e duhura kur na thuhet, “nëse ha këtë shkaktohet kjo sëmundje, ose nëse jeton filan vend do të helmohesh”, ashtu duhet ta ruajmë jetën tonë shpirtërore prej ambienteve helmuese. Dallimi mes atmosferës së adhurimit dhe asaj të gjynaheve, janë të ndryshme nga njëra-tjetra, aq sa edhe shëndeti dhe sëmundja e zemrës.

Ne i kryejmë adhurimet.. Ato arrijnë ose jo në zemrën tonë... Dhe kjo në fakt ka të bëjë me cilësinë e adhurimeve tona. Por, nëse ne qëndrojmë në namaz dhe nuk e dimë se po qëndrojmë para Allahut, atëherë zemra jonë nuk përfiton asgjë prej atij namazi. Ai namaz nuk shkon në zemër.

Agjërimi shndërrohet në uri, haxhi në udhëtim, e zekati në një ushtrim, që ushqen dëshirën tonë për të qenë sa më të pasur...

I gjallë, i gjallë, i gjallë...

Çdo adhurim duhet të bëhet me gjallëri. Duhet bërë në mënyrë ideale, aq sa ta mbajë gjallë marrëdhënien tonë me Allahun. Për këtë arsye, ne duhet të kemi një aktualitet të zemrës. Ndërsa vetëdija e një detyre të pafundme, si përpunimi i zemrës, duhet ta kontrollojë gjithmonë zemrën e besimtarit.

Shumë dijetarë islamë, flasin për marrëdhënien Qabe-Zemër. Të shkosh në Qabe, e të mos e zbulosh zemrën, është e papranueshme. Zemrat që e rinovojnë marrëdhënien e tyre me Qaben nuk duhet të vjetërsohen.

Një dijetar Islam thotë:

“Njeriu duhet të jetë i zoti të marrë zemrën në dorë e të shëtisë pa u turpëruar mes njerëzve.”

Transparent, transparent, transparent...

Sepse Allahu e di çfarë ka në zemër. Prandaj s'ka rëndësi nëse nuk e shohin njerëzit!

Nëse këshillohemi me zemrat tona, edhe ne mund t'i shohim ato.

Për të rishikuar zemrat tona, namazi është më afër nesh se umreja dhe haxhi...

Agjërimi po troket në derë!.. Zëre se erdhi... Për një ripërpunim zemre.

Allahu mos na e largoftë zemrën prej aktualitetit tonë dhe na e bëftë të mundur që Bajramin ta jetojmë me gëzime të zemrës!



Marrëdhënia

agjërim, zemër dhe nefsi

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Dëlirja dhe përsosja e personalitetit të njeriut pa dyshim se është njëra prej detyrave më të rëndësishme për shpëtimin e përhershëm. Vendi i ushtrimit të kësaj detyra është fusha e “nefsit” dhe “zemrës”. Nefsi duhet të pastrohet nga fuxhuri (çdo lloj prirjeje për mëkat dhe papastërtitë e gjynahut). Ndërsa zemra duhet të mbrohet e të pajiset me devotshmëri. Në të kundërt, kapitali i jetës do të shkojë dëm dhe njeriu do të humbasë. Edhe harta e kësaj lufte që do të realizohet në trupin tonë i është paraqitur të gjithë njerëzimit si një plan mësimor hyjnor nga Zoti (xh.xh.), me Kuranin Fisnik dhe me fjalët, veprat dhe gjendjet e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ne në këtë shkrim krahas se do të theksojmë që agjërimi është një ibadet, do të nxjerrim në pah edhe faktin sesi agjërimi bëhet shkak për pastrimin e nefsit dhe

për mbrojtjen e zhvillimin e zemrës me devotshmëri.

Nefsi i cili shpreh unin/egon e njeriut, posedon një natyrë që siç thotë edhe Kurani Fisnik, urdhëron të keqen me të gjithë fuqinë që ka.¹ Por gjithashtu atij i është dhënë edhe aftësia për t’u dëlirë.² Ndoshta sprova dhe përgjegjësia e njeriut me veten e tij fillon këtu.

Ndërsa zemra është vendi edhe i të kuptuarit, edhe i devotshmërisë e cila cakton nderin dhe vlerën e njeriut te Zoti (xh.xh.). Zemra është thelbi i njeriut dhe vendi ku shikon Allahu Teala. Zemra është masa e vlerës që robi do të ketë në ditën e gjykimit.

1. Shik. Surja Jusuf, 53.

2. Shik. Surja Shems, 7-9.

Për sa i përket agjërimit mund të themi se ai ka një veti edukuese për dëshirat e nefsit dhe forcuese për ndjenjën e devotshmërisë në zemër. Në të vërtetë, ai është një adhurim që i është bërë obligim të gjithë njerëzimit në forma të ndryshme dhe një mundësi pastrimi/edukimi universale. Tani le të shohim marrëdhënien edukuese dhe pastruese ndërmjet agjërimit, nefsit dhe zemrës.

Hoxhallarët e mëdhenj të cilët mund t'i quajmë prijësit e edukimit të civilizimit tonë, i kanë konsideruar si të lidhur shumë me njëri-tjetrin edukimin e nefsit dhe dëshirat e trupit. Gjërat me të cilat duhet të ushqehet trupi dhe mënyrat se si duhet të ushqehet ky i fundit pothuajse i kanë konsideruar si hapin e parë në edukimin e nefsit. Vazhdimisht na është kujtuar se duhet të shfaqim kujdes të madh kundrejt çdo lloji të haramit, të ushqehemi me hallall, të qëndrojmë larg gjërave të dyshimta dhe të përfitojmë nga mirësitë me një zemër të zgjuar dhe pa qenë neglizhentë ndaj Allahut (xh.xh.).

Hoxha i mirënjohur, Ibrahim Hakkë Erzurumi në veprën e tij me titull Marifetname, na e tërheq vëmendjen ndaj këtyre çështjeve të mëposhtme të cilat janë shtyllat, bazat dhe themelet e “Rrugës së Urtësisë”, domethënë të shkollës së “marifetu’n-nefs ve marifetu’ll-llah / njohjes së vetes dhe njohjes së Zotit”:


1. Taklili taam (Të ngrënë e pakët)
2. Taklili kelam (Të folurit e pakët)
3. Taklili menam (Të fjeturit e pakët)
4. Uzleti enam (Të qëndruarit larg njerëzve përveç se në situata të domosdoshme dhe të nevojshme)
5. Dhikri mudam (Të përkujtuarit e Zotit në mënyrë të vazhdueshme)
6. Fikri temam (Të llogariturit e vetes dhe të medituarit duke nxjerrë nga zemra çdo gjë të kësaj bote dhe duke iu drejtuar Zotit në një mënyrë të plotë)³

Nëse i shohim me vëmendje, pothuajse të gjitha këto gjashtë nene mbartin qëllimin e pastrimit të nefsit dhe forcimit të devotshmërisë së zemrës. Këtu në një mënyrë përjetohen të gjitha kushtet e numëruara te ibadeti i agjërimit. Le ta shpjegojmë edhe pak më shumë:

Të ngrënë dhe të pirët në agjërime janë të ndaluar për një kohë të caktuar. I Dërguari i Allahut

3. Ibrahim Hakkë Erzurumi, Marifetname, Shtypshkronja Ahmed Kamil, Stamboll 1330, fq. 304.

**ZEMRA E AGJËRIMIT
ËSHTË DEVOTSHMËRIA.
NDËRSA VENDI I
DEVOTSHMËRISË
ËSHTË ZEMRA. NDËRSA
AGJËRIMI I ZEMRËS ËSHTË
ELIMINIMI I ÇDO LLOJ
QËLLIMI QË MBAN ERË
NEFSI, NXJERRJA E ÇDO
GJËJE PREJ SAJ PËRVEÇ
ZOTIT DHE SPECIFIKIMI
I SARAJIT TË SAJ VETËM
PËR ALLAHUN (XH.XH.).**



(a.s.), nuk e ka parë të përshtatshëm “savmi visal”, domethënë agjërimit ditë pas dite pa bërë iftar, sepse, uria dhe pehrizi ekstrem edhe pse mund ta bëjë njeriun të përjetojë gjendje të mbinatyrshe siç ndodh te murgjit budistë dhe Brahmanët, me kalimin e kohës e largojnë njeriun nga pjekuria e një personaliteti të ekuilibruar. Bazuar në këtë, ibadeti i agjërimit në Islam edhe pse jep edukimin e “taklili taamit/të ngrënë e pakët” dhe në këtë mënyrë e bën zemrën të fitojë kundër nefsit, këtë të fundit nuk e shkëput krejt nga jeta. Thënë ndryshe, ia jep nefsit të drejtat e saj dhe ia kufizon e frenon qejfet (dëshirat dhe epshet) e veta.

Të folurit përgjatë agjërimit nuk është ndaluar krejtësisht. Domethënë, në fenë tonë nuk është këshilluar një praktikë të cilën mund ta quajmë agjërime të folurit. Ama këshillohet në mënyrë të veçantë që t'i dalim për zot gjuhës dhe të qëndrojmë larg fjalëve e debateve të panevojshme. Ky është “taklili kelam/të folurit e pakët” që përbën njërin prej themeleve të rrugës së njohjes së Zotit (xh.xh.).

Namazi i natës, veçanërisht namazi i taravisë dhe adhurimi në kohën e agimit, janë prej sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), që kryhen me një kënaqësi e pasion të madh përgjatë muajit të Ramazanit. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Në syfy

ka bereqet.”⁴ Me këtë shprehje është kërkuar që besimtarët të jenë në këmbë në mes të natës, në mënyrë që të adhurojnë Zotin e tyre. Këto vepra të mira që kryhen përbëjnë “taklili menamin / të pakësuarit e gjumit” i cili është njëri prej themeleve të edukimit të “sejri sulukut/ udhëtimit shpirtëror”.

Muaji i agjërimit është muaji kur robi mund t'i shtojë momentet e veçanta të qëndrimit vetëm për vetëm me Zotin (xh.xh.). Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, pothuajse në çdo Ramazan ka hyrë në itikaf dhe veçanërisht në dhjetë ditëshin e fundit nuk është larguar nga xhamia natë e ditë. Marrëdhënien e tij me çdo gjë tjetër përveç Allahut Teala pothuajse e ka zbritur në nivelin më të ulët. Kjo gjendje quhet “uzleti enam”.

Agjërimit nga një aspekt është të kujtuarit e Zotit (xh.xh.), në një mënyrë të vazhdueshme, sepse lënia e nevojave dhe dëshirave më të natyrshme si të ngrënës dhe të pirës ngaqë ka kërkuar Ai, sigurisht që nxjerr në pah një gjendje dhikri të vazhdueshme. Kjo gjendje vazhdon pothuajse në mënyrë të domosdoshme më shumë se gjysmën e ditës. Ja pra, kjo është njëra prej çështjeve për të cilën folëm më sipër dhe që e quajtmë “dhikri mudam” dhe “fikri tamam”.

Secila prej bazave për të cilat folëm më sipër, në shumë aspekte janë pastruese dhe edukuese për dëshirat e panevojshme, të ulëta dhe shumicën e rasteve të dëmshme të nefsit. Në të njëjtën kohë ato e mbrojnë zemrën nga preokupimet e panevojshme dhe e ushqejnë me gjëra që formojnë devotshmërinë. Në të vërtetë, Zoti (xh. xh.), shprehet se qëllimi i urtësisë në obligimin e agjërimit është pikërisht ky. Andaj thotë: “**...Ju është obliguar agjërimit, në mënyrë që të bëheni të devotshëm.**”⁵ Njëri prej shumë përkufizimeve të devotshmërisë është ky: “Devotshmëria është vetëdijësimi i robit për përgjegjësinë që ka ndaj Allahut.” Nisur nga ky kontekst, agjërimit është edhe një ibadet që ia shton njeriut ndjenjën e përgjegjësisë së nënshtrimit kundrejt Allahut, edhe një plan mësimor i ardhur nga Zoti për t'ia shtuar atij ndjenjën e përgjegjësisë kundrejt kri-

jesave të tjera. Kjo sepse muaji i Ramazanit nga njëra anë është një muaj në të cilin kryhen shumë adhurime farz dhe nafile me në krye namazin. Në anën tjetër është edhe një sezon i veçantë në të cilin ndjehet në nivel të lartë vetëdijësimi për mëshirën, dhembshurinë dhe dhurimin duke dhënë zekatin dhe fitret.

Gjithashtu agjërimit, si një rezultat i natyrshëm i ngrënies dhe pirjes së pakët, bëhet shkak që nga zemra të shpërthejnë burimet e urtësisë. Shumë dijetarë e kanë shprehur në veprat e tyre se ka një lidhje të afërt ndërmjet urisë dhe urtësisë. Urtësia është një nderim i madh hyjnor edhe për zemrën, edhe për jetën tonë. Nisur nga ky kontekst mund të themi se agjërimit luan një rol të rëndësishëm në reflektimin e dritave dhe shfaqjeve hyjnore në zemrën tonë.

Disa dijetarë të urtë që janë frymëzuar nga hadithi fisnik: “Për agjëruesin ka dy gëzime. Njëri është gëzimi kur të çelë iftarin, ndërsa tjetri është gëzimi kur të takojë Zotin.”⁶, kanë thënë se agjërimit në të njëjtën kohë është edhe përgëzim për takimin me Zotin dhe për shikimin e bukurisë së Tij. Nisur nga këto që thamë, agjërimit është urë edhe për ndjesinë dhe perceptimin që bën të mundur shikimin (e fuqisë së) Zotit në çdo gjë të kësaj bote. Në këtë kontekst, agjërimit është prekje shpirtërore e ardhur nga Zoti që formon prehjen e zemrave.

Zemra e agjërimit është devotshmëria. Ndërsa vendi i devotshmërisë është zemra. Ndërsa agjërimit i zemrës është eliminimi i çdo lloji qëllimi që mban erë nefs, nxjerrja e çdo gjëje prej saj përveç Zotit dhe specifikimi i sarajit të saj vetëm për Allahun (xh. xh.). Kjo gjendje është një agjërimit që zgjat gjithë jetën dhe të cilën të gjithë dijetarët kanë dëshiruar ta realizojnë në jetën e tyre. Për ta arritur këtë pjekuri duhet të pastrohemi me agjërimit, të tërheqim mëshirën dhe udhëzimin hyjnor me shumë muxhahede/përpjekje⁷ dhe t'i përgjrohemi Zotit (xh.sh.) për teufik/sukses.⁸


6. Buhari, Saum, 9; Muslim, Sijam, 163.

7. Muxhahede do të thotë t'i drejtohesh çdo lloji të adhurimeve, përpjekjeve dhe shërbimeve me qëllimin për t'u bërë prej robërve nga të cilët është i kënaqur Zoti në rrugën e edukimit të nefsit dhe pastrimit të zemrës.

8. Teufik do të thotë që Allahu ta ndihmojë dhe ta kapë për dore robin e Tij në çështje që janë në përputhje me mendjen e shëndosh dhe shëriatin.

4. Buhari, Savm, 20; Muslim, Sijam, 45.

5. Bekare, 183.



Mbi kujtimet dhe historinë

— Edison Çeraj —

1

Ndoshta gjëja e parë që na bie në sy kur bëhet fjalë për kujtimet dhe historinë është një e përbashkët e menjëhershme: fakti se si kujtimet ashtu dhe historia janë të lidhura pazgjidhshmërisht me të shkuarën. Nëse do të ishte nevoja për një krahasim, le të themi se historia është shtëpia si strukturë, si materie, kurse kujtimet janë shtëpia si banim, si frymë. Në anglisht kemi *house* dhe *home*.

2

Historia është e përbashkëta e një shoqërie dhe e një vendi, kurse kujtimet janë vetëm individuale, thellësisht individuale. Ja pse kujtimet mund të jenë fare mirë paradhoma e letërsisë. Kujtimet mbushin me jetë muret e ftohta të ngrehinës që ndërton historia si shkencë. Duke qenë se kujtimet janë gjithnjë në vetën e parë, ato i drejtohen individit, gjë që nuk ndodh (pothuajse) aspak me historinë, pasi ajo ka si objektiv shoqërinë në përgjithësi.

3

Kujtimet janë një peshë e ngrohtë që i bën masazh disa zonave të ndrydhura të ndërgjegjes sonë, dhe kështu këto zona bëhen gati për të pritur të tashmen. Kujtimet janë shumëçka nga ajo që jemi dhe kemi. Teksa kujtojmë pastrojmë nga qenia shumë skorje të kohës dhe hapësirës, duke na bërë të mundur të përqendrojmë ndërgjegjen.

4

Kur lexojmë kujtime është si të shëtisësh në një qytet tradicional, ku çdo ndërtim i përgjigjet masës dhe kutit njerëzor. Ndërsa kur lexojmë histori është si të ecësh në një metropol, ku vetja të duket aq e parëndësishme, thjesht një fenomen pezull në kërkim të kuptimit, ku sa më shumë kërkon, aq më shumë shtohet doza e largësisë nga vetja. Hizonti mbyllet, pa magji. Një perde prej çeliku zë dritën dhe çdokujt i jepet një rol. Është pikërisht ky rol që duhet të luajmë çdo ditë që na bën të huaj me veten.

5

Historia është një zinxhir i mundimshëm interpretime, që sa më shumë ta zhvillosh, aq më shumë të shtrëngon. Faktet dhe provat për të cilat vihet në kërkim historiani të privojnë nga thelbi. *Lufta dhe paqja* apo *Të mjerët* janë edhe libra historikë, por duke qenë se nuk kanë qëllim një gjurmim “sistemik” faktesh, ato na lidhin me thelbin njerëzor në kushtet e historisë, domethënë në kushtet e kohës dhe hapësirës.

6

Kujtimet të kallin dhimbje, historia frikë. Është një dhimbje që të ruan nga përshtatja, nga rryma, nga turma, nga grupimi. Është një dhimbje që shoqërohet edhe me një gjendje shprese, ku njeriu gjen kohë të takohet me veten. Kujtimet janë një botë mes ëndrrave dhe të shkuarës. Kujtimet janë zëri tjetër, që nuk dëgjohet nga të tjerët; janë dobësia jonë e pushtetshme.

TË FESTOSH BAJRAMIN NË FUND TË RAMAZANIT, FILLIMI I TË CILIT ËSHTË MËSHIRË, MESI FALJE DHE FUNDI SHPËTIM PREJ XHEHENEMIT DHE TË PËRJETOSH GËZIMIN E PASTRIMIT NGA GJYNAHET, DUKE QENË KANDIDAT PËR XHENET, PADYSHIM QË ËSHTË E DREJTA MË E NATYRSHME E ATYRE QË E KANË GJALLËRUAR DHE JANË GJALLËRUAR ME RAMAZAN.

RAMAZANË PA BAJRAM

— Ali Riza Temel —

Titulli i shkrimit mund të duket disi i çuditshëm. Madje, mund të thuhet se, “ku ka Ramazanë pa Bajram?”. Kujt i duket kështu në pamje të parë dhe bën këtë pyetje, ka të drejtë, sepse deri më sot, në fund të Ramazanit është festuar gjithmonë Bajrami, gjë e cila është edhe domosdoshmëri në aspektin fetar. Po ashtu, me qëllim që të gëzohen dhe të festojnë ata të cilët kanë agjëruar një muaj, kanë falur teravitë, kanë braktisur gjumin dhe janë ngritur në syfy, kanë lexuar më tepër Kuran, kanë bërë hatme dhe kanë dhënë sadaka, agjërimi ditën e Bajramit është konsideruar haram, ose tahrimen mekruh.

Çdo punë e ka një shpërblim. Punëtorët kanë të drejtë të paguhen. Për rrjedhojë, edhe besimtarët që kanë kryer adhurime intensive brenda një muaji, padyshim që kanë të drejtë të gëzohen dhe të shpërblehen.

Të festosh Bajramin në fund të Ramazanit, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi falje dhe fundi shpëtim prej Xhehenemit dhe të përjetosh gëzimin e pastrimit nga gjynahet, duke qenë kandidat për Xhenet, padyshim që është e drejta më e natyrshme e atyre që e kanë gjallëruar dhe janë gjallëruar me Ramazan.

Ramazanët janë mundësia më e madhe për fitimin e Xhenetit. Profeti ynë (a.s.), ka thënë “amin” në çdo shkallë të minberit të tij tre shkallësh. Kur u pyet, përse veproi ashtu, ai u përgjigj: “*Mu shfaq Xhibrili (a.s.) dhe më tha: «Qofshin larg prej mëshirës ata të cilët arrijnë Ramazanin dhe nuk shpëtojnë nga Xhehenemi e hyjnë në Xhenet!» Ndërsa unë thashë «amin».*” (et-Tergib, 2/92.)

Bajrami më i madh, është arritja e kënaqësisë së Allahut dhe hyrja në Xhenet. Ramazani është shpagim për gjynahet e shkuara. Në të hapen dyert e Xhenetit, lidhen me zinxhir shejtanët dhe mbyllen dyert e Xhehenemit. Po ashtu, në të, veprat vlerësohen shtatëdhjetë herë më tepër. Ramazanët janë mundësi pastrimi prej papastërtive fizike dhe shpirtërore, shërim prej sëmundjeve dhe shkaqe për miqësi, bujari dhe solidaritet. Gjatë Ramazanit, hapen plotësisht dyert e mirësisë dhe mbyllen ato të së keqes.

Ata që e gjallërojnë Ramazanin dhe gjallërohen siç duhet me të, kanë të drejtë të gëzohen dhe të bëjnë Bajram. Por, a vlen kjo për të gjithë? A e meritojnë Bajramin të gjithë ata që arrijnë Ramazanin? A mund të jenë ata kandidatë për Xhenet?

Ka shumë të mjerë, të cilët nuk arrijnë të fitojnë prej mirësive dhe begative të Ramazanit. Lidhur me këta, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Ka shumë që agjërojnë, e nuk përfitojnë prej agjëritimit përveçse urinë, dhe shumë që falin namaz nate, e nuk përfitojnë prej tij

përveçse pagjumësinë.” (Tergib, 2/148.)

“Kush nuk e braktis gënjeshtren dhe të vepruarit sipas saj, Allahu nuk ka kurrfarë nevoje që ai ta braktis ushqimin dhe pijen.” (Tergib, 2/146.)

Siç shihet, Ramazani nuk është njësoj për të gjithë. Për rrjedhojë, kush nuk përfiton prej Ramazanit, nuk mund të përfitojë as prej Bajramit. Këta, jo vetëm që nuk mund ta fitojnë dot Xhenetin, por meritojnë edhe mallkimin e Xhibrilit dhe të Profetit tonë (a.s.).

Po digjemi nga malli për Ramazanët që hapin dyert e Xhenetit, mbyllin dyert e Xhehenemit dhe bëhen arsye Bajrami për myslimanët në të dyja botët. Nuk e dimë me siguri nëse agjërimet, hatmet dhe sadakatë tona janë apo jo të pranuar dhe a do të bëhen shkak për pranimin tonë në Xhenet. Megjithatë, ne i lutemi Allahut të Madhëruar që t'i pranojë ato. Mirëpo, nuk mund të themi se në fund të Ramazanit, ne e festojmë Bajramin të kënaqur në të gjithë botën. Më së shumti, po jetojmë Ramazane dhe Bajrame ku gëzimet kthehen në hidhërime dhe shpresat në pesimizëm.

Bajramet janë ditë gëzimi. Kohë kur gëzimi dhe lumturia përjetohen bashkërisht. Momente kur fytyrat ndriçohen me buzëqeshje dhe zemrat me shpresë. Ndërkohë që myslimanët kanë më tepër të drejtë të gëzohen dhe të bëjnë Bajram me kuptimin e vërtetë të fjalës, ata, prej kohësh ndjejnë mallin e gëzimeve të vërteta të Bajrameve. Kemi kohë që nuk përjetojmë Bajrame larg lajmeve të hidhura të vdekjeve, vrasjeve dhe masakrave. Tashmë, në vend që të zgjohemi me zërat e hareshëm që lajmërojnë festimet e Bajramit, ne po zgjohemi me zhurmat e bombave që hidhen për të vrarë myslimanët.

Profeti ynë (a.s.), duke synuar që myslimanët të gëzohen të gjithë së bashku, ka thënë; *“Agjërim është ai që mbajmë së bashku, ndërsa Bajram, kur gëzohemi së bashku.”* Mirëpo, në vend që të gjenim mundësitë për t'u gëzuar së bashku, ne kemi gjetur mënyrat për t'u hidhëruar së bashku. Ndërkohë që edhe arabët në kohën e injorancës i respektonin muajt e shenjtë, duke mos bërë luftë në ato muajt, sot, ne që e konsiderojmë veten më të civilizuar, nuk i kalojmë dot katër ditë pa luftë.

Ndërkohë që kur jemi me ihram gjatë haxhit, përpiqemi të mos vrasim asnjë gjallesë dhe të mos këpusim asnjë bimë, përse jashtë kësaj kohe nuk arrijmë të kemi respekt për njëri-tjetrin dhe jetën përreth nesh?

Allahu i Madhëruar ka shpallur se; *“Besimtarët janë vëllezër!”*, ndërsa Profeti (a.s.), na ka porositur; *“Mos u bëni si mohuesit, që vrasin njëri-tjetrin!”*. Atëherë, ne që jemi robër të të njëjtit Zot, ummet

i të njëjtit profet, ndajmë një libër dhe një kible, përse e shndërrojmë miqësinë në armiqësi, paqen në luftë dhe bashkimin në përçarje?

Thonë se, *“një fatkeqësi, është më e mirë se njëmijë këshilla”*. E në fakt, ne myslimanët kemi përjetuar me mijëra fatkeqësi dhe ende vazhdojmë t'i përjetojmë. Por, si t'i bëjë dobi këshilla një shoqërie, kur nuk i bën as fatkeqësia? A mos jemi kthyer edhe neve në një shoqëri që nuk i bëjnë dobi as këshillat, e as fatkeqësitë?

Çfarë kemi fituar deri më sot prej grindjeve racore, fetare dhe atyre për interesa të ngushta, të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me Islamit dhe humanizmin? Këto dobësi dhe fatkeqësi që po përjetojmë si ummet, burojnë prej brendësisë sonë, prej të metave që bartim në veten tonë. Në vend që të kërkojmë armiq nga jashtë, jemi të detyruar t'i kthehemi vetes dhe të rishikojmë sëmundjet e egojeve tona, duke bërë një “checkup” shpirtëror.

Shkaktarët e privimit edhe nga gëzimet e Bajrameve, jemi vet ne. Allahu nuk i bën padrejtësi askujt, sepse cilësitë e Tij, Rrahman dhe Rrahim janë gjithmonë në plan të parë.

“...Allahu nuk u bëri padrejtësi atyre, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.” (Teube, 70.)

Allahu i Madhëruar krijon atë që gjithkush e meriton. Madje, edhe vet shejtani thotë: *“...Mos më qortoni mua, por veten tuaj!..”* (Ibrahim, 22.) Prandaj, ne duhet t'i kthehemi vetes dhe të rindërtojmë personalitetin dhe identitetin tonë. Ky rindërtim, duhet të jetë patjetër në përputhje me planet dhe projektet hyjnore, sepse vetëm kështu mund të ndërtohet një personalitet dhe identitet që i reziston tërmetejeve.

Bota jonë, që thuhet se është e qytetëruar, po vuan! Ndërsa ne myslimanët, po vuajmë edhe më shumë. Shtëpitë tona po i rrënojmë me duart tona, mbi kokat tona. Po përpëlitemi mes rrënojave që kemi krijuar vet dhe po dëmtojmë veten dhe brezat e ardhshëm.

Dëshirojmë që Ramazanet dhe Bajramet të jenë reale dhe gëzimet të mos shndërrohen në ditë zie. Pra, le t'i themi së bashku amin lutjes së Isait (a.s.), e cila përmendet në Kuran:

“O Allah, o Zoti ynë! Zbritna një sofër nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë dhe të jetë mrekulli prej Teje! Na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë!” (Maide, 114.)

Të mos harrojmë se sofa e zbritur nga qielli, është Kurani. E rëndësishme, është të jesh i vetëdijshëm për ato mirësi që ndodhen në atë sofër dhe të festosh Bajramin në sofrën e Kuranit.

Ramazani muaji i Kuranit

— Doç. dr. Mustafa Karabaxhak —

Muaji Ramazan është muaji i Kuranit. Pra, është një muaj në të cilin ka zbritur libri ynë i shenjtë, Kurani Fisnik. **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”** (Bekare, 185) Po ashtu është shprehur qartë se në cilën natë të muajit ramazan ka zbritur libri ynë i shenjtë, Kurani: **“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se një-mijë muaj. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”** (Kadr, 1-5)

Muaji i Ramazanit në të njëjtën kohë është edhe muaji kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ia thoshte Kuranin Xhebrailit (a.s.). “I Dërguari i Allahut çdo vit ia thoshte Kuranin Xhebrailit (a.s.). Ndërsa vitin kur ka ndërruar jetë ia ka thënë dy herë.” (Buhari, Menakib, 25; Muslim, Fedail, 50; Fedailu’s-Sahabe, 98,99; Ibn Maxe, Xhenaiz, 64.)

KURANI ËSHTË I MBROJTUR NGA GABIMI

Kurani Fisnik është një libër mrekullis nisur edhe nga aspekti i fjalëve, edhe i kuptimit. Ndërkohë që mrekullitë e tjera të Hz.

Pejgamberit ishin të kufizuara me kohën, mrekullia e Kuranit është një mrekulli që i sfidon shekujt. Në këtë kontekst, ai është një libër për të cilin njerëzit e kanë të pamundur të bëjnë një të tillë. **“...Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin.”** (Isra, 88)

Kurani Fisnik është i mbrojtur nga gabimi dhe nën sigurinë e Zotit (xh.xh.): **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”** (Hixhr, 9) **“Ata që e mohojnë Fjalën Tonë përkujtuese, kur u vjen, do të dënohen rëndë. Ai është vërtet një Libër i madhërueshëm. Atij nuk mund t’i afrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”** (Fussilet, 41-42)

Në librin tonë, Kuranin është e pamundur të gjendet qoftë edhe mospërputhja më e vogël: **“A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”** (Nisa, 82)

Sado i kujdesshëm që të jetë një dijetar, mund të gabojë në librat dhe shkrimet e tij, sepse është njeri. Ky transmetim i Ebu Ibrahim Ismail ibn Jahja ibn Ismail el-Muzeni el-Misri, i cili ishte prej nxënësve kryesorë të Imam Shafiut (204/820), është

mjaft interesant: Shafiut ia kam dhënë tetëdhjetë herë librin e vet er-Rrisale për ta lexuar. Çdo herë patjetër e gjente nga një gabim. Pastaj thoshte: “Ah! Ah! Allahu nuk pranon që ndonjë libër të jetë i saktë përveç librit të Tij.” (Ibn Abidin, Muhammed Emin ibn Omer ibn Abdulaziz Abidin ed-Dimashki el-Hanefi (1252/1836), Reddu’l-Muhtar ala ed-Durri’l-Muhtar, Botimi i 2-të, I-VI, Daru’l-Fikr, Bejrut, 1412/1992, I, 27.)

Mesazhet e Allahut në Kuranin Fisnik në lidhje me çdo çështje janë dhënë në mënyrë të kuptueshme dhe janë shpjeguar. **“Në këtë Kuran, Ne u shpjegojmë njerëzve gjithfarë shembujsh, por shumica e njerëzve, kurrësi nuk duan të besojnë.”** (Isra, 89)





Në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, domethënë, në muajin e Kuranit, ata që nuk dinë ta lexojnë Kuranin duhet që sa më parë ta mësojnë leximin e tij. Kurani Fisnik duhet të përfshijë çdo moment të Myslimanit dhe duhet të lexohet vazhdimisht. Kurani duhet të gjendet mbi tavolinën e myslihanit, në xhep dhe në çantën e tij, në mënyrë që ta gjejë mundësinë dhe ta vlerësojë çdo moment. Ndërsa në muajin e Kuranit, në Ramazan duhet të preokupohemi edhe më shumë se herët e tjera me Kuranin. Kurani Fisnik është libri të cilin duhet ta lexojmë më së shumti dhe ndaj të cilit duhet të jemi jashtëzakonisht të prirë. Madje në këtë kontekst, vetë i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka paralajmëruar ata që janë preo-

kupuar më shumë me hadithet dhe nuk e ka konsideruar si të pranueshme prishjen e kësaj radhe. Malik ibn Ubade (r.a.), transmeton se Resulullahu (a.s.), ka thënë: *“Ju e keni më të nevojshme të mësoni Kuranin. Ndërkohë dëshironi të transmetoni hadithe prej meje me një oreks të madh. Krahas kësaj, për atë që e ka mësuar mirë një hadith prej meje, nuk ka ndonjë problem për ta transmetuar. Por kush shpif për mua, domethënë, kush shpif ndonjë hadith në emrin tim, le të përgatisë vendin e tij në xhehenem.”* (Buhari, Tarihu'l-Kebir, VII, 301, 302; Taberani, Mu'xhemu'l-Kebir, XIX, 296; Ramehurmuzi, el-Muhaddithul Fasil Bejne'r-Ravi ve'l-Vai, fq. 172; Ebu Zur'a, Tarihu Ebi Zur'a ed-Dimashki, fq. 268, 269.)

MË I MIRI PREJ JUSH

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka thënë: *“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson atë edhe të tjerëve.”* (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21/5027, 5028.) Hz. Pejgamberi na ka njoftuar se i jepet dhjetë sevape çdo shkronje të Kuranit Fisnik që lexohet duke u shprehur: *“Ai që lexon një shkronjë nga Kurani Fisnik ka sevapin e një mirësie. Shpërblimi i çdo mirësie është dhjetë sevape. Unë nuk po them se “elif, lam, mim” janë një shkronjë, por përkundrazi “elifi” është një shkronjë, “lami” është një shkronjë dhe “mimi” është një shkronjë.”* (Tirmidhi, Fadailu'l-Kur'an, 16/2910). Kurani Famëlartë duhet të lexohet në çdo kohë dhe çdo vend: *“Ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës* (duke thënë: *“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh* (nga çdo e metë)! *Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”* (Al Imran, 191) Abdullah ibn Mu-gaffeli ka thënë se e ka parë të

Dërguarin e Allahut (a.s.), duke kënduar suren Fet'h mbi deve përgjatë çlirimit të Mekës. (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 24/5034; Muslim, Salatu'l-Musafirin, 237/794.) Por nuk duhet ta harrojmë edhe këtë se Kurani nuk ka ardhur vetëm për t'u lexuar dhe për të fituar sevape, por për t'u lexuar, për t'u kuptuar dhe për t'u praktikuar në jetë. Poeti i famshëm Mehmet Akif Ersoji e shpreh këtë si më poshtë:

“E hapim Kuranin dhe i shohim faqet e tij,

Ose i fryjmë tokës së një të vdekuri me të,

Dijeni mirë se Kurani nuk ka zbritur për këtë,

Pra, nuk ka zbritur as për t'u kënduar te varrezat, as për të parë fallin.”


Kuranin Fisnik duhet ta lexojmë çdo ditë dhe duhet të mendojmë rreth kuptimit të ajeteve të tij. Në qendrën e jetës sonë duhet të gjendet Kurani Famëlartë.

Të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, i pëlqente kur disa sahabë e lexonin Kuranin. Njëri prej këtyre ishte Ebu Musa el-Esh'ariu. Një ditë Resulullahu (a.s.), e dëgjoji atë duke kënduar Kuran. Andaj tha për të: *“Atij i është dhënë zëri i bukur si zëri i bukur që i ishte dhënë pejgamberit Davud.”* (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 31; Muslim, Salatu'l-Musafirin, 236; Nesai, Iftitah, 83; Ibn Maxhe, Ikametu's-Salat, 176.)



Mbartja e Kuranit në jetë brenda linjës së Ramazanit dhe Furkanit

Doç. dr. Kerim Bulladë



Po përjetojmë lumturinë e arritjes së muajit në të cilin ka zbritur Kurani Fisnik i cili është burim udhëzimi dhe mëshire për të gjithë njerëzit¹ dhe në veçanti për besimtarët², të devotshmit³ dhe punëmirët.⁴ Ajo që i jep kuptim muajit të Ramazanit, krahas agjërimit, padyshim se është fillimi i shpalljes së Kuranit. Muaji i Ramazanit në një kuptim është muaji i Kuranit. Fjala “Ramazan” vjen nga rrënja “ramada-ramida” që do të thotë të djegësh dhe të digjesh.⁵ Thuhet se muajit të agjërimit i është thënë muaji i ramazanit për shkak se i djeg mëkatet me vepra të mira.⁶ Nëse mendojmë rreth kuptimeve që i jepen fjalës Ramazan, mund të themi se ato janë: “Pastrim, dëlirje dhe shkatërrim i mëkateve.” Mirë, por si do t’i djegim dhe pastrojmë mëkatet? Cilat janë metodat dhe parimet për ta bërë këtë?

Kurani Fisnik i ka shpjeguar metodat dhe rregullat e dëlirjes. Përderisa të ndiqen parimet e Kuranit dhe të Sunetit i cili është shpjegim i tij, edhe pse këto i vijnë rëndë dhe vështirë nefsit, kjo nuk është një çështje që nuk kryhet me sukses dhe shpëtimi i vërtetë fillon pikërisht me këtë. Kurani me atributin e tij “furkan” e ka dhënë recetën e shpëtimit.

Kurani Fisnik është një libër që e ndan nga njëra-tjetra të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e gabuara, të mirën nga të keqen, të bukurën nga e shëmtuara, mëkatin nga sevapi dhe haramin nga hallalli. Ai na shpjegon se cila është e drejtë, cila është e gabuar, cila është e vërtetë, cila është e pavërtetë, cila është e bukur dhe cila është e shëmtuar. Ai i deklaron, i shpjegon dhe pastaj vendos parime e rregulla në lidhje me këto çështje.⁷ Kurani këtë veçori të tij e shpjegon si më poshtë:

“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”⁸

Në ajetin e mësipërm tregohet cilësia “Furkan” e Kuranit. Fjala “furkan” do të thotë ndarës i së vërtetës nga e pavërteta. Ai e tregon në mënyrë thelbësore dhe të shkurtër rrugën e udhëzimit. Kjo synohet nga cilësia “Huden” e Kuranit Fisnik. Ndërsa me cilësinë “Furkan” tregohet rruga e udhëzimit në mënyrë të detajuar. Ai është një libër që shpjegon dispozitat e hallallit e haramit dhe që ndan të vërtetën nga e pavërteta e hallallin nga harami.

Njëri prej emrave të rëndësishëm të Kuranit është “Furkan”. Në ajetin: **“I lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Furkanin/Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.”**⁹, është theksuar në mënyrë të veçantë cilësia “Furkan” e tij.

Ajeti në vijim me emrin “furkan” të Kuranit u jep besimtarëve një rregull shumë të rëndësishëm: **“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë...”**¹⁰ Domethënë, zemrave tuaja u jep një dritë dhe aftësi më

të cilat mund ta ndajnë të vërtetën nga e pavërteta. Kelamull-llahu (Kurani) është quajtur “Furkan” ngaqë e ndan të vërtetën nga e pavërteta në itikad (besim), të drejtën nga mashtrimi në fjalë dhe të mirën nga të keqen në vepra. Fjalës “furkan” i është dhënë edhe kuptimi shpëtim, sepse njerëzit me Kuranin arrijnë të shpëtojnë nga errësirat e devijimit.

E drejta nga e gabuara, e bukura nga e shëmtuara dhe e mira nga e keqja janë ndarë me urdhrat, ndalesat, deklaratimet dhe shpjegimet e Kuranit Fisnik. E vërteta ka dalë në pah si dielli me parimet dhe rregullat që ka vendosur ai (Kurani). Me cilësinë “Furkan” të Kuranit është bërë krejt e qartë se cilat parime dhe principe do ta shpjen njerëzimin drejt lumturisë dhe se cilat rregulla e ligje do t’i shpjen individët, familjet dhe popujt drejt paqes, qetësisë, sigurisë dhe lumturisë. Urdhrat hyjnore që Kurani ia ka shfaqur njerëzimit janë aq të qarta dhe të kuptueshme saqë një shpjegim dhe qartësim të tillë nuk mund të gjendet në asnjë fe, ideologji apo filozofi. Në lidhje me këtë çështje Kurani Fisnik ia shpall në një formë të prerë mesazhin e tij të gjithë njerëzimit: **“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!..”**¹¹

Muaji i Ramazanit është muaji i Furkanit/Kuranit. Besimtari që i beson dhe është i lidhur me Kuranin, falë “Furkanit” në këtë muaj arrin një fuqi më të madhe dalluese në krahasim me muajt e tjerë. Kurani i përket Allahut nga aspekti i fjalës, kuptimit, shpjegimit dhe sistemimit. Sigurisht që do të lexohen edhe fjalët e Kuranit. Të thuash se nuk ka kuptim, sepap dhe shpërblim të lexuarit e fjalëve të Kuranit edhe pse kanë ardhur shumë ajete e hadithe në lidhje me këtë çështje, nuk është e drejtë. Nëse fjala, kuptimi, shpjegimi dhe sistemimi i përkasin Atij (Zotit), atëherë këtu robërve nuk u takon të thonë asnjë fjalë. Por të mos harrojmë se Kurani Fisnik nuk është dërguar vetëm për t’u kënduar. Ai është dërguar për t’u siguruar njerëzve lumturinë në këtë botë dhe në botën e përtejme. Ai është libër i dispozitave. Ai ka sjellë parime edhe për sistemimin e jetës së kësaj bote, edhe për fitimin e botës tjetër. Ai nuk është një libër që flet vetëm për të kaluarën. Ai është një libër që e sistemon edhe të tashmen dhe të ardhmen ndërkohë që thekson se duhet të merret mësim nga e kaluara. Atëherë, ne si besimtarë falë cilësisë “furkan/dalluese” që na ka dhënë Kurani kemi një detyrë të shenjtë si dëlirja, sistemimi dhe edukimi i nefsit tonë, familjes sonë, umetit të Muhamedit dhe i gjithë njerëzimit me rregullat e parimet e tij.

Kurani e ka theksuar si më poshtë se qëllimi i zbritjes së tij është që njerëzit e mençur të mendojnë rreth ajeteve të tij dhe të marrin mësim nga ato: **“Ky (Kurani) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatuar mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.”**¹²

Në këtë ajet gjendet argumenti se Allahu Teala e ka zbritur Kuranin jo vetëm që të këndohet pa me-

nduar rreth tij, por për të menduar e medituar rreth kuptimeve të tij.¹³ Ajëtit që sapo e përmendëm më sipër i janë dhënë kuptime të ndryshme. Fjalja “për të përsiatuar mbi vargjet e tij” është kuptuar në formën “për të zbatuar urdhrat dhe ndalesat e tij”. Sipas Fahrudin Razit, ai që nuk mendon, nuk mediton dhe nuk e arrin marrjen e suksesit nga Zoti, nuk mund t’i njohë të fshehtat magjepsëse të cilat janë përmendur në Kuranin Famëlartë.

Sahabët e nderuar në vitet e para të Islamit nuk e kuptonin mësimin përmendësh të Kuranit Fisnik siç ndodh në ditët e sotme. Ata i mësonin dispozitat e ajeteve që i memorizonin dhe përpiqeshin për t’i praktikuar në jetën e përditshme. Informacioni që do të japim më poshtë është shumë e rëndësishëm nga aspekti i metodave që përdornin, ndiqnin dhe u jepnin përparësi sahabët e nderuar në lidhje me të kuptuarit e Kuranit.

Ibn Mes’udi (v. 32/652) dhe Ubej ibn Ka’bi (v. 19/640) transmetojnë se i Dërguari i Allahut (a.s.), u jepte atyre dhjetë ajete për t’i mësuar. Ata nuk kalonin te dhjetë ajete të tjera pa i mësuar dispozitat e dhjetë ajeteve të para dhe pa i praktikuar ato. Resulullahu (a.s.), atyre bashkë me mësimin e Kuranit, u mësonte edhe të punuarit me Kuranin. Abdurrahman es-Sulemi (r.a.), transmeton: “Kur mësonim dhjetë ajete nga Kurani, nuk kalonim te mësimi i dhjetë ajeteve të tjera derisa t’i mësonim urdhrat, ndalesat, hallallin dhe haramin që përfshinin dhjetë ajetet e para.” Imam Maliku (v. 179/795) në veprën e tij me titull Muvatta thotë: “Sipas lajmit që më ka ardhur mua, Abdullah ibn Omeri (v. 73/692) është preokupuar tetë vjet me mësimin e sures Bekare.” Gjithashtu Imam Maliku transmeton se Omeri (r.a.), e ka mësuar suren Bekare për dymbëdhjetë vjet. Kur e ka përfunduar, ka therë një deve prej gëzimit. Ndërsa Abdullah ibn Mes’udi (r.a.), ka thënë: “Neve na dukej i vështirë mësimi përmendësh i fjalëve të Kuranit, por na dukej i lehtë zbatimi i tyre. Ndërsa atyre që kanë ardhur pas nesh po u duket i lehtë mësimi përmendësh i Kuranit dhe i vështirë zbatimi i tij.”

Siç shihet qartë, sahabët e nderuar i kanë mësuar bashkë fjalët dhe kuptimet e Kuranit Fisnik. Pastaj i kanë zbatuar menjëherë në jetë ato. Ata i kanë dhënë më shumë rëndësi zbatimit të Kuranit sesa këndimit të tij. Andaj edhe ne si myslimanë të paktën në muajin e Ramazanit le të përpiqemi ta kuptojmë Kuranin me fuqinë e emrit “Furkan” që na ka dhënë. Le të përpiqemi për ta bërë atë një libër që e zbatojmë në jetën tonë me begatinë e muajit të Ramazanit. Le të kërkojmë metodat për ta kuptuar se çfarë dëshiron të thotë dhe çfarë kërkon prej nesh.

Referencat: 1. Shik. Bekare, 185. / 2. Shik. Junus, 57. / 3. Shik. Bekare, 2. / 4. Lukman, 3. / 5. Ragib el-Isfahani, Mufredatu Elfadhi'l-Kur'an, korrektoi Safuan Andan Davudi, Bejrut, Daru'l-Kelam, fq. 366. / 6. Shevkan, Muhammed b. Ali b. Muhammed, Fet'hu'l-Kadir el-Xhamiu bejne Fenneji'r-Rivajeti ve'd-Dirajeti min Ilmi't-Tefsir, Tas'hih, Ahmed Abdusselam, Bejrut, 1994, I, 228. / 7. Kerim Bulladë, Kur'an Kendisini Nasil Tanitir; Botimet Kajëhan, Stamboll, 2010, fq. 31. / 8. Bekare, 185. / 9. Furkan, 1. / 10. Enfal, 29. / 11. Bekare, 256. / 12. Sad, 29. / 13. Shevkani, vepra e lartpërmendur, IV, 537.

Thurja e imagjinatave të përherëshme në një botë të përkohshme

— Raif Koçak —

Allahu Teala, i Cili ka krijuar tokën, qiejt, universin dhe të gjitha krijesat e tjera, ka krijuar edhe njeriun në mënyrë që ky i fundit ta njohë, t'i nënshtrohet dhe ta adhurojë Atë, nëpërmjet rrugës së marifetullahut, domethënë, njohjes së Allahut. Njeriut i ka dhuruar edhe mirësinë e mendjes dhe të vullnetit, si një privilegj kundrejt krijesave të tjera. Zoti (xh.xh.), si domosdoshmëri e e kësaj dhurate, dëshiroi ta sprovonte njeriun. Kështu që e dërgoi në këtë botë.

Ndërkohë që kjo botë dhe mirësitë që gjenden në të, janë mundësi që do të vazhdojnë deri në frymën e fundit për ata që besojnë se kjo botë është e përkohshme dhe vend i sprovimit, ndërsa për ata që nuk besojnë, janë veç rast për të prishur e shkatërruar.

Allahu Teala i ka dhënë njeriut shumë mundësi dhe mirësi, së bashku me disa veçori që nuk ua ka dhënë krijesave të tjera. Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut veçori që do ta mbajnë atë në jetë dhe që do ta bëjnë të përpiqet e të luftojë. Të tilla janë mendja, vullneti, zgjuarsia, zemërimi dhe egoizmi.

Njeriut, të cilin e ka çuar për ta sprovuar, i ka dërguar Librat për ta njoftuar në lidhje me rregullat që duhet të zbatojë, dhe peygamberë për t'ia shpjeguar e për t'ia dëshmuar mënyrën e të zbatuarit të këtyre librave. Njeriut i ka dhënë vullnetin, në mënyrë që t'i pasojë këta libra dhe peygamberët.

Allahu (xh.xh.), do vërejë nëse njeriu do t'i përdorte këto mundësi dhe mendjen, në punët për këtë botë, apo në punët për botën tjetër. Gjithashtu, do vërejë nëse fuqinë, emocionin dhe përpjekjen do ta përdorë për të mbajtur në këmbë të vërtetën dhe drejtësinë, apo për të bërë padrejtësi e zullum. Do vërejë nëse trupin, rininë, energjinë dhe kohën që ia ka dhuruar, do t'i përdorë për hir të Tij apo do t'i përdorë për interesat


vetjake. Do vërejë se si do t'i përdorë njeriu pasurinë dhe mundësitë. Do vërejë nëse këto do t'i ndajë me njerëzit e tjerë apo do të kaplohet nga pasioni për të mbledhur pasuri dhe do ta shkatërrojë jetën duke e ditur se kur të vdesë nuk mund të marrë me vete qoftë edhe një qindarkë.

Shkurtimisht, çdo mirësi dhe çdo gjë tjetër që i është dhënë njeriut në këtë botë, i është dhënë si provë për të cilën do të japë llogari në ditën e Tubimit. Allahu Teala e ka përforcuar këtë të vërtetë me këtë ajet fisnik: **"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë"** (e kësaj bote!) (Tekathur, 8.)

Po ashtu, edhe në një ajet tjetër na e ka shpjeguar se çfarë është jeta e kësaj bote duke thënë: **"Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."** (Hadid, 20.)

Sa përpjekje e pamend do të ishte mundimi i njeriut për të qëndruar gjithmonë në këtë botë, ndërkohë që e di se edhe jeta që i është dhënë është e përkohshme pikërisht si të gjitha mirësitë e tjera që nuk mund të numërohen. Njeriut nuk i mjafton si mësim as vdekja e gjyshërve apo e të afërmve të tij.

Përgjatë fëmijërisë kemi luajtur me "paratë" që shokët tanë i bënin prej gjetheve të pemëve



apo prej letrave të gazetave. Me to ne blinim objekte të tjera të cilat i përgatitnim për lojë. Në këtë mënyrë, e kalonim kohën deri në mbrëmje. Kur në mbrëmje shkonim në shtëpi, as paratë, as mallrat që blinim, nuk kishin më vlerë, sepse nuk ishin të vërteta. Ja pra, edhe kjo botë është vendi i humbjes së kohës së shkurtër në të cilën inskenohet një lojë e tillë. Edhe në një ajet tjetër përmbledhet kështu jeta e kësaj bote:

“Njerëzve u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.” (Al ‘Imran, 14.)

Njeriu asnjëherë nuk dëshiron t’i merren apo t’i hiqen mirësitë që posedon. Ai dëshiron që mirësitë që ka, të mbeten përgjithmonë të tijat, dhe preferon të bëjë një jetë të përhershme. Dikush përpiqet me çdo çmim për të mbrojtur pasurinë dhe pronat, dikush përpiqet për të ruajtur fëmijët dhe dikush tjetër përpiqet për të ruajtur udhëheqjen, famën apo bukurinë e trupit. Këta lloj njerëzish nuk e kuptojnë se një përpjekje e tillë është krejt e pavlefshme.

Hazreti Mevlana u drejtohet në këtë formë atyre që mashtrohen ndaj joshjeve të përkohshme të kësaj bote: “O ti që i shikon e i lakmon gjellët me vaj e mjaltë dhe ushqimet e shijshme! Çohu, shko në banjë dhe shikoje përfundimin e tyre! Pastaj, thuaj papastërtisë që gjendet aty: ‘Ku është bukuria, shija dhe aroma e këndshme që kishe në pjatë?’ Ajo do të të përgjigjet: ‘Ato që ti përmende ishin gonxhe. Ndërsa unë isha një kurth i kurdisur. Pasi ti erdhe dhe re në kurth, gonxhet u vyshkën, u prishën dhe u thanë.’”

Ai që dëshiron të arrijë në destinacion, nuk fle në stacion.

Kjo botë për ne është si hija e një peme nën të cilën ulemi për të pushuar dhe kalojmë pak kohë kur lodhemi, ndërkohë që po shkojmë nga një vend për në një vend tjetër. Ne nuk do të fitojmë gjë nëse do të argëtohemi në një vend ku do të rrimë vetëm pak. Ky veprim vetëm sa do të na lërë të privuar nga destinacioni ku dëshironim të arrinim dhe të eksploronim.

Sa bukur që e shpreh këtë të vërtetë Imam Shafiu:

“Mendja nuk e pranon që karvanët të ndërtojnë shtëpi përgjatë udhëtimit.”

Kjo jetë e përkohshme është një stacion në rrugën që shkon drejt Jetës së Përhershme, domethënë drejt Botës së Përtejme. Argëtimi, kalimi i kohës dhe dëshira për të qëndruar në stacion, nuk i sjell asgjë njeriut, përveç pendimit. Herët apo vonë, çdo njeri do të shpërngulet për në Botën e Përhershme, duke kaluar nëpërmjet derës së vdekjes. Atëherë, të përgatiturit dhe përpjekja për Jetën e Përhershme, do të ishin investimet më fitimprurëse për çdo njeri të mençur.

Njeriu i mençur duhet ta vlerësojë në mënyrë të mirëfilltë jetën e shkurtër që i është dhënë, si një kapital i madh edhe për këtë botë, edhe për Botën e Përtejme. Kapitalin duhet ta përdorë jo për punë të pavlera, por

për të pasuruar jetën e Botës së Përtejme, e cila është e përhershme.

Jeta e kësaj bote, e cila është sa një pikë ujë në oqean kundrejt Botës së Ahiretit, është një mundësi e vyer që nuk ia vlen të mbetet vetëm si çast ndërmjet djepit dhe varrit.

Qefini, i cili është rroba më e fundit e jetës sonë të përkohshme, një ditë patjetër do ta mbështjellë çdo njeri të pasur apo të varfër, të lartë apo të përçmuar, dijetar apo injorant. Për këtë arsye, jemi të detyruar që ta vlerësojmë në mënyrë sa më të volitshme kohën që fillon nga djepi dhe që mbaron te petku ynë i fundit. Sepse, pasi ta veshim rrobën tonë të fundit, nuk do të kemi mundësi për t’u penduar e për t’u kthyer pas. Bazuar në këto që thamë, jemi të obliguar të japim përgjigjet më të përshtatshme ndaj pyetjeve që do të na bëhen Ditën e Gjykimit dhe të pajisemi me të gjitha veprat e vlerat që do të na nevojiten atje.

Fundi i jetës së kësaj bote do të jetë varri prej dy metrash edhe nëse kemi jetuar në saraje, në vilë apo në ndonjë barakë prej dërrasash. Sa bukur e shpreh i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, me këtë hadith fisnik, pavlefshmërinë e jetës së kësaj bote kundrejt jetës së Ahiretit:

“Kjo botë, në raport me Botën e Përtejme, i ngjan zhytjes së gishtit të dikujt prej jush në det. Le të shikojë ky person se sa pak ujë mban gishti.” (Muslim, Xhenet, 55.)


Ajo që quhet jetë, një ditë do të marrë fund. Njeriu do t’u japë lamtumirën të gjitha pasurive, pronave, pozitës, salltanetit dhe njerëzve të tij dashur. Pra, jeta jonë është një sprovë që do të përfundojë me hyrjen në varr.

Nisur nga këto që thamë, kohën e kufizuar dhe të vyer përgjatë këtij sprovimi, duhet ta vlerësojmë duke bërë vepra që do të na ndihmojnë në Jetën e Përhershme. Prandaj, duhet të kryejmë sa më shumë të jetë e mundur prej veprave të pranuarra te Zoti (xh.xh.). Hz. Xhunejdel-Bagdadi, i cili është njëri prej të mëdhenjve tanë në këtë rrugë, në lidhje me këtë çështje thotë:

“Një ditë e kësaj bote është më e mirë se një mijë vjet të Botës së Përtejme, sepse, në një ditë të kësaj bote gjendet mundësia për të fituar Kënaqësinë Hyjnore. Ndërsa në Botën e Përtejme nuk kemi mundësi të bëjmë vepra të mira dhe të fitojmë. Atje bëhet vetëm përllogaritja e veprave të kësaj jete.”

Përfundimisht, kjo jetë ka kohën dhe kufijtë të përcaktuar. Çdo vepër që bëjmë, merret në regjistrim deri në detajin më të vogël të saj. Të gjitha këto regjistrime, një ditë do të na jepen për t’i lexuar. Atëherë, le të veprojmë me zgjuarsiri dhe të mos e ndërrojmë jetën e përhershme me jetën e përkohshme.

Allahu (xh.xh.), na bëftë të gjithëve prej atyre që e mbjellin siç duhet arën e kësaj bote dhe që vjelin në Botën tjetër mirësi të shumta prej atyre që kemi mbjellë!



Një udhëtim me Sheherazaden

(PJESA E PARË)

— Nuredin Nazarko —

Njeriu është njeri pavarësisht kohës dhe hapësirës. Në çdo cep të lëmshit të dheut e shqetësojnë dhe e gëzojnë po të njëjtat gjëra. Ka të njëjtat dilema. Kërkon të njëjtat përgjigje. Përpiqet të arrijë atë që dëshiron apo ëndërron. Rend pas gjithçkaje derisa të lërë pas gjithçka dhe të marrë me vete në udhëtimin pa kthim veprat e veta.

Në një nga ecejaket e përditshme takova Sheherazaden. Fama e saj është e përhapur anembanë botës. Megjithatë u tregua kaq zemërbutë dhe e lirshme për të më rrëfyer mësimet e thella mbi jetën dhe sfidat e saj, saqë më habiti e më la pa mend. Një vajzë kryeveziri, e lakmuar nga shumë syresh, shfaqet kaq e thjeshtë dhe kaq pranë realitetit jetësor, pa hundëpërpjetësi, arrogancë, krenari të sëmure mbi origjinën dhe pozitën që gëzonte. Kjo thjeshtësi, krejt njerëzore dhe e pandotur, ndoshta është edhe sot vlere më e madhe e kësaj femre të shquar anembanë lëmshit të dheut. Një model i shquar jo vetëm për femrat.

U bë shkas një ngjarje aspak e kapërdishme mes dy vëllezërish mbretër që të shfaqej Sheherazadja, në të kundërt as që do ta kisha takuar në kohën dhe hapësirën ku gjendem tash sa kohë.

Dy vëllezërit mbretër, edhe pse me pasuri të

shumta, fuqi të madhe dhe të drejtë me popullin, tradhtinë më të madhe e pësuan nga bashkëshortet e tyre. Fatkeqësia që u ra mbi kokë i dëshpëroi pa masë. U preu fuqitë. I bindi se në këtë botë nuk paska vlerë asgjë, përballë tradhtisë së njeriut të afërt. Kësisoj braktisën mbretëritë dhe vendosën të jetonin si njerëz të zakonshëm, për të harruar brengat dhe dëshpërimin e përmbysjes së gjithçkaje vetëm nga një akt i vetëm besëthyes.

Teksa endeshin larg viseve që dikur i qeverisnin me madhësi të drejtësi, ndeshën në krijesa me fat më të keq se i tyri. Për rrjedhojë u bindën se asgjë nuk mund të barabitet me dinakërinë e grave. Morën vendim dhe u kthyen në pallatin e vëllait të madh, tek i cili u ndez ndjenja e hakmarrjes ndaj tradhtisë së kryer. Urdhëroi ekzekutimin e mbretëreshës dhe të gjithësa ishin përfshirë në këtë besëthyerje. Dhe për t'i shpëtuar tradhëtive që mund të pësonte vendosi që të martohej në darkë dhe të nesërmen të ekzekutonte bashkëshorten e radhës.

Për shkak të një besëthyerje qeverisja në mbretëri u përmbys. Nga qeverisje e drejtë, tani një makth për këdo që kishte vajza në moshën e martesës. Kur mbreti sundonte me drejtësi njerëzit luteshin dhe e bekonin sundimin e tij. Tani e mallkonin

dhe dëshironin të përmysej një orë e më parë ky mbret mizor. Dhe në mes kësaj mizorie shfaqet Sheherazadja, e hijshme, e bukur, inteligjente dhe e guximshme. Prej një femre mynxyra kishte push-tuar mbretërinë. Prej një femre mbretëria mund të rikthehej në ditët e saj të begata.

Vetëm një mendje e zgjuar, zemër inteligjente dhe shpirt i madh si i Sheherazades mund të merrte nismën e guximshme për të zgjidhur me mençuri dhe urtësi situatën. Pranoi me vetëdije të plotë, vullnet të lirë dhe në kundërshtim me babin e vet, kryevezirin e mbretërisë, të bëhej kurban i shpëtimit të femrave në mbretërinë ku jetonte. Për të zgjidhur gjendjet e vështira duhet kthjelltësi, inteligjencë dhe guxim për veprim, të shkruara në një të vetme. Prej këtij guximi pata fatin e mirë të takoja këtë femër të shquar, mësimet e së cilës janë të vlefshme si për lindjen ashtu dhe për perëndimin. Si për jugun ashtu dhe për veriu.

Bota gjithmonë ka njohur njerëz të pasur, me autoritet dhe famë edhe si shkak i pasurisë, po edhe si shkak i bamirësive që kryenin. Edhe kjo shtresë nuk i shpëton dot lakut të jetës, të papriturave të saj. Ndodh që gjërat e vogla të bëhen shkak për fat-keqësi të mëdha, nëse tregohemi të pavëmendshëm ndaj veprimtimit të tyre.

Vdekja është e sigurt. Nëse njeriu e di që do të shkojë drejt saj pakthyeshmërisht atëherë duhet t'i japë rëndësi punëve sipas peshës dhe vlerës së tyre. Po kështu, njeriu bën mirë të shkruajë testamentin e pasurisë me drejtësi, që pas vetes të mos lërë grindje, konflikte mes pasardhësve apo të afërmeve për pjesën që u takon. Duhet respektuar drejtësia që askush të mos ndihet i veçuar, i harruar apo i nëpërkëmbur. Jo pak herë ndarjet e padrejta të pasurisë kanë shkatërruar lidhjet e gjakut apo ato shoqërore.

Nëse njeriu shkon i bindur se vdekja po i afrohet nga çasti në çast, mirëpo nuk është çasti që njeriu e mendon si të tillë, atëherë përtej mendimit vetjak të njeriut vdekja nuk ka për t'i ardhur kur ai e mendon. Do të vijë pikërisht në çastin e duhur. Kësisoj do të ndodhin ngjarje të cilat do të të shtyjnë më tej në rrjedhën e jetës, ashtu sikundërse nuk e kishe imagjinuar kurrë më parë. Përtej sigurisë njeriu bën çmos që t'i ikë dhe largohet sa më shumë vdekjes, duke mos e kuptuar se ecën në ato rrugica që do ta nxjerrin pikërisht në rrugën ku vdekja e pret në takim.

Njeriu është qenie e paparashikueshme. Kurrë nuk i dihet ç'mund të ndodhë me gjendjen shpirtërore. Të qepet si rrodhe për të të mbushur mendjen të bësh një të mirë dhe kur sheh se kanë ardhur shumë të mira prej asaj të mire mund të shndërrohet në smirëzi. Nga smirëzi mund të shndërrohet edhe

në kriminel. Smira është një nga gjendjet më të rrezikshme për njeriun. E udhëheq nga një e keqe në tjetrën dhe asnjëherë nuk e lejon skllavin e vet të gjejë qoftë edhe pakëz paqe. Kush ndez zjarrin e smirës brenda vetes ka marrë fund me gjithësa. Pasojat mund të jenë fatale edhe sikur të rrojë një mijë vjet, sepse pasojat nuk janë fatale vetëm kur njeriu vdes fizikisht. Po kështu duhet të bëjmë kujdes prej njerëzve smirëzinj. Të mos japim shkas që smira që kanë përbrenda t'u errësojë sytë edhe më. Duhet të jemi të kthjellët, të pastër në zemër, që intuita të njohë edhe shpërfaqjet më të vogla të smirëziut. Gjendja bëhet edhe më e rëndë kur smira ndizet midis njerëzve që kanë lidhje gjaku, familjare apo fisnore. Por gjithmonë ka rrugëdalje. Të bërit mirë. Të qenit zemërpastër. Këto janë ndihmëtare për njeriun edhe atëherë kur gjendja duket e pashpresë. Përtej vështirësive të qëndrojmë besnikë të virtyteve.

Varfëria është një nga provat më të rënda për njeriun. Për karakterin e tij. Frika prej saj e mban njeriun në ankth të vazhdueshëm. Vazhdimisht njeriu është i shqetësuar se ç'mund të ngjasë me të nëse një ditë krejt papritur varfërohet. Kësisoj çdo ditë rend pas pasurisë, duke kujtuar frikën nga varfëria. Kjo frikë mund ta shndërrojë në koprrac, dorështrënguar dhe mosndihmues ndaj nevojtarëve. Varfëria e shtyn njeriun të mallkojë fatin e vet të keq. E quan veten të pafat, ndërkohë që e krahason me ata që rrojnë më gjithë të mirat edhe pse mund të jenë të ligj e të pandershëm. Është gjendje e pashmangshme nëse je peng i kuptimeve sipërfaqësore. Për t'i shpëtuar këtij kurthi duhet të synosh kuptimet thelbësore, sepse kështu shpëton prej dëshpërimit të mospasjes. Shpëton sepse e kupton se këto janë gjendje kalimtare, dhe ajo çfarë mbetet me njeriun është ajo çfarë vjen dhe nuk humbet në honin e së shkuarës. Ankesa ndaj varfërisë së të ndershmëve, duke patur si kundërpeshë matëse bollëkun e të pandershmëve ngjall pesimizëm tek të drejtët, të ndershmit. Për rrjedhojë njeriu gjendet përballë një tundimi tepër të rrezikshëm; të vazhdojë të jetojë i ndershmë edhe pse i varfër, apo ta hedhë tej ndershmërinë dhe të përmirësojë jetën materiale shpejt e shpejt. Varfëria rrjedhon me mungesa dhe pamundësi për jetë të qetë, por ata që njohin thelbin e dinë se kjo është thjesht çështje kohe dhe për më tepër qetësia në këtë botë nuk ka zbritur dhe as nuk zbrit as tek ata që notojnë mes pasurish. Prandaj nuk duhet nxituar në fjalë për atë që fati ka parandarë për ty, sepse ngjarjet sillen në atë mënyrë që t'i të mbërrish aty ku është më e mira për jetën tënde. Dhe njeriu e ka të pamundur të dijë në thelbin e vet se çfarë realisht është më e mira për jetën e tij.



Veçoritë e atyre që garojnë në mirësi

— Khafer Durmush —

Qëllimi themelor në Kuran, është orientimi i njeriut drejt së mirës, së bukurës dhe së drejtës dhe pengimi i tij prej së keqes, së shëmtuarës dhe së pavërtetës. Për rrjedhojë, në Kuranin Famëlartë gjenden shumë ajete që nxisin për garë në mirësi dhe devotshmëri.¹ Një prej këtyre ajeteve është në suren Mu'minun, ku urdhërohet: ***“Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre, që besojnë në shpalljet e Zotit të tyre, që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre, dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët. Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësive të tij; te Ne është Libri që flet të vërtetën dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi.”***²

Këto ajete të shenjta, na prezantojnë me katër virtyte të bukura të besimtarëve që nxitojnë gjithmonë në punë të mira. I pari prej këtyre virtyteve, është lidhja e tyre e fortë me Zotin me ndjenja të larta respekti dhe dashurie. Për këtë arsye, ata qëndrojnë larg të këqijave dhe përpiqen të mos bëjnë asgjë në kundërshtim me pëlqimin e Tij.

Virtyti i dytë, është besimi absolut që kanë ndaj Fjalës së Allahut. Pra, ata nuk i kundërshtojnë kurrë

ajetet e Kuranit dhe, duke e pranuar si një të tërë, përpiqen të punojnë vazhdimisht me të.

Virtyti i tretë, është se ata nuk i shoqërojnë asgjë Allahut. Ata jetojnë çdo çast me vetëdijen se Allahu i Madhëruar nuk ka ortak apo të ngjashëm në asnjë aspekt. Ndërsa adhurimet i kryejnë me sinqeritet dhe larg çdo dëshire për t'u dukur.

Virtyti i katërt dhe më i rëndësishmi, është se ata çdo punë e bëjnë duke menduar se një ditë do të japin llogari para Allahut të Madhëruar. Po ashtu, ata jetojnë të shqetësuar nga frika se mos nuk ju pranohen mirësitë që kanë bërë. Me këtë vetëdije, ata japin zekatet dhe sadakatë e tyre, ose i dorëzojnë të zotëve amanetet që u kanë besuar atyre. Po ashtu, me këtë vetëdije vrapojnë edhe drejt punëve të mira.³

Siç theksohet edhe në komentimin e këtyre ajeteve, ata që i zotërojnë të katërta këto virtyte njëherësh, tregohen shumë të shpejtë në bërjen e punëve të mira, duke u përpjekur të shtojnë veprat



e mira pa u ardhur vdekja. Jetën dhe mundësitë që u janë falur, i konsiderojnë si mirësitë më të mëdha. Për këtë arsye, ata përpiqen t'i shfrytëzojnë këto në mënyrën më të mirë.

Nëna jonë Aisha (r.anha.), duke dashur të kuptonte më mirë domethënien e ajetit, **“kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre”**⁴, e pyeti të Dërguarin e Allahut (a.s.): **“A e ka fjalën për ata që konsumojnë alkool dhe vjedhin?”** I Dërguari i Allahut (a.s.), tha: **“Jo! Këta janë njerëz që agjërojnë, falin namaz dhe japin sadaka. E megjithatë, duke pasur frikë se mos nuk u pranohen mirësitë, ata shpejtojnë në vepra të mira.”**⁵

Këto ajete fisnike dhe fjalët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i nxisin besimtarët të shpejtojnë në punë të mira sa kanë ende mundësi. Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka këshilluar të shfrytëzojmë shtatë mirësi pa ardhur shtatë pengesa, të cilat janë: **“Varfëria që të bën të harrosh adhurimet dhe bindjen ndaj Allahut, pasuria që të devijon nga rruga e Allahut, sëmundja që të shkatërron gjithçka, pleqëria që të bën të flasësh përçart, vdekja që të vjen papritur dhe ardhja e më të këqijave që pritet, Dexhallit dhe Kiametit.”**⁶

Një çështje tjetër që kuptohet këtu, është se; të gjitha urdhëresat dhe ndalesat në Kuran dhe sunnet, janë brenda mundësive njerëzore. Allahu i Madhëruar nuk i ka ngarkuar njeriut asgjë përtej mundësisë që ka dhe i ka motivuar besimtarët të veprojnë më në mënyrën më të mirë brenda mundësive që kanë.⁷

Në fakt, nuk ka asnjë standard për të përcaktuar mundësitë dhe aftësitë e gjithëve. Për këtë arsye, gjithkush duhet ta përcaktojë vet se sa dhe çfarë mund të bëjë, duke u orientuar nga punët e mira dhe të dobishme.

Hasan Basriu thotë:

“Besimtar i mbledh mirësi dhe frikë (ndaj Allahut). Me shtimin e mirësive, i shtohet edhe frika. Kurse mohuesi mbledh të këqija dhe siguri. Me shtimin e të këqijave i shtohet edhe ndjenja e sigurisë.”

Me pak fjalë; garimi në punë të mira dhe pamjaftueshmëria me to, është nga veçoritë më të spikatura të besimtarit. Mirëpo, më e rëndësishmja ndër to është dridhja e zemrës duke menduar pronarin e vërtetë të gjithçkaje, Allahun e Madhëruar dhe qëndrimi larg ndjenjave të tilla si, “unë e bëra, unë e dhashë”.

Referencat:

1. shih. Al-i Imran, 96; Maide, 2; Muxhadele, 9; Bekare, 189. / 2. Mu'minun, 57-62. / 3. Omer Nasuhî Bilmen, Kur'an-ı Kerim'in Türkçe Meâl-i Âlîsi ve Tefsiri, Kahraman Yayıncılık, c. 5, s. 2287. / 4. Mu'minun, 60. / 5. Tirmidhi, Tefsir 23/4. / 6. Tirmidhi, Zuhd, 3/2306. / 7. shih. Mulk, 2.



SPROVA E LUMIT

Në ajetin 249 të sures Bekare, urdhërohet: **“Kur Taluti u nis për luftë bashkë me ushtrinë, u tha atyre: «Allahu do t'ju provojë me një lumë. Kush pi ujë në të, nuk është ushtari im. Ndërsa kush nuk pi ujë në të ose kënaqet vetëm me një grusht ujë, është ushtari im.» Por të gjithë pinë, përveç një pakice...”**

Ky ajet fisnik na mëson se; Allahu mund t'i sprovtojë robërit e Vet para se t'i ngarkojë me detyra që kërkojnë përgjegjësi të rëndë. Për këtë arsye, Ai mund t'i ndalojë për njëfarë kohe disa gjëra që normalisht janë të lejuara në kohë dhe vende të tjera -siç është agjërimi-. Duke u nisur nga kjo, mund të themi se; nëse është e nevojshme, edhe ata që kanë pozita drejtuese, mund t'i sprovtojë vartësit e tyre.

Ata që i binden plotësisht urdhrit të dhënë, edhe pse nuk arrijnë ta kuptojnë urtësinë e tij në momentin e parë, dalin me sukses nga sprova. Ndërsa ata që përdorin si justifikim nevojën dhe e shkelin urdhrin e përkohshëm, e humbasin sprovën. Për rrjedhojë, në vazhdim të ajetit të kësaj teme, ata që pinë ujë nga lumi si të etur thanë; **“...Ne sot nuk kemi fuqi të luftojmë me Xhалutin dhe ushtrinë e tij...”** Kjo tregon se ata, edhe pse u mashtruan nga dëshira e egos së tyre, përsëri nuk u ngopën me ujë. Ndërsa ata që respektuan urdhrin dhe nuk pinë ujë, ose pinë vetëm aq sa u lejuan, thanë; **“...Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit!”** Në këtë mënyrë, ata treguan se ishin në gjendje të përballonin edhe detyrat më të vështira.

Nga kjo, kuptohet se dorëzimi dhe bindja e plotë, e pjek njeriun. Ndërsa mos kënaqja me atë që i jepet dhe nxitimi, e ul vlerën e tij.



Nevoja

për një muaj të veçantë

— Romeo Ismahilaj —

Jeta e çdo njeriu përshkohet nga ngjarje dhe gjendje të cilat vazhdimisht i ndodhin secilit prej nesh. Në varësi të asaj që përjetojmë dhe besojmë, përcaktohen edhe qëndrimet tona karshi të ardhmes. Të gjithë njerëzit, pavarësisht besimit apo identitetit të tyre, përpiqen t'i shmangen monotonisë dhe situatave të plogështa të jetës në mënyra të ndryshme. Por, përpjekjet e një kategorie njerëzish dhe pritshmëritë që ata ndërtojnë nëpërmjet punës dhe besimit dallojnë prej përpjekjeve dhe pritshmërive të shumë e shumë njerëzve. Kjo kategori është pikërisht kategoria e besimtarëve myslimanë, të cilëve besimi iu ka fromuar në shpirtira burime shprese që freskojnë ndjeshëm ndërgjegjjen dhe vizionin e tyre. Ata besojnë se shpirti edhe trupi kanë nevojë të madhe për një muaj të veçantë për të gjetur harmoninë dhe për të përcaktuar ekuilibrat. Ramazani shënon një periudhë të veçantë në jetën e myslimanëve, periudhë e cila dallohet për kushtet mjaft të favorshme të edukimit dhe përtëritjes si edhe përmasat privilegjuese të adhurimeve përgjatë tij.

Adhurimet në Islam kanë rol të madh në kultivimin e vlerave të larta tek njeriu. Tek secili adhurim fshihen urtësi të shumta të cilat shkaktojnë shëndërrimin e gjendjes së brendshme dhe të jashtme të besimtarit. Mirëpo, edhe parimisht, edhe praktikisht adhurimet zotërojnë shkallë të ndryshme të vlerës dhe ndikimit. Namazi i falur në shtëpi nuk gëzon vlerën e namazit me xhemat, sikurse adhurimet e kryera në xhaminë e Haramit (Kible) kanë vlerë më të madhe se sa adhurimet e kryera në vende

të tjera. Po ashtu edhe gjatë muajit të Ramazanit, adhurimet marrin një tjetër dimension të vlerave e natyrisht edhe ndikimi i tyre shfaqet në nivele më të larta. Pikërisht ky muaj, me përmasat madhështore që e karakterizojnë, ka shënuar historikisht kulmin e ndryshimeve madhështore në jetën e shoqërive myslimane; muaji i përtëritjes themelore të imanit (besimit) të myslimanëve dhe përtëritjes së marrëdhënieve të këtyre shoqërive; muaji i konfirmimit të palëkundur për pozitën fisnike të qenies njerëzore; stacion i çlirimit nga monotonia, pesimizmi, plogështia dhe dëshpërimi; periudhë e forcimit të unitetit mes besimtarëve e të krjimit të urrave të ndërshkëmbimit të begatave midis tyre.... sa e sa dukuri të jashtëzakonshme ndodhin përgjatë këtij muaji të shenjtë dhe sa e sa shumë hapësira më të mëdha lihen pa shfrytëzuar si shkak i dobësisë dhe neglizhencës që na karakterizon si qenie njerëzore!

Në pritje të muajit të shenjtë të Ramazanit, ne, si besimtarë ndodhemi në një situatë që mund të krahasohet me alegorinë që iu dedikohet personave të cilët gjendeshin brenda një shpelle të mbushur me florinj, por që nuk kishin dritë për ta konstatuar se çfarë materiali kapnin duarte e tyre, kështu që më i fituari doli ai që shfrytëzoi rastin dhe mblodhi sa më shumë florinj. Ndryshe nga këta persona, ne na është bërë me dije vlera e begatave të çmuara të cilat kemi mundësinë që t'i akumulojmë për të pasuruar jetën shpirtërore dhe materiale. Detyra dhe njëkohësisht privilegji që na takon ka të bëjë me meditim

në lidhje me mirësitë madhështore të këtij muaji si edhe me përgatitjen për ta pritur atë.

I Dërguari fisnik i Allahut të Lartmadhëruar, Muhamedi (paqja qoftë me të) thotë në një hadith: “Kur hyn muaji i Ramazanit, hapen portat e qiellit dhe mbyllen portat e Xhehenemit si edhe lidhen shejtanët në pranga.”¹ Sipas kësaj thënie të të Dërguarit të Zotit, kemi të bëjmë me përcaktim hyjnor të kushteve dhe atmosferës që i paraprijnë përjetimeve të këtij muaji të veçantë. Përkujtohem se me fillimin e tij, Allahu i hap portat e qiellit, të atij qielli përtej të cilit qëndron Arshi (Froni) i Sunduesit të Gjithësisë, - “I Gjithëmëshirmi mbi Fron u ngrit (si i takon madhësisë së Tij)”². Hapen portat e qiellit për të cilin Zoti ynë na bën me dije gjithashtu se “Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që iu është premtuar”. Portat e lidhjes së robit me Zotin e vet janë gjithmonë të hapura derisa njeriu jeton mbi tokë, por dimensionin e hapjes së tyre në Ramazan arrin stadi të një natyre tjetër të cilën e kemi vështirë ta konceptojmë me mendje, por shumë më të lehtë për ta përjetuar. Hapja e portave qiellore gjatë muajit të Ramazanit nënkupton edhe gatishmërinë e Krijuesit për të intesifikuar marrëdhëniet me roberit e tij besimtarë, demonstrimin e mëshirës së Tij të pakufishme në sajë të së cilës pret edhe prej gabimtarëve të gjynaheve të mëdha pendim dhe kthim tek Ai.

Kushtet që mundësojnë një atmosferë sa më pozitive përgjatë Ramazanit nuk janë lënë deri në gjendjen e afrimit dhe ekspozimit të skajshëm me mirësitë e Zotit, por janë fortifikuar me kufirin që i është vendosur të keqes dhe ithtarëve të saj. Kështu, Allahu i mbyll në këtë muaj portat e Xhehenemit dhe i lidh shejtanët që konsiderohen prej armiqve kryesorë që përpiqen ta çojnë njeriun në Xhehenem. Në kuptimin metafizik mbyllen portat pas të cilave ndodhet vendbanimi i pabesimtarëve dhe keqberësve, ndërsa në aspektin social mbyllen rrugët të cilat e rrezikojnë njeriun të shkojë në humbje e po ashtu prangoset prijësi i thirrjes të së kotës, shejtani.

E si të mos jetë madhështor ky muaj i cili zotëron aftësinë për t'i qartësuar sa më shumë njeriut realitetet e kësaj jete (dynjasë) dhe të jetës tjetër (ahiretit). Hark kohor që ka dëshmuar aftësinë për të përsosur dhe zbukuruar sjelljen e miliona e miliona njerëzve në mbarë botën e po ashtu të jetë një burim i pashtershëm i përvetësimit të virtytëve. Sa e sa shpirtra janë zbutur e kanë përhapur mirësi e drejtësi përgjatë këtij muaji të shenjtë, e sa e sa zemra janë afruar e bashkuar me sinqeritet vetëm për hatër të Zotit.

Ky muaj na fton që të reflektojmë sa më shumë që

të mundemi për të përfituar dhe përvetësuar sa më shumë prej mirësive të Zotit po edhe për të zgjeruar dhe thelluar njohjen dhe të kuptuarit. Urësitë e tij janë të panumërta dhe madhështore, mjafton të përkujtojmë faktin se; Zoti të mirën dhe bagatinë i ka bërë pasojë të punës, pavarësisht se sa shpërblime ka puna e kryer. Në këtë mënyrë edhe shpërblimet e muajit të Ramazanit janë pasojë e punës sonë me disiplinimin e vetes dhe sakrificës duke e privuar veten nga nevojat bazë trupore për të plotësuar sa më shumë nevoja shpirtërore. Këtu vihet në pah parimi i meritokracisë, vlerë e domosdoshme për t'u kuptuar e përvetësuar, sidomos nga ne si besimtarë. Zbullimi i sa më shumë urtësive që mbart në vete Ramazani është i mundshëm vetëm në sajë të përpjekjes mendore e cila duhet të jetë shoqëruese e përpjekjeve të nefsit (egos) së njeriut për ta zbatuar agjërimin në mënyrë sa më korrekte.

Marrëdhënia me Kuranin përbën gjithashtu, çelësin e ndërtimit dhe të konsolidimit të dijeve dhe të karakterit të besimtarit në këtë muaj, prandaj edhe vlera e leximit të tij përgjatë Ramazanit na shfaqet e shumëfishuar, ashtu sikurse çdo vepër tjetër e mirë.

Në rrugëtimin plot sprova e vështirësi, plot begati dhe bereqet të besimtarit, gjendet një sihariq i gëzueshëm, ai është sihariqi që na përkujton afrimin e muajit më të bukur. Në mjedisin shoqëror ekziston një grup njerëzish, virtytet e të cilëve qëndrojnë në shkallët më të përsosura, këta janë agjëruarit e Ramazanit. Midis muajve të vitit ndodhet një muaj në të cilin bamirësia përhapet pa dallim dhe pakufi, si shiu i pranverës, e ky muaj është Ramazani. Mes mishmashit dhe moskoherencës në këtë botë të larmishme, shfaqet një unitet dhe koordinim i jashtëzakonshëm njerëzish që mahnit të gjithë ata që e shohin, ky unitet ndodh në syfyf, iftar dhe në namaz të teravive nga të përkushtuarit ndaj Zotit të tyre. Në zemrën e besimtarit përjetohet një ndjenjë e thellë altruizmi dhe vetmohimi e veçantë, vetëm përgjatë Ramazanit. Shpirti i besimtarit dominon në betejën me kërkesat e trupit në mënyrë absolute, e ky dominim arrihet vetëm përgjatë muajit të shenjtë. Në raportin familjar të besimtarëve shfaqet një gjendje hyjnore e dashurisë dhe harmonisë, e kjo gjendje përjetohet vetëm në bashkimin e tyre për syfyf e iftar. “Në Xhenet është një portë që quhet Rejjan, nga e cila do të hyjnë agjëruarit Ditën e Ringjalljes dhe askush tjetër nuk do të hyjë andej, përveç atyre. Do të thirret: ‘Ku janë agjëruarit?’ Ata do të ngrihen dhe askush tjetër nuk do të hyjë nga ajo portë përveç tyre. Kur ata të kenë hyrë të gjithë, ajo do të mbyllet dhe askush nuk do të hyjë më që andej.”³

1. Sahih el Buhari 1899

2. Kurani, 20:5

3. Sahih el Buhari 1896



Sababi dijetar UKBE IBNI AMR

- RADIJALLAHU ANHU -

— Mustafa Erish —

Ukbe Ibni Amr (r.a.), ishte një fatlum që u takua me Profetin (a.s.), në Besëlidhjen e Dytë të Akabes. Një hero që ka marrë pjesë në të gjitha betejat që prej asaj të Bedrit. Një sahab që ka transmetuar një-qind e ca kusur hadithe prej të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ukbe (r.a.), lindi dhe u rrit në Medinë. Ai i përkiste degës Beni Nexhar prej fisit Hazrexh. Transmetohet se ai ka lindur rreth 15 vite para hixhretit. Ndërsa në vitin e 13 të profetësisë (622), mori pjesë në Besëlidhjen e Dytë të Akabes dhe i dha besën Profetit (a.s.).

Në rrethin e vet, është njohur më tepër me emrin Ebu Mes'ud el-Bedri. Ndërsa emri i tij i vërtetë ishte Ebu Mes'ud Ukbe ibni Amr ibni Sa'lebe el-Bedri. Lidhur me shtesën e emrit el-Bedri, ka mendime të ndryshme. Disa thonë se e ka marrë për shkak se ka luftuar në betejën e Bedrit, e disa të tjerë thonë ngaqë ka banuar në Bedr.

Dijetarët e hadithit, duke filluar prej Buhariut, thonë se ai ka marrë pjesë në betejën e Bedrit. Ndërsa Uakidi dhe shumica e dijetarë të historisë, thonë se ai nuk ka marrë pjesë në këtë betejë. Shkaku i këtyre mendimeve të ndryshme, mendohet se është fakti që në betejën e Bedrit, ai ka qenë me detyrë në shërbimet e prapavijës. Por, ka edhe nga ata që transmetojnë se para se të fillonte lufta, ai ka siguruar ujë në pusët e Bedrit. Ndërsa në betejën e Uhudit dhe të tjerat pas saj, është e sigurt që ka marrë pjesë. (shih. Isabe, IV, 432.)

Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), emigroi në botën tjetër, Ukbe Ibni Amr (r.a.), u vendos në Kufe. Më vonë, kur Aliu (r.a.), u nis në luftën e Siffinit, e caktoi Ukben (r.a.), si zëvendës të tij në Kufe. Zemra

e tij ishte e mbushur me dashuri për të gjithë vëllezërit e fesë. Ai dëshironte që mes myslimanëve të mbizotëronte paqja dhe dashuria, e jo urrejtja dhe armiqësia. Për këtë arsye, ai u lut që në Siffin të mos fitonte asnjëri prej dy grupeve. Më vonë, ai u shkakua nga detyra që kishte dhe u kthye në Medinë. (shih. Ibni Sa'd, VI, 16; Dhehebi, Sijerua'lami'n-nubela, II, 493-496.)

Ukbe ibni Amr (r.a.), ishte një sahab i dorëzuar plotësisht tek Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Edhe ai, si gjithë sahabët e tjerë, çdo gjë që dëgjonte prej Profetit (a.s.), përpiqej ta vinte menjëherë në jetë, duke i zbatuar me përpikëri të gjitha urdhrat dhe ndalesat e tij.

Ai ka transmetuar mbi njëqind hadithe nga i Dërguari i Allahut (a.s.), nëntë prej të cilëve gjenden edhe tek Buhariu, edhe tek Muslimi. Përveç këtyre, një hadith tjetër gjendet vetëm tek Buhariu, ndërsa shtatë të tjerë vetëm tek Muslimi.

Këtu dëshirojmë të ndajmë me ju disa prej haditheve që ka transmetuar Ukbe (r.a.), të cilat na hapin horizontin dhe na ndriçojnë jetën:

Ebu Mes'ud Ukbe Ibni Amr el-Ensari el-Bedri (r.a.), ka thënë:

*“Kur zbriti ajeti i sadakasë, ne filluam të jepnim sadaka duke bartur mallra mbi kurriz (duke punuar si hamall). Ndërkohë, erdhi një person, i cili dha sadaka me bollëk. Dyftytrëshit (munafikët), thanë: «e bën për t'u dukur». Më pas, erdhi një tjetër dhe dha një sasi hurmash. Munafikët përsëri thanë: «Allahu nuk ka nevojë për një sasi të tillë hurmash». Pas kësaj, zbriti ajeti: «**Sa për ata (hipokritë) që përqeshin besimtarët që japin lëmoshë me vullnet dhe tallen me ata që nuk janë në gjendje të japin gjë përveç***

(fryteve të) punës së tyre, Allahu do të tallet me ta. Ata do të kenë dënim të dhembshëm.» [Teube, 79.] (Buhari, Zekat, 10; Muslim, Zekat, 72.)

Në komentimin e këtij hadithi, na jepen këto të dhëna të rëndësishme, të cilat mund të na zgjerojnë vetëdijen e dhurimit për hir të Allahut:

Kur zbriti ajeti, **“Merr sadaka prej pasurisë së tyre!”** [Teube, 103.], Profeti (a.s.), i nxiti myslimanët të japin sadaka. Sahabët që nuk kishin ç’ të jepnin si sadaka, por që zbatimin e urdhrave hyjnore e konsideronin një përpjekje në rrugën e Allahut, filluan të punonin si hamall dhe të jepnin sadaka prej asaj që fitonin. Nga ajo që kuptohet, ashtu si në adhurimet dhe urdhrat e tjera hyjnore, si sahabët e pasur, ashtu edhe ata të varfrit kanë marrë pjesë me një entuziazëm, përpjekje dhe vendosmëri të lartë në zbatimin e urdhrat të sadakasë. Kjo përpjekje e tyre tepër entuziaste, u prit me fjalë përçmuese nga dyfytyrëshit.

Siç kuptohet edhe në transmetime të ndryshme të këtij hadithi, sahabiu që kishte sjellë para me bollëk, ishte Abdurrahman Ibni Auf (r.a.), i cili dhuroi katër mijë dirhem, që përbënin gjysmën e pasurisë së tij. Mirëpo, dyfytyrëshit e kanë cilësuar si “për t’u dukur” këtë veprim të tij. Po ashtu, ata e përçmuan dhe u tallën edhe me Ebu Akil el-Ensarin (r.a.), i cili kishte sjellë një sasi hurmash, duke i thënë: “Allahu nuk ka nevojë për një sasi të tillë hurmash”. Ndërkohë që edhe Ebu Akili (r.a.), kishte sjellë gjysmën e hurmave që kishte fituar nga puna e asaj dite. Në fakt, ajo që nuk arrinin të duronin dot dyfytyrëshit, ishte përpjekja nga ana e sahabëve, për të dhuruar gjysmën e pasurisë, qofshin të pasur apo të varfër. Megjithëse në këto dy shembuj sasia e sadakasë së dhuruar ndryshon, përqindja e sakrificës së atyre që dhuruan nuk ndryshonte aspak. Dhe kjo sasi ishte pesëdhjetë për qind e pasurisë... Gjithsecili jepte aq sa kishte mundësi, por sakrificë ishte e njëjtë. Pra, përpjekjet bëheshin në të njëjtën masë. Mbase në këtë pikë duhen kërkuar edhe virtytet e sahabëve të nderuar. Atyre që donin të talleshin me këto virtyte të tyre, iu mbyll goja me ajetin 79 të sures Teube, të cilën e kemi përmendur më sipër.

Sado e vogël të jetë një mirësi e bërë, përçmimi i saj nuk është aspak i drejtë. Gjithkush duhet të përpiqet t’i bindet urdhrave të Allahut të Madhëruar sipas mundësive që zotëron dhe nuk duhet t’i marrin për bazë fjalët e atyre që i përqeshin në këtë çështje. Dhënia e sadakasë nuk duhet neglizhuar, qoftë ajo edhe e pakët. Me këtë duhet të mësohen edhe të vegjlit tanë, sepse sadakaja e fik zjarrin e Xhehenemit dhe i parandalon trazirat që mund të dalin në pah për shkak të çekuilibrit ekonomik në shoqëri.

Ebu Mes’ud Ukbe Ibni Amr el-Ensari el-Bedri (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush i hap rrugën një mirësie, shpërblehet si ai që e bën atë mirësi!” (Muslim, Imare, 133; Ebu Daud, Edeb, 115.)

Lidhur me pjesën e parë të këtij hadithi, në komentim thuhet:

“Një person erdhi tek Profeti (a.s.) dhe i tha:

«Më ka ngordhur kafsha që kisha prandaj më gjej dhe më dhuro ti një kafshë që ta kem për ti hipur!» Profeti (a.s.), tha:

«As unë nuk kam një kafshë të tillë!»

«O i Dërguari i Allahut!» – tha një person që gje-ndej aty. «Ta tregoj unë një person, i cili mund t’i japë atij një kafshë për ti hipur.»

Pas këtyre fjalëve, Profeti (a.s.), tha hadithin e mësipërm.

Të ndërmjetësosh për kryerjen e një pune të mirë ka sevape njësoj si të bësh një vepër të mirë. Kjo mund të bëhet me fjalë, me vepra, me shenja ose me shkrim. Mbi të gjitha, shpërblimi dhe sevapi që meriton personi që ndërmjetëson për kryerjen e një vepre të mirë, nuk ia pakëson aspak sevapin atij që e kryen atë vepër të mirë.

Ebu Mes’ud el-Bedri (r.a), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Nëse një njeri siguron jetesën e familjes së tij duke shpresuar kënaqësinë e Allahut, ato që shpenzon ai, do të jenë secila nga një sadaka për të.” (Buhari, Iman 41, Megazi 12, Nafakat 1.)

Megjithëse sigurimi i jetesës së familjes është detyrë e kryetarit të familjes, përmeshja e kësaj detyre nuk përbën asnjë pengesë që ai të fitojë sevape për atë që bën. Ashtu sikurse fiton sevape duke dhënë sadaka, pra duke kryer një punë vullnetare (nafilë), besimtari fiton sevape edhe duke kryer një detyrë farz, siç është sigurimi i jetesës së familjes. Për shkak të dashurisë që ka për krijesat e Tij, Allahu i lartësuar dëshiron t’i shpërblejë robërit e Tij në çdo rast. Ai dëshiron t’u shkruajë atyre të mira për çdo punë që bëjnë.

Ebu Mes’ud Ukbe ibn Amr el-Bedri el-Ensari (r.a), transmeton se Profeti (a.s.), ka thënë:

“Xhematin ta drejtojë ai që e di më mirë Kuranin dhe e lexon më bukur atë. Nëse njohuritë e kiraetit i kanë të barabarta, të drejtojë ai që e njeh më mirë sunnetin tim. Në qoftë se sunnetin tim e njohin në mënyrë të barabartë, të prijë ai që ka bërë hixhret më parë. Në qoftë se kanë bërë hixhret në të njëjtën kohë, të bëhet imam ai që është në moshë më të madhe. Askush mos të çohet të bëhet imam aty ku i pari i vendit e ka caktuar atë. Askush mos të ulet në vendin ku ulet i zoti i shtëpisë pa i dhënë leje ai më parë.” (Muslim, Mesaxhid, 290.)

Islami është një sistem vlerash. Shoqëria islame është e ngarkuar me detyrën e respektimit të këtyre vlerave dhe përparësive. Respektimi i të diturve, të devotshmëve dhe të moshuarve, tregohen shkallën e pjekurisë së individit dhe të shoqërisë.

HUMBJA E BESIMIT DHE SIGURISË

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Besimi dhe siguria, në sensin më të thjeshtuar të tyre, nënkuptojnë mbështetje, mirëbesim pa ndjerë frikë e dyshim, lidhje dhe mënyrë jetese. Çfarëdo të vlejë ajri, uji dhe oksigjeni për njerëzit dhe gjallesat e tjera, ata shprehin në çdo atom edhe besim e siguri për shoqëritë. Dome thënë, besimi dhe siguria kanë pozitë themelore në këtë jetë. Nëse besimi dhe siguria fillojnë të humbasin, do të thotë se shoqëria ka filluar të ketë probleme.

Në ditët e sotme shihet qartazi përhapja e problemit të mungesës së besimit dhe sigurisë, thënë më saktë, humbja e sigurisë dhe depresioni që shkakton kjo e fundit. Konceptet si dashuria, respekti, mirësjellja, ndershmëria, mbajtja e amanetit, mbajtja e premtimit, besnikëria, drejtësia dhe solidariteti, të cilat formojnë strukturën e besimit dhe të sigurisë, pothuajse janë shndërruar në “koncepte të humbura”. Shtimi i masave të sigurisë nga dita në ditë dhe përhapja e teknologjisë së sigurisë, janë argumentet më të qarta të konceptit “humbje e vlerave”.

Kjo do të thotë se ummeti islam ka nevojë të formojë përsëri një shoqëri të sigurt dhe të ndërtojë një botë me rend, në mënyrë që të parandalojë humbjen e besimit dhe sigurisë, dukuri kjo që po përhapet me shpejtësi. Përgjegjësia në lidhje me këtë çështje zë vend para të gjitha të tjerave, sepse besimi dhe siguria janë kapitali social më i vlefshëm që mund të posedojë një shoqëri. Dihet qartazi se pa u arritur rendi dhe siguria në shoqëri, nuk mund të pritët asnjë arritje materialo-shpirtëror, nuk mund të realizohet asnjë aktivitet ekonomik apo social dhe nuk mund të paramendohet asnjë zhvillim i shëndetshëm as në shkallë shteti, e as në shkallë ummeti.

Humbja e ndjenjës së besimit dhe sigurisë, apo depresioni që shkaktohet nga kjo humbje e vlerave, e që po thellohet çdo ditë, po i shtyn njerëzit në kërkim të garancive. Këto lloje masash të shumë njerëz po shkaktojnë dobësim të ndjenjës së sigurisë ndaj vlerave të besimit dhe ndaj Allahut. Një gjendje e tillë për një besimtar është shenjë e dobësimit të thellë, serioz dhe shqetësues në besim, i cili është burimi më i fuqishëm i sigurisë.

Humbja e sigurisë, deri te vlerat e besimit, në strukturën e ummetit, duhet të konsiderohet e

para nga të gjitha çështjet e rëndësishme që duhet të shqyrtohen dhe të rregullohen me seriozitet.

Kur lindi Islami, filloi të përhapej fenomeni i sigurisë, së pari në gadishullin Arabik dhe pastaj në shoqëritë e vendeve që e përvetësonin atë. Të gjithë e dimë se dikur njerëzit shkonin për të falur namazin e Xhumasë pa i mbyllur dyert e dyqaneve. Ndërsa tani konsiderohet e detyrueshme vendosja nën siguri e dyqaneve me lloj-lloj mjjetesh sigurie.

TË QENIT I BESUESHËM ËSHTË MË I RËNDËSISHËM SE TË QENIT I DASHUR TE TË TJERËT.

Të jesh njeri i besueshëm në të vërtetë është më e rëndësishme se sa të jesh i dashur. Rëndësia e besueshmërisë është jetike. Njeriu nuk është i detyruar t'i dojë të gjithë njerëzit, por të gjithë janë të detyruar t'u besojnë veçanërisht vëllezërve në fe dhe përgjithësisht njerëzve me të cilët jetojnë. Njerëzit mund pranojnë që se duan një person të caktuar, por pas kësaj duhet të shprehen: "Ama le të themi të vërtetën: Ai është një njeri besnik, i ndershëm dhe që e mban amanetin."

Nga ana tjetër, besimtari duhet të jetë njeri besnik dhe i ndershëm, sepse besnikëria është një koncept që buron pikërisht nga besimi. Në një hadith fisnik që konsiderohet "hasen", thuhet: "Njeriu që nuk ka besnikëri, nuk ka as besim."¹

TË QENIT I BESUESHËM ËSHTË VIRTYTI DHE FUQIA MË E MADHE

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka qenë i njohur si "Muhammedu'l-Emin /Muhamedi Besnik" në shoqërinë ku jetonte edhe para profecisë, edhe pas profecisë, edhe prej ata që e donin, edhe prej ata që e urrenin. Personaliteti i tij plot besnikëri përbënte pikën më të fuqishme pasi shpalli profecinë. Ndërsa për politeistët kjo përbënte pikën më të dobët të tyre.

BESIMI DHE SIGURIA JANË NEVOJAT SOCIALE MË THEMELORE

Në bazën e humbjes së besimit dhe sigurisë, gjendet neglizhimi i virtyteve themelore si drejtësia, barazia, liria dhe ndershmëria, si dhe dobësimi i vlerave morale. Problemi i besimit dhe sigurisë, me kalimin e kohës u hap rrugë disa problemeve edhe më të mëdha dhe lind rrezikun

1. Ahmed ibn Hanbel, Musned, III, 210.

për përplasje ndërmjet grupeve të ndryshme brenda shoqërisë. Për ta parandaluar një zvarritje të tillë apo këtë shkatërrim social, te individët që formojnë shoqërinë, duhet të zhvillohet ndjenja e besimit dhe sigurisë.

El-Maverdi (v.450/1058), në veprën e tij të njohur me titull "Edebu'd-dunjave'd-din" jep gjash-të rregulla themelore për një jetë shoqërore të sigurt:

-Feja që zbatohet me të gjitha bazat e saj.

-Udhëheqës i fuqishëm.

-Drejtësia që përfshin të gjithë.

-Siguri e përgjithshme.

-Vend produktiv / të ardhura të vazhdueshme.

-Ideal i lartë²

Këto rregulla mund të zgjerohen më tej:

Nevojitet një sistem udhëheqjeje i fuqishëm dhe i drejtë, një strukturë sociale që i ka të forta lidhjet familjare, një shoqëri e lidhur me zakonet e traditat e saj dhe individë e breza që zotërojnë parimin për ta mbartur fenë dhe kulturën në çdo shekull.

Me të vërtetë, në ditët e sotme gjendemi ballë për ballë me realitetin e brezave që i kanë të dobëta vlerat familjare, që nuk kanë dijeni për traditat e zakonet dhe që nuk e zbatojnë fenë. Në një shoqëri që e harxhon energjinë e saj në këtë mënyrë për çdo ditë, nuk mund të shpresohet që të ketë siguri. Çdo ditë në lajme diskutohen korrupsioni dhe mashtrime të reja. Kjo situatë ndikon seriozisht në besimin e njerëzve kundrejt njëri-tjetrit.

Në ditët e sotme nuk kemi shoqëri të formuara mbi ndjenjën e besimit, por mbi fenomenin e marrjes së masave të sigurisë. Për arsye se është më e lehtë të formosh një shoqëri mbi marrjen e masave të sigurisë, sesa mbi ndjenjën e besimit, udhëheqësit dhe udhëheqjet zgjedhin mënyrën e parë. Kështu pandehin se do ta frenojnë humbjen e besimit dhe sigurisë në shoqëritë që drejtojnë. Por në fakt nuk po bëjnë gjë tjetër përveçse po përforcojnë humbjen e ndjenjës së besimit dhe shtimin e masave të sigurisë. Marrja e masave të sigurisë nuk ka fund. Çdo marrje masash u hap dyert mashtrimeve të tjera.

2. Edebu'd-dunjave'd-din, fq. 135, Kajro, 1978.



Koha për të JETUAR ESENCËN e Islamit

— Rabia Brodbeck —

Ne jemi fëmijët e Habilit që ka rënë dëshmor. Ne e kemi për borxh ta tregojmë miqësinë tonë ndaj tij, për hir të gjakut që derdhi dhe dashurisë që shfaqti. Ne jemi nipërit e Ibrahimit (a.s.), i cili hodhi themelet e shtëpisë së tevhidit të Krijuesit të Gjithësisë. Ne jemi fëmijët e Ademit (a.s.). Ne jemi ndjekësit e pluhurit të këmbëve të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ne jemi ndjekësit e mesazhit: **“Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë.”** Ne jemi mbartësit e amanetit Hyjnor. Prandaj, ne u kemi borxh atyre që kanë rënë dëshmorë në rrugë të Allahut dhe e kemi për borxh që të ndjekim gjurmët e tyre. Ata e kanë dhënë jetën e tyre, që ne të shohim, të zgjohemi, të kuptojmë dhe të gjejmë dritën e udhëzimit nga urtësia e Kuranit Fisnik. Ne ia kemi borxh Allahut (xh.xh.), që të mos kemi frikë nga vdekja dhe të ecim në rrugën e të vërtetës, duke i zbatuar detyrat që kemi ndaj Tij. Le të trashëgojmë qoftë edhe pak fare prej fuqisë së rezistencës që kishte në zemër Husejni (r.a.). Le të trashëgojmë qoftë edhe pak nga dashuria e Ismailit (a.s.), për nënshtrim ndaj Zotit, nga fuqia e trimërisë së Hamzait (r.a.), nga fuqia e Jusufit (a.s.), për të duruar kundrejt sprovave, dhe nga sinqeriteti i Aliut (r.a.), i cili u shtri dhe fjeti në shtratin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Le ta drejtojmë veten nga përhershmeria, nga tevhidi që na

jep nder, dhe nga Allahu Teala. Ne kemi ardhur në këtë botë për të përjetuar dashurinë Hyjnore, për të bërë miraxhin, për të rënë dëshmorë, për të fituar kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), për të fituar Xhenetin dhe për të fituar Jetën e Përhershme. Ne kemi ardhur në këtë botë për të perceptuar nevojën për tevhidin dhe për esencën e Islamit. Ne kemi ardhur në këtë botë për të marrë këshilla nga ata që e kanë arritur pozitën e martirëve, për ta flijuar jetën për Atë që na e ka dhënë dhe për të vdekur me të njëjtën pastërti që kemi ardhur. Ne kemi ardhur në këtë botë për të arritur identitetin e vërtetë prej njeriu dhe për të jetuar të vërtetën e fjalës së shehadetit. Ne kemi ardhur në këtë botë për të mbartur amanetin Hyjnor, për të fituar dritën Hyjnore, për të flijuar çdo dashuri që nuk është për Allahun Teala dhe për të mbajtur premtimin tonë “Po”, që e kemi dhënë në “Kalu Bela”. Ne kemi ardhur në këtë botë për të ndjekur të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Ne kemi ardhur në këtë botë për të thënë të gjithë së bashku me një gojë: “Nëna, babai, fëmijët, pasuria, pronat dhe jeta ime të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut!” Ne kemi ardhur në këtë botë për t’u bërë ummet i Muhamedit (a.s.). Ne kemi ardhur në këtë botë për ta pasuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.).

Prandaj duhet të rendim pas të vërtetës. Ndër të tjera duhet të mësojmë të duam pa kushte. Duhet të shpëtojmë nga frika e humbjes dhe vdekjes. Ne duhet të specializohemi në artin e dhënies. Kur jetojmë, edhe duam. Kur duam, edhe japim. Prandaj nuk duhet të kaplohem nga virusi i interesave vetjake dhe duhet të mësojmë të derdhim lot. Duhet të mësojmë artin e afrimit ndaj të tjerëve. Duhet të mësojmë t’i thyejmë idhujt në zemër. Duhet të mësojmë ta zbusim zemrën. Duhet të specializohemi në profesionin e dashurisë. Duhet të mësojmë artin e heshtjes. Rumi thotë: “Mbylle derën e fjalës dhe hape derën e zemrës. Hëna do të të puthë nga dritarja.”

Ne duhet të fitojmë dritën dhe Dashurinë Hyjnore. Duhet të përpiqemi të shohim me syrin e nevojës, e jo me syrin e epshit dhe pangopësisë. Duhet të përpiqemi ta përvetësojmë fenë dhe duhet ta lëmë kërkimin e përgjigjes. Duhet të përballlemi me veten tonë dhe duhet të largohemi nga padrejtësia. Vetën tonë nuk duhet ta humbasim dhe jetën tonë duhet t’ia kushtojmë Islamit. Njerëzit duhet t’i mbrojmë, por jo t’i shfrytëzojmë.

Ne nuk duhet të marrim prej njerëzve, por duhet të kërkojmë prej Zotit (xh.xh.). Asnjëherë nuk duhet të konsumohemi dhe gjithmonë duhet të prodhojmë. Asnjëherë nuk duhet të jemi mendjemëdhën. Gjithmonë duhet të jemi të gatshëm për t’u flijuar për Allahun Teala. Nuk duhet të shohim prapa dhe nuk duhet të humbasim. Hz. Mevlana thotë: “Zgjohu dhe shiko, o ti që je si një pikë! Bëje kurban veten pa hezituari, në mënyrë që të blesh një oqean në shkëmbim të një pike!” Ne duhet të marrim nga Allahu dhe t’u japim njerëzve. Në të vërtetë, përse të mos ua japim njerëzve atë që është e Allahut? Të mëdhenjtë tanë nuk kanë bërë rehat pa i dhënë të gjitha. Ndërsa ne nuk bëjmë rehat pa i marrë të gjitha.

Në këtë botë kemi nevojë për një nijet të pastër dhe të sinqertë. Nijeti është vetë jeta. Të dhënë për hir të Zotit tregon gjendjen shpirtërore të mirë. Sexhdeja është burim i frymëzimit. Namazi është drita e syve tanë. Agjërimi i zemrës është kënaqësi. Tradita e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është dashuri. Allahu i Lartësuar na bën thirrje që ta shohim bukurinë e përhershme të thesareve të krijimit. Allahu na fton te admirimi, dashuria dhe frymëzimi hyjnor.

Duhet të kuptojmë sa kemi nevojë për dritën e Tevhidit. Të vërtetën e shehadetit duhet ta shndërrojmë në stil të jetës. Meditimi dhe dashuria na mundësojnë të jetojmë esencën e Islamit. Dashuria për bindje, besim, nënshtrim, xhihad, ibadet dhe infak, na bën të jetojmë esencën e Islamit. Lufta me nefsën, lufta me vetveten, shërimi nga sëmundjet shpirtërore dhe largimi nga çdo lloj be-laje, injorance, shkujdesjeje, mungese vetëdijeje dhe lidhjeje materiale, na mundësojnë të jetojmë esencën e Islamit. Nëse shpëtojmë nga një jetë e ngujuar brenda katër mureve dhe zhytëmi në shkretëtirën e ekzistencës, për të jetuar urtësinë e ajeteve hyjnore, do të kemi mundësi të jetojmë esencën e Islamit.

Tashmë ka ardhur koha për t’u strehuar te mëshira e Zotit të botëve dhe për të pasuar atë që është dërguar mëshirë për botët. Tashmë ka ardhur koha për t’i perceptuar mirësitë e pafundme që Allahu i Madhëruar ia ka dhënë ummetit të Muhamedit (a.s.). Tashmë ka ardhur koha për të ndjekur gjurmët e atij që e ka jetuar Kuranin Fisnik. Tashmë ka ardhur koha për të jetuar të vërtetën e shehadetit.

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë!”

(E’nam, 125)

Kush beson dhe zbaton urdhëresat e Krijuesit, Allahu atij i jep një qetësi shpirtërore. Zemra e tyre ndriçohet nga drita e imanit. Detyrat e ngarkuara i bëjnë me zell të madh, pa asnjë lloj dembelizmi. Kurse jo besimtarët me gjithë të mirat materiale që zotërojnë janë gjithmonë në stres e depresion. Një nga qëllimet kryesore të njeriut në këtë botë është edhe sigurimi i një jetë të lumtur pa problem e telashe. Gjithë jetën njeriu përpiqet për të arritur këtë qëllim. Dikush mendo se lumturia arrihet duke plotësuar objektivat materiale dhe kënaqësitë trupore. Ky grup e kufizon lumturinë vetëm me posedimin e të mirave materiale të kësaj bote.

Dikush tjetër lumturinë e shikon në një këndvështrim tjetër duke besuar se është një shpëtim shpirtëror në botën e amshua . Në këtë kuptim rruga e vetme për të arritur lumturinë e përjetshme është devotshmëria ndaj Allahut. Për rrjedhojë lumturia nga këndvështrimi material me lumturinë në këndvështrimin shpirtëror janë të ndryshme. Ndërsa njëra realizohet duke plotësuar në mënyrë të shfrenuar dëshirat trupore tjetra realizohet duke arritur përsosmërinë shpirtërore përmes mbajtjes nën kontroll të dëshirave.

Nga ky këndvështrim dallohet se Islami ka sjellë një sistem për ta bërë njeriun të lumtur. Feja islame merr parasysh edhe anën materiale edhe atë shpirtërore. Islami e vlerëson njeriun si të tërë pa bërë ndarjen trup-shpirt. Islami nuk e shikon jetën të kufizuar

vetëm në këtë botë, përkundrazi jeta e vërtetë dhe e pafundme fillon pas jetës tokësore. Dëshirat edhe nevojat e njeriut janë të pafundme kurse mundësitë për t’i plotësuar janë të kufizuara. Për këtë arsye nuk mundet të plotësohen të gjitha dëshirat në këtë botë.

Nga kjo pikëpamje bota e përtejme është një shpresë për besimtarët të cilët besojnë se do të shpërblehen me mirësi të pafundme nga ana e Allahut. Kurse për jo besimtarët nuk mund të mendohet një gjë e tillë sepse sipas tyre i vetmi vend ku mund dhe duhet të plotësohen dëshirat është kjo botë. Kjo filozofi jete e shtyn njeriun në një liri totale për të plotësuar dëshirat nëpërmjet të cilave, gjoja, realizohet lumturia por kjo është një iluzion sepse përmbushja e gjithë dëshirave, së pari, është e pamundur dhe e dyta assesi nuk sjell lumturi.

Ndërsa për mos besimtarin, fundi i kësaj bote ndjell frikë, kurse për besimtarët nuk ndodh një gjë e tillë, ai e pret me mall dhe aspiratë. Kjo gjendje rrjedh sepse islami e mëson njeriun të jetë pozitiv dhe optimist për jetën. Ai e shikon botën të mbushur me mirësi, krijuesi të të cilëve është Allahu. Dhe për këtë falënderon Allahun për mirësitë e pafundme që i janë dhënë. Njeriu duke qenë i vetëdijshëm se krijuesi dhe zotëruesi i të gjithë këtyre është Allahu i dorëzohet vullnetit dhe përcaktimit të Allahut, dhe kjo sjellë tek ai një qetësi shpirtërore të papërshkruar. **Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.** (Talak, 3)

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'arij (r.a.)
se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*"Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme.
Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë një
parfum ose tekefundit mund të të vijë era parfumit.
Kurse shoku i keq është si farkëtari qëndrimi pranë
të cilit ose të djeg teshat ose të mbyt nga era e keqe."*

Ky hadith është në përputhje të plotë me ajetet që këshillojnë besimtarët të shoqërohen gjithmonë me njerëz të mirë e të devotshëm. Shoqëria dhe miqësia përtej, një marrëdhënie shoqërore natyrale, e ka të nevojshme sinqeritetin dhe sinqeriteti arrihet më së miri midis njerëzve që ndajnë besim dhe ideale të njëjta. Hadithi i mësipërm na këshillon të jemi të kujdesshëm në zgjedhjen e shokut, për vetë faktin, se edhe pse me besim të njëjtë por me sjellje të papajtueshme, njerëzit ndikohen reciprokisht pozitivisht apo negativisht. E këshillueshme është shoqërimi me njerëz të mirë për të përfituar nga edukata e morali i mire i tyre dhe distancimi nga personat me sjellje të keqe sepse shoqërimi sjell patjetër ndikim. Siç e shpreh më qartë hadithi tjetër *"Personi është në fenë e shokut prandaj të shikojë çdonjëri prej jush se me kë shoqërohet."* (Ahmed Ibn Hanbel, Musnedi, 2/334)

Ky hadith i mrekullueshme i thënë ka tërmbëdhjetë shekuj më parë e ruan edhe sot aktualitetin. Tema e ndikimit

zë një vend të rëndësishëm sidomos për sa i përket edukimit të fëmijëve dhe të rinjve. Sepse sjelljet që fitohen në këtë moshë do të përbëjnë një pjesë të karakterit të tij në të ardhmen. Në shumicën e rasteve duhanpirja fillohet thjeshte duke u nxitur nga një shok për të vazhduar gjithë jetën. Përhapja e veseve të tjera të këqija si alkooli, droga dhe kumari është e lidhur ngushtë me ndikimin e rrethit shoqëror. Prandaj zgjedhja e shokut është shumë e rëndësishme, për më tepër në kohën tonë, ku komunikimi ka marrë përmasat e një zhvillimi marramendës duke bërë të mundur edhe krijimin e shoqërive virtuale. Familja duhet të tregohet shumë e kujdes për grupmoshat nga klasa e parë deri në moshën e pjekurisë sepse kjo është moshë ku fillon të formësohet personaliteti por është edhe moshë e cila është shumë e prirur ndaj ndikimeve pozitive apo negative.

Mburoja më e sigurt për të mbrojtur fëmijët nga ndikimet negative është strehimi tek feja islam.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Nxitja për tu shoqëruar me njerëz të mirë.
2. Njeriu ndikohet nga shoku me të cilin shoqërohet.
3. Qëndrimi larg prej shoqërisë së keqe.

Mjë Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- PJESA VI -

PRANË PERSONIT QË ËSHTË DUKE VDEKUR

Profeti ynë (a.s.), e ka këshilluar ummetin e tij të flasë gjëra pozitive pranë dikujt që është duke vdekur:

“Kur të jeni pranë një të sëmuri apo të vdekuri, flisni për gjëra pozitive dhe të bukura, sepse melekët thonë “Amin!” pas fjalëve tuaja.” (Muslim, Xhenaiz, 6; Ebu Daud, Xhenaiz, 15.)

“Kur t’i afroheni një të sëmuri, i thoni atij gjëra të bukura në lidhje me vdekjen, qetësojeni dhe jepini shpresë! Këto fjalë nuk mund ta kthejnë pas diçka që është caktuar t’i ndodhë të sëmurit, por ia kënaqin zemrën atij.” (Tirmidhi, Tib, 35/2087; Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 1/1438.)

Gjithashtu të nxisësh dikë që të shqiptojë shehadetin, *“La ilahe il-lallah”*, në frymën e fundit, është një detyrë fetare, sepse i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nxitini ata që janë duke vdekur të thonë La ilahe il-lallah!” (Muslim, Xhenaiz, 1, 2; Ebu Daud, Xhenaiz, 15-16/3117.)

Mirëpo gjatë kryerjes së kësaj detyre duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm, delikatë dhe të butë. Nuk është e drejtë që i sëmuri të lodhet apo të teprohet në këmbënguljen për ta nxitur atë që të shqiptojë shehadetin, sepse zemërimi i të sëmurit në një gjendje të tillë, mund të shkaktojë vdekjen e tij pa e thënë ende shehadetin, ose -Allahu na ruajt!- shfaqjen e veprimeve në kundërshtim me besimin, gjë e cila është një prej katastrofave më të mëdha.

Përveç këtyre, nëse besimtari nuk ka folur më asnjë fjalë të kësaj bote pasi e ka shqiptuar shehadetin, sado që t’i zgjasë sëmundja, konsiderohet se fjala e tij e fundit është *“La ilahe il-lallah”*. Për këtë arsye shpresohet që ai person të përfshihet në përgëzimin

e Profetit (a.s.), që thotë: *“Kush thotë “La ilahe il-lallah hyn në xhenet!”*¹ Për rrjedhojë, nuk është më e nevojshme që personat në gjendje të tillë të nxiten të shqiptojnë shehadetin.

Gjithashtu, është mirë që pranë njerëzve që janë duke dhënë frymën e fundit, të lexohet Kuran me një zë të bukur e qetësues e veçanërisht surja Jasin.

ÇASTI I VDEKJES

Të gjithë do të përballen me vdekjen në një formë që përputhet me llojin e jetës që kanë bërë. Dikujt vdekja do t’i vijë si lumturia e një mëngjesi bajrami, e dikujt tjetër si një udhëtim drejt dënimit plot me makthe...

Prandaj në momentin e vdekjes, besimtarëve të mirë, melekët ua marrin shpirtin lehtë, pa i shkakuar vuajtje dhe duke i përgëzuar me fjalët:

“Shpëtimi qoftë mbi ju! Hyni në Xhenet, si shpërblim për veprat që keni kryer!” (Nahl, 32.)

Në momentin e vdekjes do të hiqen perdet e syve, melekët do të bëhen të dukshëm dhe besimtarët e mirë do të përgëzohen. Lidhur me këtë të vërtetë në Kuran premtohet:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzohuni Xhenetit që ju është premtuar. Ne jemi mbrojtësit tuaj në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Atje do të keni çfarë t’ju dëshirojë zemra dhe çfarë të kërkoni, dhuratë e pasur prej një Zoti Falës dhe Mëshirëplotë.» (Fussilet, 30-32.)

1. - Ebu Daud, Xhenaiz, 15-16/3116; Ahmed, V, 247; Hakim, I, 503. Shih. Buhari, Xhenaiz, 1.



Kurani na bën të ditur se njerëzit, të cilët e kanë kaluar jetën me bindje të plotë ndaj Allahut, zemra e të cilëve ka gjetur paqen nga përmendja e Zotit dhe kanë arritur pjekurinë e vërtetë shpirtërore, në fillim në momentin e vdekjes e më pas në ditën e gjykimit dhe kur të hyjnë në Xhenet, do të thirren në këtë mënyrë:

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt! Ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!” (Fexhr, 27-30.)

Nëse vihet re me kujdes, ajetet e mësipërme na bëjnë të ditur se pikësëpari robi duhet të jetë i kënaqur prej Zotit të vet. Pra që njeriu të marrë te drejtën për në Xhenet, duhet të jetë gjithmonë i kënaqur me caktimin e Zotit të tij përballë baticave dhe zbatimit të jetës, në kushtet e një jete që ndryshon vazhdimisht. Ai duhet të vazhdojë detyrat e devotshmërisë me durim dhe falënderim, derisa Zoti i tij të jetë i kënaqur me të.

Ndërsa momenti i vdekjes së zemrave të ngurta e të pa ndriçuar me dritën e besimit, është me të vërtetë një katastrofë më vete, sepse melekët do t’ua shkulin dhe do t’ua nxjerrin shpirtin me dhunë.² Ata do të japin shpirt në mënyrë të dhimbshme midis vorbullave të frikshme të vdekjes dhe goditjeve të melekëve.

Allahu i Madhëruar na e përshkruan kështu këtë pamje të tmerrshme:

“Eh, sikur të shihje sesi melekët ua marrin shpirtin mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë (duke u thënë): «Shijoni dënimin e zjarrit!» (Enfal, 50.)

“Melekët ua marrin shpirtin (jobesimtarëve), ndërkohë që ata janë të padrejtë ndaj vetvetes. Ata do të shfaqin përrulje (duke thënë):

«Ne nuk kemi bërë asgjë të keqe!» (Melekët do t’u thonë):

«Nuk është kështu! Natyrisht që Allahu i di mirë veprat që keni punuar. Hyni në portat e Xhehenemit, ku do të mbeteni përgjithmonë! Eh, sa vendbanim i shëmtuar është ai për mendjemëdhenjtë!» (Nahl, 28-29.)

Ndërsa në këtë hadith fisnik përshkruhet mënyra e tmerrshme me të cilën do të nxirret shpirti nga trupi i një gjynahqari:

“(Nxjerrja e) shpirtit nga trupi do të realizohet përmes një procesi shumë të vështirë, njësoj sikur tërhiqet

dhe nxirret një shufër me kanxha dhe grepa prej leshit të lagur.” (Hakim, Mustedrek, I, 93-95/107. Shih. Ahmed, IV, 287, 295; Hejthemi, III, 50-51.)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar u drejtohet kështu idhujtarëve në Kuran:

“Por, kur shpirti të vijë në grykë e të thërrasin, «A ka shërues?», atëherë, ai (që po vdes) do të ibndet se ky është çasti i ndarjes dhe këmbët do të ngrijnë.

Atë ditë, ai do të sillet te Zoti yt. Ai as nuk besoi dhe as nuk u fal, por e mohoi të vërtetën dhe ia ktheu kurrizin, e pastaj shkoi te njerëzit e vet, duke u krenuar.” (Kijame, 26-33.)

Në suren Uakia na ilustron momenti i vdekjes së njerëzve me fund të veshtirë:

“Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, - ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re- përse pra nuk ia ktheni shpirtin atij, nëse (pretendoni se) nuk do të gjykoheni (në jetën e përtejme)? Përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën!” (Uakia, 83-87.)

I gjithë njerëzimi do t’i nënshtrohet e dorëzohet caktimit hyjnor. Madje edhe njerëzit më mizorë e mendjemëdhenj, që kanë kundërshtuar me inat urdhrat hyjnore gjatë jetës, në atë moment nuk do të kenë mundësi të bëjnë asnjë kundërshtim. Ai do të shohë e do të kuptojë se sundimi i vërtetë i gjithësisë i takon vetëm Allahut të Madhëruar, vetëm në momentin kur prej mendjes njerëzore të hiqen perdet e panumërta të indiferencës. Mirëpo kjo njohje tekembramja nuk do t’i bëjë asnjë dobi!..

Në ajetet që vijojnë urdhërohet:

“Kështu, nëse ai (në agoni) është nga ata që janë të afërt (me Allahun), do të ketë prehje, kënaqësi dhe dhunti të Xhenetit. E, nëse është nga njerëzit e së djathtës, (ai do të përshëndetet) «Paqe për ty» nga njerëzit e së djathtës. Por, nëse (ai në agoni) është nga përgënjeshtuesit e humbur, ai do të gostitet me ujë të valuar dhe do të përcëllohet në Zjarrin e flakëruar (të Xhehenemit). Pa dyshim, kjo është e Vërteta e sigurt. Andaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm!” (Uakia, 88-96.)

Njëherë i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Nëse dikush dëshiron të takohet me Allahun, edhe Allahu dëshiron të takohet me të. Por, kujt nuk i pëlqen të takohet me Allahun, as Allahut nuk i pëlqen të takohet me të!”

Aisheja (r.a.), ose një nga gratë e tjera të Profetit (a.s.), ka thënë:

“O i Dërguar i Allahut! Të gjithë ne e shohim të shëmtuar vdekjen dhe nuk na pëlqen. (pra a për-

2. - shih. Naziat, 1.

fshihet këtu edhe mospëlqimi i vdekjes?)”

“Jo, nuk është kështu! Por, kur besimtarit i vjen vdekja dhe ai përgëzohet me mëshirën e Allahut, kënaqësinë dhe Xhenetin e tij, ai e dëshiron shumë takimin me Allahun. Gjithashtu, edhe Allahu e dëshiron takimin me të. Ndërsa, kur i vjen vdekja mohuesit, ai njoftohet me zemërimin dhe dënimin e Allahut. Për këtë arsye, ai nuk e pëlqen takimin me Allahun. Po ashtu, edhe Allahu nuk e do takimin me të.” (Buhari, Rikak, 41; Muslim, Dhikr, 14.)

Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka rrefyer:

“Daudi (a.s.) ishte tepër i kujdesshëm në lidhje me namusin (nderin). Kur dilte nga shtëpia ai kyçte dyert me qëllim që askush të mos hynte tek anëtarët e familjes së tij, derisa ai të kthehej. Një ditë doli duke e lënë shtëpinë të kyçur... Kur Daudi (a.s.) u kthye dhe pa një njeri në mes të shtëpisë, pyeti:

«- Kush je ti?»

«- Ai, i cili nuk u frikësohet sundimtarëve dhe për të cilin nuk ka pengesa!» - U përgjigj personi.

«- Atëherë, për Allahun ti qenke meleku i vdekjes! Urdhëro, unë po i përgjigjem urdhrin të Allahut!»

Pas kësaj, ai ia mori shpirtin...” (Ahmed, II, 419.)

Një fjalë e urtë thotë: “qesh më mirë, ai që qesh i fundit”. Kuptimi i vërtetë i kësaj shprehjeje lidhet me momentin kur robit do t’i hiqen të gjitha perdet në frymën e fundit dhe do t’i tregohet vendi ku do të dërgohet. Nuk do të ketë buzëqeshje më të bukur se kjo! Pra, kjo do të jetë buzëqeshja më e bukur, më kuptimplote dhe më e lumtur në këtë botë. Zoti na e bëftë të mundur të gjithëve!..

Një prej halifeve Emeui, Sulejman ibn Abdulmeliku, e pyeti dijetarin asket të devotshëm Ebu Hazmin:

“Si do të jetë arritja tek Allahu i Madhëruar?”

Ebu Hazmi përgjigjet:

“Arritja e një robi të bindur tek Allahu do të jetë si takimi i një njeriu me familjen e vet që e pret me dashuri, ndërkohë që ai ka qenë larg prej kohësh. Ndërsa mbërritja e një njeriu të pabindur tek Allahu është si kthimi i skllavit tek i zoti, ndërkohë që i është larguar njëherë atij.”

PENDIMI

Njëherë i Dërguari i Allahut, (a.s.), duke dashur të na tërheqë vëmendjen neve, umetit të tij, tha:

“Nuk do të ketë asnjë person që do të vdesë, e nuk do të ndjejë pendesë.”

Kur sahabët e pyetën:

“Për çfarë do të pendohet o i Dërguar i Allahut?”, ai u përgjigj:

“Nëse (i vdekuri) është njeri i mirë, do të pendohet se nuk ka shtuar dot më tepër mirësitë e tij (duke përfutuar më shumë prej mirësisë të jetës). Por nëse (i vdekuri) është njeri negativ, do të bëhet pishman se

përse nuk ka hequr dorë nga veprat e këqija dhe nuk ka përmirësuar veten.” (Tirmidhi, Zuhd, 59/2403.)

Lidhur me këtë çështje Allahu i Madhëruar i parajlmëron kështu robërit e Tij:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humibn.” (Munafikun, 9.)

“Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t’i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: «O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!»” (Munafikun, 10.)

“Ai do të thotë: «Ah, sikur të kisha bërë diçka të mirë për jetën time!»” (Fexhr, 24.)

“Por Allahu nuk ia shtyn afatin askujt që i vjen koha (e vdekjes); Allahu e di mirë gjithçka që bëni ju.” (Munafikun, 11.)

Robi duhet t’i dërgojë në Ahiret mirësitë për të cilat bën fjalë Allahu, atëherë kur ai i ka ende mundësitë në dorë. Pra ai duhet të përgatitet që sot për atë ditë të vështirë, të ashpër e të vuajtur të Kiametit. Nesër, kur të kalojmë në vendbanimin tonë të përjetshëm, nuk do të kemi më në dorë asgjë për të dhuruar, edhe nëse kemi qenë të pasur. Po ashtu, nuk do të kemi më as mundësi që mirësitë e përkohshme t’i konvertojmë në kapital të lumturisë së përjetshme!..

Sa bukur shprehet poeti Nexhip Fazil:

Argjendari i mirë, një tjetër qese qep për vete!

Çfarëdo paraje që vlen në varr, atë ndan më vete!

Aliu (r.a.), thotë:

“Kjo botë ka kthyer shpinën e po shkon, ndër-sa bota tjetër po vjen drejt nesh. Të dyja këto kanë fëmijët e vet të veçantë. Ju bëhuni fëmijët e botës tjetër, e jo fëmijët e kësaj bote.

Sot është dita e kryerjes së veprave dhe nuk ka llogari. Nesër ka llogari, por nuk ka mundësi për të kryer vepra!” (Buhari, Rikak, 4.)

Një nxënës që del nga salla e provimit, nuk mund të hyjë përsëri në provim e të shkruajë më tepër përgjigje për të shtuar notën, edhe nëse i vijnë në mendje përgjigjet e sakta të cilat nuk i kujtoi gjatë provimit. Në të njëjtën mënyrë edhe gjetja e përgjigjeve të sakta të pyetjeve të provimit të jetës, nuk ka asnjë dobi për njeriun pas vdekjes. Përkundrazi, kjo do të bëhet shkak për pendimin e thellë të tij.

Këto fjalë të urta të Ebu Dherrit (r.a.), janë një përmbledhje shumë e bukur e domosdoshmërisë së përgatitjes për vdekjen dhe për çka vjen përtej saj, me qëllim që më vonë të mos thuhet “Ah sikur!”:

“Një mall ka tre ortakë. I pari është i zoti i mallit, pra ti vetë. I dyti është kaderi (caktimi), i cili nuk të pyet ty për çfarë do të të sjelli (ai mall), mirësi apo fatkeqësi. Ndërsa i treti është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh)! E pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti

jep llogari për të. Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!

Allahu i Madhëruar urdhëron: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”**³. Ja, kjo deve është pasuria ime që e dua më shumë dhe po e dërgoj (jap sadaka) para vetes (në Ahiret që të më presë atje).” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163)

Gjendja e një prej të dashurve të Allahut, Rebi ibn Hajsemit, është një shembull mbresëlënës në lidhje me çështjen e përgatitjes për vdekjen dhe kohën përtej saj:

I nderuari Rebi ibn Hajsemi kishte hapur një varr në bahçen e vet. Kur e ndjente se zemra i ishte ngurtësuar, hynte në varr dhe qëndronte aty për njëfarë kohe. Aty meditonte se një ditë patjetër do t'i jepte lamtumirën kësaj bote dhe se në varr do të kishte nevojë qoftë edhe për një istigfar apo sadaka të vetme. Në këtë mënyrë, ai kalonte në një gjendje përsiatjeje të thellë, duke u shqetësuar për llogarinë që do jepet në Ahiret. Më vonë lexonte këto ajete:

“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: «O Zoti im, më kthe që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!» Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai e thotë(kot)! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Mu’minun, 99, 100.)

Ndërsa kur Rebiu dilte prej varrit, i thoshte vetes:

“O Rebi! Pa shiko, sot u ktheve pas! Por do të vijë edhe një çast kur kjo kërkesë nuk do të të pranohet, e nuk do të kthehesh më pas në këtë botë. Prandaj merr masat që tani dhe shtoji veprat e mira, përpjekjet në rrugën e Allahut dhe furnizimet e Ahiretit!”

Edhe këto këshilla të Imam Gazaliut janë shumë mësimdhënëse në lidhje me këtë çështje:

“Biri im! Zëre se vdiqe sot... Sa keq do të të vijë për momentet e indiferencës që ke kaluar në këtë jetë, duke thënë «ah sikur»!? Mirëpo më kot! (Tashmë nuk mund të kthehesh më pas)”

“Pasi të ketë falur namazin e sabahut, çdo besimtar duhet t'i kujtojë vetes këto gjëra:

« Jeta është kapitali im. Me humbjen e jetës, më humbet edhe kapitali, e atëherë nuk kam më mundësi të fitoj. Kjo ditë që sapo ka filluar është një ditë e re dhe Allahu më ka gositur duke më lejuar të jetoj edhe sot. (Më hapi edhe një fletë të re prej kalendarit të jetës.) Nëse do të ma kishte marrë shpirtin, unë do të dëshiroja të më kthente përsëri në këtë botë, qoftë edhe për një ditë, që të veproja sa më shumë të mira.

Tani supozo se ke vdekur dhe të është dhënë leje të kthehesh vetëm për një ditë në këtë botë... Pra, mos iu afro absolutisht haramëve! Kujdes mos ta kalosh

kot qoftë edhe një çast të kësaj dite, sepse çdo frymë është një mirësi e paçmueshme!»”

Përpjekja më e rëndësishme e të gjithëve duhet të jetë sigurimi i furnizimit për Ahiret, në mënyrë të shpejtë, për sa kohë ekziston ende mundësia. Prandaj nuk duhet të mashtrohemi prej kënaqësive kalimtare e të rrejtshme të kësaj bote. Ne nuk duhet të harrojmë se mirësitë që mendojmë se zotërojmë, ngjajnë me një thesar të gjetur në ëndërr. Siç shprehet edhe i nderuari Mevlana: “Ne duhet të përpiqemi t'i kthejmë të zotit të vërtetë çdo gjë që duhet t'i jepet, para se vdekja të na marrë çdo gjë që na është dhënë!”

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndër-mjetësi! Jobesimtarët janë keqbërësit e vërtetë.” (Bekare, 254.)

Nuk duhet të harrojmë se fryma e fundit është si një pasqyrë e pastër dhe pa njolla. Në këtë pasqyrë, çdo njeri sheh qartë gjithë jetën e vet, me bukuritë dhe shëmtitë e saj. Atë çast, mbi sy dhe zemra nuk ekziston më asnjë perde refuzimi dhe indiference egoiste. Përkundrazi, të gjitha perdet hiqen dhe çdo rëfim e fut mendjen dhe shpirtin në një atmosferë pendese.

Duke respektuar parimin *“vdisni para se t’ju vijë vdekja!”*, ne duhet t'i braktisim sot me vullnetin tonë të gjitha ambiciet egoiste, para se të jemi të detyruar t'i braktisim për shkak të vdekjes. Ne duhet ta përmi- rësojmë veten duke u penduar dhe duke kërkuar falje pa na ardhur vdekja, me qëllim që fryma e fundit të mos jenë një pasqyrë në të cilën do të shohim jetën tonë me pendesë. Pasi të përmbushet afati i panjohur i jetës sonë e të vijë vdekja, atëherë nuk do të kemi mundësi të bëjmë asgjë për Ahiretin tonë, ndërkohë ndjenja e pendesës sonë për jetën e kësaj bote, do të jetë e padobishme.

Koha është mirësia hyjnore më e çmuar e Allahut të Madhëruar për robin e Tij. Koha nuk mund të kthehet pas, nuk mund të kursehet dhe nuk mund merret apo jepet borxh. Edhe vetë Allahu i Madhëruar betohet në kohën, në suren Asr, duke paralajmëruar se ata të cilët nuk e përdorin kohën në besim, në vepra të mira dhe në këshillimin e së vërtetës dhe durimit, janë në humbje të madhe.

Sot është dita që ne duhet të përgatitemi për këtë llogari, e cila do të na sigurojë shpëtimin në Ditën e gjykimit! Ky është çasti për të kryer vepra të mira! Kjo është edhe mundësia që kemi për t'ia kthyer të zotit të vërtetë amanetet që kemi! Po ashtu, kjo është edhe arsyeja e thënies profetike: *“Janë shkatërruar ata që thonë, e bëj nesër!”*, sepse nuk ka asnjë garanci se e nesërja do të arrihet.

Ne duhet të nxitojmë në kryerjen e punëve të dobishme dhe të marrim si parim të jetës sonë këto këshilla të Profetit tonë (a.s.):

3. -Al-i Imran, 92.

“O Njerëz! Pendohuni tek Allahu para se të vdisni! Nxitoni në vepra të mira, para se të përballeni me vështirësi e vuajtje që do t’ju mbajnë të zënë! Përpiquni t’i jepni Allahut të drejtën që ka mbi ju, duke e përmendur shumë Atë dhe duke dhënë sadaka hapur dhe fshehtas, me qëllim që të arrini furnizimin, të merrni ndihmën e Tij dhe të përmirësoheni!” (Ibn-i Maxhe, Ikame, 78.)

UDHËTIMI I SHPIRTIT

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka përshkruar disa tablo prej ndodhive të varrit, Kiametit dhe Ahiretit, me qëllim që ne të meditojmë, të marrim mësim, e të përgatitemi për frymën e fundit dhe për kohën përtej saj:

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se, njëherë i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Kur besimtarit i del shpirti, atë (shpirtin) e presin dy melekë dhe e ngrenë lart.” Më pas, tha se shpirti i besimtarit mban erë të mirë, e cila përhapet rreth e qark. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut, (a.s.), vijoi:

“Banorët e qiellit thonë:

«Sa shpirt i bukur e i mirë po vjen nga toka! Allahu të mëshiroftë ty dhe trupin brenda të cilit ke qenë!»

Më pas, shpirti nxirret menjëherë para Allahut, i Cili urdhëron:

«Dërgojeni atë (në varrin e tij që është si kopsht Xheheti) të qëndrojë derisa të mbarojë jeta e berzahut!»

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut, (a.s.), foli për erën e keqe të shpirtit që del nga trupi i mohuesit, për mallkimin që bie mbi të dhe për faktin se të gjithë duan të largohen prej tij. Ai vazhdoi me këto fjalë:

“Kur del shpirti i mohuesit (banorët e qiellit) thonë:

«Sa shpirt i ndyrë po vjen nga toka!» Më pas thuhet:

«Dërgojeni atë (në varrin e tij që është si një prej gropave të Xhehenemit) të qëndrojë derisa të mbarojë jeta e berzahut!»

Ndërkohë që po rrëfente këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), (për shkak të erës së keqe të shpirtit të mohuesit) kishte vendosur në hundën e tij të bekuar një rrobë të hollë, të cilën e kishte më parë mbi supe.” (Muslim, xhenet, 75.)

Ndërsa Bera ibn Adhib tregon:

Bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), shkuam në xhenazen e njërit prej ensarëve. Kur arritëm tek varri, i vdekuri nuk ishte varrosur ende. Ne u ulëm rreth të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili filloi të shohë sa në tokë e sa në qiell. Ai i ngriti dhe i uli tri herë sytë e tij të bekuar, e më pas u lut:

“O Allah! Strehohem tek Ti prej dënimit të varrit!” Pas kësaj tha:

“Kur vjen koha që një mysliman të ndahet prej kësaj bote, e i afrohet Ahiretit, vjen meleku i vdekjes dhe

ulet tek koka e tij. Prej qiellit zbresin edhe melekë (të tjerë), të cilëve u shndrisin fytyrat si dielli. Ata kanë me vete qefin dhe parfum prej Xhenetit. Këta melekë ulen para njeriut, në vendin ku sheh ai. Ndërkohë meleku i vdekjes thotë:

«O shpirt që ke arritur paqen! Dil që të arrish faljen dhe kënaqësinë e Zotit tënd!»

E ai del (prej trupit) me lehtësi ashtu siç derdhet pika e ujit prej enës.

Melekët e tjerë, pa e lënë atë shpirt goftë edhe sa hap e mbyll sytë në dorën e melekut të vdekjes, e marrin menjëherë dhe e ngrenë në qiell. Sa herë që kalojnë pranë një grupi melekësh, thuhet:

«Kush është ky shpirt i bukur?» Ndërsa melekët që po e ngrenë në qiell, duke e përmendur atë me cilësi të bukura, thonë:

«Ky është filani, biri i filanit!»

Kur arrijnë në qiell, hapen të gjitha portat e tij. Në çdo kat që kalojnë, këtë shpirt e përcjellin melekët “mukarrabun”, pra melekët më të afërt me Allahun, derisa arrijnë në katin e shtatë të qiellit. Më pas thuhet:

«Librin e punëve të tij shkruajeni në Il-lijin!»

E më pas thuhet:

«Dërgojeni në tokë robin Tim, sepse Unë kam premtuar se do t’i krijojë ata prej dheut, do t’i rikthejë në të dhe do t’i nxjerr përsëri prej tij!»

Pas kësaj, shpirti kthehet përsëri në trupin e tij.

Melekët afrohen pranë të vdekurit dhe e pyesin:

«Kush është Zoti yt?»

«Allahu!» -thotë ai.

«Cila është feja jote?» -pyesin ata.

«Islami» -thotë ai.

«Kush ishte ky person që ka dalë prej jush?» -pyesin përsëri ata.

«Ishte i Dërguari i Allahut.» -përgjigjet ai.

«Nga e di këtë?» -pyesin ata.

«Lexova Librin e Allahut, i besova dhe e pranova Atë!» -thotë ai.

Pas kësaj, një zë thërret nga qielli:

«Ka thënë të vërtetën! Përgatitini atij një vend në Xhenet, visheni me rrobat e Xhenetit dhe tregojini vendin e tij në të!»

Më vonë ai person vendoset në varrin e vet, ku i vijnë erërat e Xhenetit dhe flladet e tij të këndshme. Pasi i bëhen këto, pranë tij shfaqet një njeri me fytyrë të bukur, rroba të pastra dhe aromë të mirë, i cili i thotë:

«Gëzohu me gjërat që të pëlqejnë! Kjo është dita që të është premtuar!»

Kur myslimani e pyet:

«Kush je ti? Paskë një fytyrë përgëzuese!», njeriu thotë:

«Unë jam vepra jote e mirë.»

Më pas, myslimani lutet:

«O Zot! Bëje menjëherë Kiametin, që të takohem me familjen dhe pasurinë time (që do të më dhurosh në Xhenet)!»

Pasi tha këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), këndoi ajetin:

“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër...” (Ibrahim, 27.)

Më pas, Profeti (a.s.), vazhdoi:

“Sa i përket gjynahqarit; kur atij i vjen koha të ndahet nga kjo botë e i afrohet Ahiretit, i vjen meleku i vdekjes dhe i ulet tek koka. Nga qielli zbresin melekë me fytyra të nxira që mbajnë në duar rroba të ashpra të bëra prej qimeve dhe ulen para tij, në vendin ku ai sheh. Më pas meleku i vdekjes thotë:

«O shpirt i ndyrë! Dil që të shijosh ashpërsinë dhe zemërimin e Allahut!»

Më pas, shpirti ndahet me vështirësi prej trupit, sikur nxirret një shufër me grepa e ganxha nga leshi i lagur. Madje, bashkë me të (duket sikur) këputen edhe të gjithë damarët dhe nervat (pra aq shumë vuan).

Melekët ngrihen menjëherë dhe pa e pritur shumë atë shpirt, e ngrenë në qiell. Sa herë që kalojnë pranë një grupi melekësh, thuhet:

«Kush është ky shpirt i ndyrë?»

Melekët, duke e përmendur atë me cilësi negative, thonë:

«Ky është filani.»

Kur arrijnë në qiell, dyert e qiellit i mbyllën në fytyrë dhe thuhet:

«Librin e punëve të tij shkruajeni në Sixhxhin!»

E më pas thuhet:

«Dërgojeni në tokë robin Tim, sepse Unë kam premtuar se do t'i krijojë ata prej dheut, do t'i rikthejë në të dhe do t'i nxjerr përsëri prej tij!»

Shpirti i tij hidhet në tokë dhe bie në trupin e tij.”

Pasi sqaroi këtë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), këndoi këtë ajet:

“...Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.” (Haxh, 31.)

Më pas, Profeti (a.s.), vazhdoi:

“Melekët i vijnë gjynahqarit dhe e pyesin:

«Kush është Zoti yt?»

«Nuk e di!» -thotë ai.

Atë moment nga qielli thërret një zë, i cili thotë:

«Nuk ka thënë të drejtën! Përgatitini atij një vend prej zjarrit, vishini rroba të Xhehenemit dhe tregojini vendin e tij në të!»

Varri e shtrëngon aq shumë atë, saqë brinjët i hyjnë njëra me tjetrën. Atij fillojnë t'i vijë era dhe nxehtësia e Xhehenemit. Pas këtyre, pranë tij shfaqet një njeri me fytyrë të shëmtuar, i veshur keq dhe me erë të pështirë, i cili i thotë:

«Përgëzohu me atë që nuk të pëlqen! Kjo është dita që të është premtuar.»

Gjynahqari thotë:

«Kush je ti? Fytyra jote ndjell të keqen!» E ai i përgjigjet:

«Unë jam vepra jote e keqe!»

Pas kësaj, gjynahqari thotë:

«O Zot! Mos e sill fare Kiametin!» (Hakim, Mustedrek, I, (93-95/107. Shih. Ahmed, IV, 287, 295; Hejthemi, III, 50-51.)

UDHËTIMI I TRUPIT

Lidhur me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur xhenazja vendoset në tabut dhe njerëzit (ose burrat) e marrim mbi supe, nëse ai (i vdekuri) njeri ka qenë i mirë thotë:

«Më takoni sa më parë, më takoni sa më parë (me shpërbllimin e punëve të mia të mira)!»

Por nëse nuk është njeri i mirë, fillon e qahet duke thënë:

«Mjerë unë! Ku e çoni këtë tabut?»

Fjalët e kësaj xhenazeje i dëgjon çdo qenie tjetër përveç njerëzve. Nëse njeriu do ta dëgjonte këtë zë, do t'i binte të fikët menjëherë.” (Buhari, xhenaiz, 50, 90, 91.)

Ndërsa Bera (r.a.), e tregon kështu gjendjen e Profetit tonë (a.s.), gjatë përcjelljes së një xhenazeje:

“Bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), gjendeshim në një xhenaze, ku ai u ul në anë të varrit dhe filloi të qajë aq shumë sa toka u lag me lotët e tij. Më pas tha:

«O vëllezërit e mi! Përgatituni pikërisht për një vend të tillë të rëndësishëm!» (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 19.)



EL-ALIJ EL-KEBIR

MË I LARTI I TË LARTËVE - MË I MADHI I TË MËDHENJVE

— Ilir Hoxha —

El-Alij dhe el-Kebir, janë dy emra që shprehin lartmadhërinë e Zotit tonë. Ai që ka krijuar çdo gjë, sigurisht që është edhe më i lartë, edhe më i madh se çdo gjë. Askush nuk ka dyshim në këtë. Por problemi qëndron në faktin se mendjet tona të kufizuara, nuk mund ta perceptojnë dot ashtu siç duhet lartmadhërinë e Tij. Prandaj, ne duhet të dimë dhe të besojmë se Ai është më i lartë dhe më i madh se çdo gjë që mund të mendojmë, sepse kjo na ruan nga gjynahet dhe iluzionet për madhështi.


Cilësitë esenciale të Allahut të Madhëruar, janë përtej kufijve të mendjes njerëzore. Siç shprehet edhe Isfahani, “Allahu është aq madhështor, saqë nuk mund ta përfshijnë as përkufizimet e dijetarëve dhe as intuita e të urtëve”. Kjo pamjaftueshmëri, e bën të papërshtatshme edhe çdo fjalë që flitet në lidhje me këtë çështje. Në fakt, kjo vlen për të gjithë emrat hyjnorë, sepse të kuptosh diçka në mënyrë absolute, duhet ta përfshish atë në çdo aspekt. Një mendje e krijuar, nuk mund ta përfshijë dot Krijuesin e vet. (shih. TaHa 110.) Ajo mund të kuptojë vetëm aq sa mundësi i është dhënë.

Të jesh më i lartë dhe më i madh se çdo gjë tjetër jashtë vetes, do të thotë se je i pavarur nga gjithçka. Ai nuk ka nevojë për asgjë; çdo gjë ka nevojë për bujarinë e Tij. Për këtë arsye, duhet të përkulesh vetëm para derës së Tij dhe të gjitha përgjërimit t’i drejtohen vetëm Atij. Fakti që i Dërguari i Allahut (a.s.), në përgjithësi i fillonte lutjet me dhikër që

përbante emrin “Ali/i Larti”, shpreh strehimin e robit me gjithë dobësinë e vet tek Allahu i Lartësuar.

Fjala “kibr/mendjemadhësi”, rrjedh nga e njëjta rrënjë me emrin “Kebir/i Madh”. Nëse fjala “kibr” i atribuohet njeriut, kjo nënkupton se ai njeri i ka kaluar kufijtë dhe i atribuon vetes madhësinë e Allahut, gjë e cila -Allahu na ruajt- e çon atë deri në shirk (idhujtari). **“Do t’i largoj prej shenjave të Mia ata që sillen me arrogancë në Tokë, kështu që edhe kur të shohin çfarëdo shenje, nuk do ta besojnë atë. Kur të shohin rrugën e drejtë, ata nuk do ta ndjekin atë dhe, kur të shohin rrugën e gabuar, do ta marrin atë, sepse ata nuk i besuan shpalljet Tona dhe nuk u kushtonin vëmendje atyre.”** (A’raf, 146.)

Në përgjithësi, Emrat Ali dhe Kebir, në Kur’an përmenden pranë njëri-tjetrit. Po ashtu, edhe në ajetet ku nuk përmenden së bashku, ata përmenden me emra të tjerë që shprehin Madhërinë e Allahut, si Adhim (shih. Bekare, 255.), Muteal (shih. Rad, 9.) dhe Uluu (shih. Isra, 4.). Nëse i shqyrtojmë këto ajete në mënyrë të përbashkët, vihet re se çështjet kryesore që theksojnë ato, janë ruajtja prej shirkut dhe madhështia e pashoqe e Allahut. (shih. Isra, 43; Lukman, 30; Haxh, 62; Sebe, 23; Gafir, 12.) Realizimi i kësaj, është shumë i rëndësishëm në aspektin e vënies në pah të faktit se përdorimi pavend i koncepteve të sublinitetit dhe madhështisë,



TË BËSH TEKBIK, DO TË THOTË TA MADHËROSH ALLAHUN,
TË MOS IMAGJINOSH ASNJË QENIE MË TË LARTË SE AI, TA
SHOHËSH ATË NË POZITËN MË TË LARTË, TË PRANOSH SE
ÇDO CILËSI E TIJ ËSHTË PAFUNDËSISHT SUPERIORE DHE
TA POHOSH KËTË. NJERIU QË E POHON KËTË NË MËNYRË
TË TILLË, KA REFUZUAR KATEGORIKISHT ADHURIMIN
NDAJ ÇDO QENIEJE TJETËR VEÇ ALLAHUT.

duke ua atribuar ato qenieve të tjera veç Allahut, çojnë në idhujtari.

ALLAHU EKBER

Kur'ani Fisnik na urdhëron të bëjmë tekbiK për Allahun e Madhëruar. (shih. Isra, 111; Muddethir, 3.) Të bësh tekbiK, do të thotë ta madhërosh Allahun, të mos imagjinosh asnjë qenie më të lartë se Ai, ta shohësh Atë në pozitën më të lartë, të pranosh se çdo cilësi e Tij është pafundësisht superiore dhe ta pohosh këtë. Njeriu që e pohon këtë në mënyrë të tillë, ka refuzuar kategorikisht adhurimin ndaj çdo qenieje tjetër veç Allahut.

Shprehja “Allahu Ekber”, që është hiperbolizimi i emrit Kebir, do të thotë, “më i madh se çdo gjë, mbizotëruesi i gjithçkaje dhe i pakrahasueshëm në madhësi”.

Edhe këto dy emra hyjnorë, manifestohen në çdo gjë që bart vlera të larta në sipërfaqen e tokës. Sipas dijetarëve, arritja e gradave të larta në këtë botë dhe në tjetrën varet nga manifestimi i këtyre dy emrave. Ndërsa Gazaliu thotë se pjekuria e mendjes njerëzore mund të matet në sajë të devotshmërisë dhe dijes së tij. Sipas tij, njerëzit tek të cilët manifestohen këto dy emra hyjnorë që shprehin sublinitet dhe madhësi, punojnë me dijen e tyre, orientojnë në rrugën e drejtë njerëzit përreth vetes, janë shembull për të gjithë dhe kanë dobi materiale dhe shpirtërore për këdo me të cilët shoqërohen.

Njeriu që e kupton pak a shumë kuptimin e këtyre emrave, e ruan mendjen e vet prej besimeve të gabuara që nuk i kanë hije madhësitë së Allahut dhe gjuhën e tij prej shprehjeve të shëmtuara. Në këtë mënyrë, ai që e kupton sado pak madhësinë e Allahut, e di shumë mirë se nuk mund ta madhërojë asnjë krijesë siç madhëron Allahun dhe është i vetëdijshëm se duhet të ketë respekt për të gjitha krijesat, sepse ato janë vepra të Krijuesit të Madhëruar. Pra, këto dy emra na ruajnë edhe nga përçmimi i krijesave të Allahut, por edhe nga madhërimi i tyre, duke i hyjnizuar në vend të Allahut. Po ashtu, ata të cilëve u është falur një pozitë e lartë në këtë botë me mirësinë e Allahut dhe kanë dorë udhëheqjen e njerëzve, nuk duhet të harrojnë kurrë se mbi ta gjendet Allahu i Madhëruar. Lidhur me këtë, ajeti 34 i sures Nisa, i cili i përcakton burrat si kryefamiljarë, mbaron duke na kujtuar emrat Ali dhe Kebir, fakt ky, i cili është shumë domethënës.

Në fakt, vlera e vërtetë dhe pozita e njeriut kuptohet nga shprehja e Allahut të Madhëruar, Zotit të botëve, kur i drejtohet atij me fjalën “robi im”. Për rrjedhojë, pozita më e lartë që mund të arrijë njeriu në këtë botë, është lira nga nënshtrimi i çfarëdo gjëje veç Allahut. Ata që e vendosin besimin dhe parimet e tyre mbi çdo interes të kësaj bote, edhe Allahu do t'i ngrejë mbi çdo gjë tjetër.



DUHET TË BËJMË LLOGARINË

— Nuredin Jëlldëz —

**NËSE ALLAHU TEALA
KA DHËNË NJË MIRËSI,
ABSOLUTISHT QË AJO
MIRËSI DO TË KETË EDHE
LLOGARINË PËRKATËSE.
PAVARËSISHT NËSE NE E
BËJMË APO JO LLOGARINË
TONË, DHURUESI I MIRËSIVE
“DO TË NA MARRË NË
LLOGARI PËR TË GJITHA
MIRËSITË”.**

Është e vërtetë se mirësitë e Zotit (xh.xh.), nuk mund t'i mbarojmë së numëruari. Toka dhe qiejt janë të mbushur me mirësitë e Tij. Ne jemi të rrethuar me mirësitë e Tij, që nga fryma të cilën marrim, e deri te çdo gjë që na shikojnë sytë. Elhamdulillah / Falënderimi qoftë për Allahun!

Ditët dhe netët që Allahu Teala na i ka dhuruar dhe të cilat në të vërtetë i shohim si “të bekuara”, janë pjesë të kohës të cilat i vlerësojmë me mangësi, siç bëjmë edhe me mirësitë e tjera të Zotit (xh.xh.). Nëse shqyrtojmë si shembull “Natën e Kadrit”, të cilën e kalojmë si netët e tjera, apo “Natën e Arafatit”, e cila shkrihet në emocionin tonë për festën e Kurban Bajramit, do të ishin të mjaftueshme për të na bindur se jemi të detyruar të bëjmë një llogari për këto. Për cilën mirësi nuk ka llogari? Edhe buka është një mirësi nga Zoti (xh.xh.). Për shkak se bukën e konsiderojmë mirësi, edhe konsumimin dhe shpërdorimin

e saj e bëjmë çështje të llogarisë. Në të njëjtën mënyrë, edhe shëndetin e konsiderojmë si një mirësi që duhet t'ia bëjmë llogarinë. Padyshim se kjo është e drejtë. Nëse një objekt mbart cilësinë e mirësisë dhe poseduesi i saj është Allahu Teala, atëherë duhet të bëjmë një llogari nëse ky objekt gjendet te ne për t'u konsumuar.

Nëse kohën dhe vendet që i vlerësojmë si të bekuara, i konsiderojmë si mirësi që mund të krahasohen me bukën, kjo mund të mos jetë e mjaftueshme. “Nata e Kadrit” dhe “buka” nuk mund të jenë dy mirësi që kanë të njëjtën vlerë. Buka është një mirësi që ka lidhje direkt me këtë botë të përkohshme dhe indirekte me botën e përtejme. Nëse këto dy mirësi do t'i vlerësojmë duke u nisur nga ndryshimi i përkohshmërisë dhe përhershmërisë që ka ndërmjet kësaj bote dhe botës tjetër, do të kuptohet edhe ndryshimi ndërmjet bukës dhe Natës së Kadrit. Ne si robër të Allahut, i Cili është Zoti ynë, sigurisht që e kemi për detyrë t'i vlerësojmë të gjitha mirësitë e Allahut Teala. Në një jetë ku nuk mund ta mendojmë dot as funksionimin pa llogari të buxhetit të një familjeje të thjeshtë, sigurisht që nuk mund të mendojmë se nuk duhet të bëjmë llogarinë e kohës dhe vendeve që i quajmë “të shenjta”. Siç jemi të detyruar të bëjmë llogarinë e ushqimeve përgjatë gjithë jetës, duhet të bëjmë edhe llogarinë se sa “Net Kadri” kemi kaluar. Për ne si besimtarë, kur të ringjallemi, do të jetë e rëndësishme llogaria e Natës së Kadrit.

Çështjen e llogarisë nuk mund ta kufizojmë vetëm me “Natën e Kadrit”. Edhe minutat që kemi kaluar së bashku me një dijetar apo me një mik të Zotit, janë mundësi të vyera që mund t'i fusim në llogari. Kështu duhet të konsiderohen edhe orët që kemi kaluar nëpër rrugët e Mekës. Le të japim një shembull edhe më të qartë: A nuk janë minuta që na çojnë në Xhenet apo Xhehenem edhe segmentet kohore që kalojmë së bashku me prindërit? Pa hezituat aspak, mund të themi po. A nuk e ka mallkuar i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), atë që i ka prindërit gjallë, por që nuk e merr dot garancinë e Xhenetit? A nuk nënkupton kjo se minutat e kaluara me prindërit vlerësohen si Xhenet apo Xhehenem? A nuk është domosdoshmëri e besimit që secili prej nesh të ndjejë emocion për ditët që do t'i kalojë me prindërit, sikur ndjen emocion e shpresë kur pyetet se si ka kaluar në haxh apo umre? Libri që na lajmëron se haxhi

është i shenjtë, është i njëjti Libër që na informon se edhe prindërit janë Xhenet apo Xhehenem për ne. Të qëndruarit me prindërit është një mirësi për të cilën do të merremi në llogari. Prandaj, ne duhet ta konsiderojmë të shenjtë kohën që kalojmë me të gjitha krijesat, për sa i përket aspektit të llogarisë individuale. Ky këndvështrim patjetër që është një përjasje shumë e lartë e shkallës njerëzore. Shkalla njerëzore kërkon që fëmijët të jenë besnikë ndaj prindërve kur atyre t'u afrohet pleqëria, duke marrë parasysh shërbimin që ata u kanë bërë fëmijëve kur kanë qenë të vegjël. Për këtë arsye, fëmijët nuk duhet të jenë mosmirënjohës kundrejt mirësive të prindërve. Këtë nivel njerëzor mund ta gjejmë edhe në tema të tjera. Prandaj, si domosdoshmëri e identitetit tonë prej besimtari, prindërit duhet t'i konsiderojmë si një mirësi që sillet rreth e rrotull Xhenetit dhe Xhehenemit. Vetëm kështu mund ta vlerësojmë siç duhet madhësinë e Dhuruesit të mirësive dhe peshën e rëndë të vetë këtyre dhuratave. Për këtë arsye, caktimin e një dite të vitit si një ditë respekti ndaj prindërve, nën këmbët e të cilëve është vendosur Xheneti, e konsiderojmë absurde, siç është edhe ndezja e qiririt në dritën e diellit.

Nëse Allahu Teala ka dhënë një mirësi, absolutisht që ajo mirësi do të ketë edhe llogarinë përkatëse. Pavarësisht nëse ne e bëjmë apo jo llogarinë tonë, Dhuruesi i mirësive “do të na marrë në llogari për të gjitha mirësitë”. Para se të vijë dita kur Zoti (xh.sh.), do të na marrë në llogari për të gjitha mirësitë, ne e kemi për detyrë që të bëjmë një llogari të logjikshme tonën. Vetëm në këtë mënyrë kemi mundësinë t'i shpëtojmë rrokullisjes në humnerë.

Këtë llogari mund ta praktikojmë edhe në muajin e bekuar të Ramazanit, sepse ne nuk kemi aspak dyshim që muaji i Ramazanit është mirësi, madje është një mirësi e madhe po aq sa vetë jeta. Ne e kuptojmë se kjo mirësi e mrekullueshme është aq madhështorë sa që nuk mund të kalohet me simbole apo të ndriçohet me shpërdorim të energjisë elektrike. Nëse do ta marrim veten në llogari për çfarë ishim para Ramazanit dhe çfarë jemi pas tij, vetëm se do të ndihmojmë veten. Prandaj, një temë kaq të rëndësishme sa muaji i Ramazanit duhet ta shtojmë në dosjen e llogarisë sonë me titullin: Llogaria e Ramazanit.

Gjuba e personalitetit

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Ka sjellje në të cilën ka vlere me shume sesa të folurit

Çdo qytetërim ndërton modelin e vetë të njeriut. Në botën moderne të kulturës kapitaliste dhe klimës globale, shumica e gjeneratave të reja formohen sipas vlerave të sistemit të kohës. Për fat të keq këto vlera përbehet prej formalitetit, më shumë për shënjestër, sesa për vlera thelbësore.


Në botën moderne, kuptimi i zhvillimit personal, ka kuptimin, komunikimin e mirë dhe përdorimin e trupit në mënyrën më efektive. Gjëja më e rëndësishme është të folurit bukur dhe efektiv, ndërsa sinqeriteti në fjalë është një vlerë e shkallës së dytë.

Gjuha e trupit duhet të jetë admiruese, ndikuese dhe mbresëlënëse. Mirëpo karakteri i gjuhës është lërë anash si një çështje që nuk ka vlerë.

Shkencëtari Stephan Covey ka hulumtuar parimet themelore që njeriun e shtyjnë të bëhet shumë efektiv. Përveç kësaj në kohën e fundit janë shkruar edhe libra në lidhje me “zhvillimin personal për një sukses.” Si rrjedhojë e kësaj ka ardhur në këtë përfundim se: “në 50 vitet e fundit librat që janë shkruar rreth suksesit, kanë rezultuar se shumica e tyre janë shkruar formalisht. Sepse këto janë mbushur me imazhe dhe me zgjidhjet e përkohshme. Këto janë plagë për shoqërinë. Këto libra pa i përfshirë problemet e mëdha kanë menduar se janë të mjaftueshëm për shërim. Faktikisht këto nuk kanë shëruar shqetësimet e shtypura madje këto janë shkaqe të plagës, pezmatimit dhe shtimit të sëmundjeve.

Në jetën tonë moderne njeriu lidhjet i ka lënë të formohen vetëm si objektiv mbi interes. Për këtë arsye miqësia, dashuria, vëllazëria dhe ndjenjat si këto nuk po jetësohen në mesin e njerëzve. Njerëzit që largohen nga esenca, faktikisht edhe fjalët dhe veprat e tyre me kohën thjeshtëzohen dhe marrin kahja ka jo e mira.

Qytetërimi Islam, nuk e sheh njeriun të përberë vetëm prej trupit, përkundrazi i jep vlerë shumë të madhe esencës së tij dhe nuk e anashkalon komu-



Gjuha e personalitetit nuk është komunikimi me gjuhë, është komunikim i cili ushqen fjalët dhe u jep jetë dhe ndikim fjalëve tona.

nikimit gjuhësor dhe trupor. Po ashtu i jep rëndësi edhe gjuhës së personalitetit i cili jep forcë më tepër sesa këto dy gjymtyrë.

Në jetën tonë të përditshme, kohë pas kohe takohemi me njerëz të cilët edhe pse nuk janë oratorë të mëdhenj edhe pse nuk e përdorin mirë gjuhën e trupit, kanë ndikim të thellë në rrethin e tyre ku jetojnë. Përveç që ndikojnë me fjalë, ata po ashtu ndikojnë edhe me heshtjen, me shikim, me të ecurit, me buzëqeshje dhe me qëndrim e tyre. Në tubime nderohen dhe mirëprehen. Të gjitha këto ndikime ata nuk i fitojnë për shkak të dije, pasurisë ose pozitës së tyre. Sepse ata posedojnë diçka shumë të rëndësishme pra posedojnë të folurit me gjuhën e personalitetit.

Çdo kush nuk mund ta flet këtë gjuhë. Këtë gjuhë mund ta flet vetëm ai që posedon personalitet të lartë.

Fjalët e kësaj gjuhe janë ndërkombëtare. Në komunikim të gjuhës në bazë të vendit dhe kombit mund të këtë ndonjë dallim por në gjuhën e personalitetit nuk ka ndryshime. Për ta kuptuar këtë gjuhë në fillimin e krijimit të njeriut i është dhënë kjo esencë njeriut. Andaj njeriu në rast se nuk e ka humbur në esencën nga personaliteti i tij mund të kuptoi këtë gjuhë.

Në periudhën e fundit, dijetari i famshëm M. Hamdi Jazër mbante ligjërata dhe diskutime të ndryshme të hapura për publiku. Nxënësi i këtij dijetarit e tregon një ngjarje shumë interesante. Ky dijetari ka qenë mësuesi i Tefsirit ku diskutimet dhe debatet që i bënte kanë qenë të nivelit të lartë sepse edhe shumica e pjesëmarrësve përbëheshin prej intelektualëve. Në këto ligjërata marrte pjesë edhe një njeri i cili vetëm dëgjonte dhe nuk ndërhynte në diskutime. Ai vetëm rrinte i qetë në një qoshe dhe me një oreks të madh përfitonte nga ligjëratat. Ky njeri kur hynte në mexhllis mësuesi M. Hamdi Jazër e respektonte dhe ia rregullonte ulësen në shenjë respektit ndaj tij dhe të tjerët ndikoheshin nga kjo sjellje e tij. Më vonë mësuam se ky njeri kishte qenë Rebi Molla. Ky njeri kishte qenë një myslimani i devotshëm dhe një njeri modest, i cili nuk kishte asnjë pozitë.

Rebi Molla në tubim qëndronte i qetë por gjuha e personalitetit të tij ndikonte rrethin e tij. Ai faktikisht ishte i ulur mbrapa por në zemrat e pjesëmarrësve ka qenë në rend të parë.

Ka heshtje e cila ndikon më shumë se fjala. Ka shikim që ndikon direkt në zemër ku ndjenjat më negative i shndërron në ndjenja pozitive. Ka qëndrim që ndikojnë më shumë sesa lëvizjet. Ka ecje të cilën Allahu thotë ky është robi im veç ec përpara.

Pra, gjuha e personalitetit është ajo e cila i jep këto aftësi dhe këtë forcë.

Gjuha e personalitetit nuk është komunikimi me gjuhë, është komunikim i cili ushqen fjalët dhe u jep jetë dhe ndikim fjalëve tona.

Gjuha e personalitetit nuk është komunikimi me gjymtyrë, është komunikim i thellë që bënë të kuptueshëm ata që duken të pa kuptueshme dhe reflekton në një forcë madhe ndikuese.

* * *

Në vitin 1982 në Universitetin Gazi studentet e prisnin në klasë profesorin e lëndës 'Ekonomia e Turqisë'. Mirëpo studentet gjatë pritjes së profesorit bënin zhurmë. Pas pak profesori hyri në klasë dhe u ndal para tabelës ku shkroi në tabelë numrin një.

Ju tha: "Shikoni, ky është numri një, ky simbolizon personalitetin, gjëja më e vlefshëm në jetë."

Pas numrit një shënoi një zero, dhe tha; "Ky simbolizon suksesin." Suksesi, personalitetin prej njëshiti e shndërron në dhjetë.

Pastaj shënoi edhe një zero tjetër. Kjo është përvoja. Përvoja dhjetëshin e shndërron në njëqind.

Profesori vazhdoi të shënoj zero pas zeros prapë zero. Duke treguar se kjo është aftësia, disiplina, dashuria etj.

Pastaj e merë shpuzën dhe fshin numrin një. Tani a ka ndonjë vlerë i pyet studentët? Ata i thanë jo.

Atëherë të dashur student, njëshi është personaliteti i çdo njeri, nëse e humbni personalitetin juve nuk ju mbetet asnjë vlerë.

Pra gjuha e karakterit është personaliteti, që nuk shihet, por që posedon pjesën shpirtërore e cila vërehet. Ajo forcon fjalën dhe gjuhën e trupit. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për virtytet që ndikojnë në personalitetin tonë. Sepse virtytet janë esenca jonë. Prandaj ne duhet që këto virtytet t'i shtojmë dhe të koncentrohemi sa ma shumë në rritjen e tyre.

Tani do të bëjmë fjalë për dinamikat më të vlefshëm që kanë të bëjnë me gjuhën e personalitetit.

DINAMIKAT ME KRYESORE TË GJUHËS SË PERSONALITETIT JANË:

Sinqeriteti, Ndershmëria
Drejtësia dhe balancimi
Bujaria, Besueshmëria
Modestia

Duke mos ngarkuar askënd
Të largohesh nga gjërat e kota
Të pasurohesh me edukatë dhe mirësjellje

Përktheu Mag. Gençer Dirvari



I dituri dhe varkëtari

Një i ditur që e njihnte shumë mirë gramatikën, mori me qira një varkë për të kaluar në anën tjetër të ngushticës së Bosforit. Ai u ul në varkë plot mendjemadhësi. Kur arritën në mes të ngushticës, i dituri e pyeti me mburrje varkëtarin:

“A e njeh ndopak gramatikën?”

Varkëtari iu përgjigj:

“Jo zotëri, nuk di asgjë prej atyre që po flisni.” I dituri ia ktheu:

“Sa keq! Të paska shkuar dëm gjysma e jetës!..”

Pasi lundruan për një kohë me varkë, filloi një furtunë. I dituri filloi të kishte frikë.

Sado që varkëtari u mundua, nuk arrinte dot të shkonte më përpara prej furtunës. Kur e kuptoi se nuk do të kalonin dot në anën tjetër, e pyeti të diturin:

“A di not?”

I dituri iu përgjigj plot shqetësim:

“Për fat të keq nuk di. Unë nuk kuptoj nga këto gjëra.”

Atëherë varkëtari ia ktheu:

“Sa keq! Tani do t’ju shkojë dëm e gjithë jeta! Ah sikur të mësonit notin si unë në vend të gramatikës dhe të shpëtonit jetën!”

AFORIZËM

“Të kërkosh për të qenë përsëri i ri është si kthimi te vija e fillimit e një kali që e ka përfunduar garën duke dalë i pari.”

(Ciceroni)

LUTJE

“O Allah! Prej Teje kërkoj udhëzim, devotshmëri, ndershmëri dhe pasuri shpirtërore!”

(Muslim, Dua, 72.)

Dy fjalë

— Ferudun Ozdemir —

Hasan Basriu, një ndër dijetarët e kohës, teksa po udhëtonte me miqtë e tij, ndeshi rrugës djalin e njërit prej udhëheqësve të shtetit, i cili shoqërohej nga një numër i madh shërbëtorësh. Hasan Basriu pasi e përshëndeti të riun iu drejtua me fjalët:

- O ti djalë i udhëheqësit të shtetit! Ti dhe soji yt, vlerësoni gjithçka sipas parasë. Dua t'ju shes dy fjalë. I pranon? Askush përveç meje nuk ka guxim të t'i shesë. Këto fjalë do të të ndriçojnë rrugën e vërtetë!

Djali pyeti:

- Çfarë do në këmbim?

- Për fjalën e parë një monedhë argjendi, ndërsa për të dytën dy. -u përgjigj Hasan Basriu.

- Në rregull. - tha djali.

Hasan Basriu nisi të flasë:

- O ti djalë i udhëheqësit të shtetit! A ke shtëpi?

- Po kam! - u përgjigj ai.

- E ke ndërtuar vetë, apo e ke trashëguar nga babai yt? - e pyeti Hasan Basriu.

- Jo, e kam ndërtuar vetë. - u përgjigj djali.

- Sa kohë t'u desh ta ndërtoje? - vazhdoi Hasan Basriu.

- Shumë kohë. - tha djali.

- Përse vonove kaq shumë kohë ndërkohë që mund ta përfundoje më shpejt? - e pyeti Hasan Basriu.

- Nuk desha që kafshët të lodheshin përtej mundësisë së tyre, prandaj urdhërova që punët të kryheshin me ngadalësi. -u përgjigj djali.

Pas kësaj Hasan Basriu tha:

«O djalë! U tregove i mëshirshëm ndaj kafshëve, por nuk tregohesh i vëmendshëm ndaj vetes tënde

duke e lënë egon të të pushtojë. Orteku i gjynaheve të ka mbuluar dhe ti akoma pandeh se frymon?!»

Djali u trondit nga këto fjalë, menjëherë zbriti nga kali dhe iu afrua Hasan Basriut me mirënjohje duke i thënë:

- Do të të jap menjëherë dy monedhat e tjera, të lutem më thuaj fjalën tjetër.

Më pas Hasan Basriu vazhdoi duke e pyetur:

- Për ku je nisur kështu?

- Jam nisur drejt mbretit për të marrë një detyrë të rëndësishme. -u përgjigj ai.

«Shoh se paske veshur rrobat më të bukura, qenke parfumosur me miskun më të shtrenjtë. Përse? Sepse dëshiron të paraqitesh denjësisht përballë mbretit dhe shpurës së tij. Po, a nuk janë edhe ata njerëz, si unë e si ti? Tani më lejo të të pyes, kur t'ia dorëzosh shpirtin Pronarit të vërtetë a nuk do turpërohesh para Tij, pejgamberëve dhe besimtarëve të devotshëm për gjithë ato gjynahe të panumërta që ke grumbulluar ndër vite?»

Pas këtyre fjalëve, i riu, i përfshirë thellësisht në ndjenjën e pendimit, i dorëzoi kalin shërbëtorit dhe hoqi dorë përjetësisht nga detyra e tij duke bërë një jetë të thjeshtë nën shërbimin e këtij njeriu të devotshëm.

Çdo gjë që fiton në këtë botë nuk është gjë tjetër veçse një amanet. Mos mendo se e ke fituar vetë! Është Allahu ai që të ka dhuruar forcën dhe mundësinë për ta arritur. Asgjë nuk është e jotja, pronari i vërtetë është vetëm Allahu. Nëse gjatë kësaj bote të është dhuruar diçka, dije mirë se kjo është mirësi e Tij. Mos u krekos me pasurinë e pozitën tënde, sepse Ai që jep, mund edhe të marrë. Edhe nëse nuk merr, dije mirë se një ditë do të vdesësh dhe asgjë nuk do mund të marrësh me vete.

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



NEVOJA

për Zotin

— Ferit Piku —

Zoti thotë në Kuranin fisnik: **“O ju njerëz! Ju të gjithë jeni të nevojshëm për Allahun e Allahu është i panevojshmi, Ai është i pasuri, Ai është i Lartësuari, madje nëse Ai dëshiron, ju fshin juve nga faqja e dheut dhe sjell krijesa të tjera e kjo gjë nuk është aspak e vështirë për Zotin”.** (Fatir, 15-17).

Kur jemi sëmurë, jemi ne ata që i lutemi Zotit dhe jo anasjelltas, sepse Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës dhe Ai nuk sëmuret kurrë. Kur kemi uri dhe etje, jemi ne ata që i drejtohem Zotit dhe jo anasjelltas, sepse Allahu (xh.sh) është Furnizuesi

i gjithçkaje në qiej e në tokë. Kur na afrohet vdekja e rrezikohemi nga të katër anët, jemi ne ata që i përgjerohem Zotit që të na ndihmojë.

Kush është i nevojshëm për tjetrin? Kush ka nevojë për ndihmë? Kush e ndjen veten të dobët e të pafuqishëm? E kush tjetër përveç nesh, njerëzve. Ne jemi fukarenj përpara Zotit. Ne jemi gjithmonë të nevojshëm për Zotin. Por puna e njeriut është e çuditshme. Nevojën ia kemi Zotit, Ai i zbret mirësitë drejt nesh, ndërsa drejt Tij shkojnë gjynahet tona.

Allahu (xh.sh) na zbret të mirat, ne ia kthejmë me gjynahe. Ai na afrohet edhe pse nuk na e ka fare nevojën, ndërsa ne i largohemi Allahut (xh.sh), pa e ditur se gjithmonë do të kemi nevojë për të. Megjithatë Ai përsëri është Falës e Mëshirues. Sa herë ta kërkojmë, ne do ta gjejmë Allahun (xh.sh) Falës e Bujar të madh. Kjo do të vazhdojë derisa të lindë dielli nga perëndimi e përderisa të arrijë shpirti në fyt. Nëse ne i afrohem Allahut (xh.sh), Ai vrapon drejt nesh. Nëse ne themi një herë: “O Zot”, Ai përgjigjet: “Ja ku më ke o robi Im. Jam afër teje, ty të kam pritur”. Ne jemi gjithmonë të nevojshëm për Zotin dhe Allahu (xh.sh) na mundësoftë, që gjithmonë ta ndjejmë këtë nevojë që kemi për Zotin.

Sa më shumë të hyjë besimi në zemër, sa më shumë të rritet besimi në Zot, aq më shumë do ta ulë njeriu hundën e tij përpara Zotit. Nga ana tjetër, sa më shumë të dobësohet besimi në zemër, aq më shumë i rritet hunda njeriut, i rritet egoja dhe i duket se nuk ia ka nevojën Zotit, por Allahu (xh.sh) thotë: **“Kur të të duket se nuk ma ke nevojën Mua, Unë do të të bëj që të kesh nevojë për njerëzit”.**

Besimtarët më të mëdhenj të Zotit janë profetët e Tij. Secili prej tyre ka kaluar vështirësitë e kësaj



dynjaje. Në momentet më të vështira do të shohësh përgjërimit dhe dobësinë që kanë treguar këta profetë përpara Allahut (xh.sh). Të gjithë i janë lutur Zotit me përgjërimit: “O Zot ne jemi të pafuqishëm e të dobët, prandaj të lutemi Ty që të na ndihmosh”.

Shiko **Ibrahimin (a.s)**. Ishte djalë i ri, kur i prishi idhujt e popullit të tij. E kërcënuan me djegie në zjarr. Një muaj rresht mblodhën dru. Aq të madh e bënë zjarrin, sa që vetë Ibrahimin (a.s) e vunë në katapultë, sepse nuk i afroheshin dot zjarrit. Kur zogjtë kalonin sipër këtij zjarri, përcëlloheshin dhe binin brenda në të.

Kur e hodhën Ibrahimin (a.s) në mes të këtij zjarri, Xhibrili (a.s) shkoi dhe i tha: “O Ibrahim a ke nevojë për ndihmë”? Ibrahimin (a.s) ia ktheu: “Për ty nuk kam nevojë, kurse për Zotin kam gjithmonë nevojë. Hasbi-Allahu ue nia’mel uekil (Zoti më mjafton mua, Ai është Mbështetësi më i mirë)”.

Profeti (a.s) na ka mësuar, se kur të jemi në rrezik, duhet të bëjmë këtë dua (lutje): “Hasbi-Allahu ue nia’mel uekil” dhe Allahu (xh.sh) na përgjigjet menjëherë. Atëherë kur Ibrahimin (a.s), ky djalë i ri, i pafuqishëm, i cili nuk kishte asnjë forcë kundër atyre që e hodhën në zjarr, u dorëzua totalisht tek Zoti, Allahu (xh.sh) tha: **“O zjarr bëhu i ftohtë dhe paqe për Ibrahimin”**. (Enbija, 69). Kur njeriu dorëzohet tek Zoti, i vjen ndihma aje ku nuk ia pret mendja.

E pyetën profetin (a.s): “O profet i Zotit. A ke parë ditë më të vështirë se dita e Uhudit”? Profeti u përgjigj: **“Po, ka qenë dita kur shkova në Taif. I ftova tek Zoti e ata më dëbuan”**. Atë ditë pasi e dëbuan nga Taifi, profeti (a.s) është ulur në hijen e një peme dhe ka thënë: **“Zot Ty të ankohe për dobësinë time. Ty të ankohe, se nuk kam zgjidhje. Ty të ankohe se njerëzit po më vënë nëpër këmbë. Ti je Zoti i të gjithë të dohtëve, Ti je edhe Zoti im. Në dorën e kujt do të më lesh? A në dorën e armikut që ka pushtet mbi mua, apo në dorën e atij që gjithmonë më largon? O Zot, nëse Ti nuk je i mërëzitur me mua, për mua nuk ka fare problem”**. A ka nevojë më të madhe se në këtë moment. Profeti (a.s) ishte dorëzuar totalisht tek Zoti. Në këto moment i vjen meleku i maleve dhe i thotë: “O Muhamed! Zoti të sjell selam. Ai e ka dëgjuar lutjen tënde. Unë jam engjëlli i maleve. Një shenjë dua prej teje dhe unë do ta shkatërroj popullin e Taifit bashkë me popullin e Mekes. Më ka dhënë Zoti urdhër, që nëse ti dëshiron, unë i fshij këta njerëz nga faqja e dheut”. Por çfarë tha profeti (a.s) që ishte mëshirë e dërguar për botët: **“Jo, unë**

shpresoj që një ditë nga fëmijët e tyre do të dalin njerëz, që thonë fjalën “Allah” me zemër dhe do të jenë besimtarë”.¹

Është treguar në historinë islame për një njeri të mirë, i cili ishte nisur për në Qabe. Dikush e ndaloi rrugës dhe i tha: “Nëse do të shkosh në Qabe, eja pas meje se do të ta tregoj unë rrugën”. E futi në disa rrugë të huaja, që ky person nuk i njihte. Atëherë ky person i tha: “O njeri ku po më çon kështu. Jam nisur për në shtëpinë e Zotit, për në Qabe. A e di mirë rrugën”. Por tjetri ia ktheu: “Eja pas meje se unë di disa rrugë të shkurtra”. E çoi në një luginë të frikshme, atje ku nuk kishte këmbë njeriu. Atëherë kthehet nga ky njeri dhe i thotë: “Sot do të vdesësh, sepse unë do të të vras”. Ky njeri i tha: “Kij frikë Zotin! Unë jam nisur për në Qabe, prandaj më ler të shkoj”. Por vrasësi i tha: “E kam vendosur që të të vras, por thuaj dëshirën e fundit”. Burri i thotë: “Merre pasurinë time e më ler të shkoj në Qabe”. Tjetri ia ktheu: “Pasinë do të ta marr, por edhe kokën do të ta heq”. Atëherë ky njeri tha: “Më jep kohë dy minuta, sa të fal dy rekate namaz e nuk dua gjë tjetër prej teje”. Tjetri ia ktheu: “Falu, por mos e zgjat shumë”. Burri filloi namazin, por i harroi të gjitha. Madje harroi edhe suren Fatiha, që e lexonte me dhjetëra herë. Vetëm një ajet i kujtohej: **“Kush është ai që i përgjigjet hallexhiut kur ai ka hall, kush është ai që i a largon të keqen njeriut, kush është ai që ju bën juve mëkëmbës në tokë, a ka Zot tjetër veç Allahut. Sa pak që kujtoheni o njerëz”**. (Neml: 62). Me këtë ajet i fali dy rekate dhe pasi mbaroi namazin, iu drejtua Zotit me këtë lutje: “O Allah, o i Dashur, o i Afërt. O Ti që je Zoti i Arshit të madh, o Ti që bën çfarë dëshiron, më ndihmo, më ndihmo, më ndihmo”. Pa e mbaruar akoma lutjen, vjen një kalorës i bardhë që e vret hasmin e këtij njeriu. Ky person çuditet dhe thotë: “Kush je ti që vjen e më ndihmon”. Kalorësi përgjigjet: “Unë jam meleku i qiellit të katërt. Kur ti u lute me këto fjalë, kanë krisur qiejt dhe engjëj e tre qiejve kërkuan që të vinin dhe të të ndihmonin ty. Ndërsa unë i thashë Allahut (xh.sh): “O Zot ma jep mua këtë nder, të shkoj e ta ndihmoj unë këtë njeri” dhe Zoti ma dha mua këtë nder. Kam ardhur nga qielli i katërt për të të ndihmuar ty”.

Kur njeriu dorëzohet totalisht përpara Zotit, shkunden qiejt dhe melekët vijnë me vrap për t’i ardhur në ndihmë njeriut. Zoti na bëftë nga ata njerëz, që gjithmonë e ndajnë nevojën ndaj Tij.

1. **Hadith i pranuar**. Taberaniu në Kebir (13/181). Hejthemiu në Mexhmauz’zeuaid (6/35) thotë: “E shënon Taberaniu në Kebir dhe në vargun e përcjellësve është Muhamed ibn Is’haku, i cili është i besueshëm por errëson vargjet e hadithit. Përcjellësit e tjerë janë të besueshëm”. Ibn Kajimi në Zadul Mead thotë: “Ky hadith është madhështor”.



Dijetarët janë ata që e njohin Zotin. Nëse ata i mbështeten egos së tyre, nëse besojnë tek gjuha dhe oratoria e tyre, nuk janë dijetarë. Dijetarët e vërtetë kanë frikë Zotin. Ata përgjërohen dhe dobësinë e tyre e shprehin gjithmonë përpara Zotit. Ata nuk e shesin fenë e Zotit me pazaret e kësaj dynjaje. Këta dijetarë kanë pasur disa lutje, me të cilat i janë drejtuar Zotit: “O Zot mos e dëno gjuhën time që u flet njerëzve për ty, sepse unë e meritoj dënimin, por të paktën këtë gjuhë mos e dëno se i flet njerëzve për ty. O Zot mos e dëno syrin tim, sepse u thotë njerëzve: “Shihni se çfarë ka krijuar Zoti”. Mos e dëno dorën time o Zot, sepse shkruan hadithin e profetit Tënd”.

Hasan el Basri thoshte: “Zoti ka zbritur 104 libra e fletushka. Sekretin të gjitha këtyre e ka mbledhur në 4 libra. Sekretin e 4 librave e ka vendosur Zoti në Kuran. Sekretin e gjithë Kuranit e ka vendosur në suren Fatiha dhe sekretin e kësaj sureje e ka vendosur tek ajeti: “**Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje kërkojmë ndihmë**”. (Fatiha, 4)

Ne e themi me dhjetëra herë në ditë këtë fjalë, por kush e thotë këtë fjalë me zemër, ai ka kuptuar sekretin më të madh të Zotit. Adhurimi është për Ty o Zot dhe ndihma vjen vetëm prej Teje. Të gjithë të gjallët një ditë do të vdesin dhe Ai që nuk vdes është Zoti i gjithësisë. Atë nuk e kap vdekja. Ai ka qenë, është e gjithmonë do të mbetet.

Ai që sot është drejtor, nesër do të ndërrohet. Ai

që sot është i fortë, nesër do të dobësohet, ai që sot është i pasur, nesër mund të varfërohet, ai që sot është diktator, nesër do të largohet. Të gjithë krijesat do të largohen e Ai që mbetet është vetëm Zoti.

Mos iu dorëzoni këtyre krijesave, se janë krijesa si puna juaj. Mos e shprehni nevojën tuaj para askujt tjetër përveç Zotit. Ibrahim (a.s) kur shihte popullin e tij që adhuronin diellin dhe hënën, pasi ata perëndonin, thoshte: “Unë nuk i dua ata që ikin”. Dielli dhe hëna ikin, ndërsa Ai që është Zoti mbetet gjithmonë.

Lindim vetëm me lejen e Zotit të gjithësisë. Kur te vdesim, përsëri do të vdesim vetëm me urdhrin e Zotit. Kur të merremi në llogari, do të llogaritemi vetëm me urdhrin e Zotit dhe me dijen e Tij. Kur të hyjmë në xhenet, do të hyjmë vetëm me mëshirën e Zotit të gjithësisë. Atëherë për kë je i nevojshëm?! Vetëm për Allahun (xh.sh). Prindërit e tu që kanë sakrifikuar gjithçka për ty, në këto moment të lënë vetëm, sepse kanë hallin e tyre. Në atë moment ke vetëm Zotin e gjithësisë dhe vetëm Ai mund të të shpëtojë.

Harun Rashidi ka qenë një halife i madh. Kur i erdhi vdekja, u tha njerëzve të tij: “Më hiqni nga krevati dhe më vendosni mbi dhé”. I thanë: “O prijësi i besimtarëve! A bën që trupi yt të vendoset mbi dhé”? Ai ua ktheu: “Ore më dëgjoni mua, më vini në tokë, se sot nuk ka shtrat. Kam turp të më vijë meleku e të më gjejë në shtratin e vdekjes.

A E DI TI SE ÇDO TË THOTË TË LUTESH?
DO TË THOTË T'Ë DREJTOHESH ZOTIT
ME PËRGJËRIM, TË TË DRIDHEN DUART
E ZEMRA. A E NDJEN TI SE NË KËTË
MOMENT JE I NEVOJSHËM PËR ZOTIN? SA
MË SHUMË TË TREGOSH NEVOJËN PËR
ZOTIN, SA MË SHUMË TA ULËSH KOKËN,
TË JESH I SIGURT SE AI DO TË TË JAPË
ZGJIDHJE PËR ÇDO HALL QË KE.

Pasi u shtri mbi dhé, tha këto fjalë: “O Zot, O Ti që kurrë nuk të mbaron pushteti, mëshiroje robin Tënd Harun Reshidin, që sot i mbaroi pushteti”. Thuhet që Zoti me këtë dua (lutje) e ka falur Harun Reshidin.

Ibn Kajjim el Xheuzije thoshte një fjalë të bukur: “Trokita në derën e atyre që falin namaz dhe gjeta shumë të tillë. Trokita në derën e atyre që agjëronin dhe pashë që kishte shumë më tepër. Trokita në derën e atyre që kanë nevojë për Zotin dhe pashë se kishte shumë pak njerëz. Prandaj trokisini në atë derë. Kush troket aty, Zoti nuk do ta kthejë kurrë mbrapsht, sepse aty ka vend për të gjithë”.

Muhamedi (a.s) lutej me këtë dua‘ (lutje) dhe na mëson, që edhe ne të lutemi me të: **“O Zot më mundëso që jetën ta jetoj si i nevojshëm, shpirtin ta dorëzoj si i nevojshëm dhe ditën e Kijametit më ringjall me njerëzit e nevojshëm. O Zot mos e ler veten time në dorën time sa hap e mbyll sytë, se atëherë shkatërrohem”**.²

Le ta tregojnë dobësinë tonë përpara Zotit. Kush është fukara përpara Zotit, Zoti do ta bëjë atë njeri me të pasurin, që nuk do t’ia ketë nevojën asnjë krijese. Kush e ngre hundën para Zotit, Zoti do ta bëjë atë njeri të nevojshëm për krijesat më të ulëta. Kush nuk ia dorëzon veten e tij Zotit, do t’ia dorëzojë veten e tij krijesave si puna e tij.

2. **Hadith i vërtetë.** Tirmidhiu (2352) dhe Ibn Maxheh (4126). Shejh Albani e vlerëson hadithin të vërtetë, ndërsa shejh Shuajbi të dobët.

A e di ti se çdo të thotë të lutesh? Do të thotë t’i drejtohesh Zotit me përgjërime, të të dridhen duart e zemra. A e ndjen ti se në këtë moment je i nevojshëm për Zotin? Sa më shumë të tregosh nevojën për Zotin, sa më shumë ta ulësh kokën, të jesh i sigurt se Ai do të të japë zgjidhje për çdo hall që ke. Ne i bëjmë ruku vetëm Zotit. Lutju Zotit në këtë gjendje, se Zoti e do shumë këtë gjë. Ne i bëjmë sexhde vetëm Zotit. Lutju Atij kur je në sexhde, se je më afër Zotit se në asnjë vend. Kush i lutet Zotit në sexhde me gjithë zemrën e tij, ta dijë se Zoti nuk e kthen mbrapsht këtë lutje.

Profeti (a.s) thoshte: **“Kush e ul veten përpara Zotit, Zoti gjithmonë do të ngrejë atë njeri. Kush nuk e ul hundën para Zotit, Zoti gjithmonë do ta ulë atë person”**.³

Zoti na lartësoftë e mos na poshtëroftë. Lusim Zotin të mos na largojë asnjëherë nga mëshira e Tij. Allahu i dhashtë dobësisë sonë, forcë nga forca e Tij. Allahu na mundësoftë që gjithmonë ta ndejmë nevojën për madhështinë e Tij. E lus Zotin e gjithësisë, që gjithmonë të na ketë në kujdesin dhe në mëshirën e Tij. Zoti mos na bëftë të nevojshëm për krijesat, por vetëm për Krijuesin, Allahun (xh. sh). E lusim Zotin të mos e lerë veten tonë në dorën tonë qoftë edhe sa hap e mbyll sytë.

Amin!..

3. **Hadith i dobët.** Bejhakiu në Shuabul iman (7790). Paragrafi i parë i hadithit është i vërtetë. Shiko musnedin e Ahmedit (1/44).

Ti je XHENETI IM

— Halime Demiresnik —

Filluan të ecnin në heshtje. Mësuesja Saxhide u tremb nga qetësia e Amines. A mos vallë nuk kishte dëshirë të vinte? A ishte duke u shpejtuar, a ishte duke i bërë presion? Ajo e këshillonte pa pushim Aminen. Mos vallë vajza kishte filluar ta ndjente veten mëkatore dhe të pa vlerë? Nuk duroi më dhe tha:

“E dashur Amina, sikur je ftohur pak. Unë të flas pa pushim dhe si duket të kam mërzitur...”

“Jo, jo!.. Unë isha duke menduar. Më keni thënë që jeta është e mbushur me surpriza... Teksa po ecim, sytë e mi fiksojnë vitrinat shumëngjyrëshe të dyqaneve, por mendja më rri tek personi që po shkojmë të takojmë! Jam duke u përpjekur që të mendoj për surprizat që na bën jeta. Sa shpejt ndryshojnë gjërat. Njerëzit që mendoja se i njihja më kanë dalë shumë ndryshe nga pretendimet e mia. Motër Saxhide, si është njohur shoqja juaj me zonzjën Zylejha?”

“Ajo është njohur me anën e një mësueseje, të cilën e vlerëson shumë. Mësuesja i paska thënë që të shkante të njëjhej me të dhe t’i kërkonte duanë e saj... Me anë të asaj shoqes u njoha edhe unë me Zylejhanë... Shtëpia e saj është e mbushur me njerëz të cilët kanë probleme dhe gjejnë ngushëllim tek fjalët e Zylejhasë... Allahu i ka larguar disa perde asaj dhe e ka lartësuar në botën e shpirtit... Zylejhaja merr letra edhe nga burgu dhe u jep përgjigje atyre letrave. I këshillon që të pendohen dhe të kthehen në rrugën e drejtë. Njerëz me profesione shumë të ndryshme e vizitojnë dhe i kërkojnë që të bëjë dua për to.”

“Jam bërë shumë kureshtarë!”

“Pas pak do ta shuash kureshtjen, mbërritëm.”

I ranë ziles. Një grua me fytyrë të qeshur u doli tek dera dhe i ftoi të futeshin brenda në shtëpi.

Hynë brenda një shtëpie të vogël, përballë derës ndodhej një dhomë e vogël... Nën dritare kishte një shtrat dhe e mbuluar me batanije të gjelbër po buzëqeshte një vajzë e dobët... Një njeri i cili nuk e dinte që Zylejhaja ishte e paralizuar, mund të mendonte se dobësia që kishte i vinte nga ndonjë grip apo ndonjë sëmundje tjetër e lehtë; buzëqeshja e saj nuk të linte të kuptoje një vuajtje aq të madhe. Si mund të ishte kaq i lumtur një njeri që kishte njëzet e shtatë vite e paralizuar?! Me një zë të ëmbël tha:

“Kush paska ardhur, hajde e dashur Saxhide! Më paska marrë malli shumë për ty...”

Mësuesja Saxhide iu përgjigj:

“Edhe mua më ka marr malli e dashur Zylejha! Ju kam sjell një shoqen time, Amina...”

“Hajde bukuroshe, paske emër shumë të bukur!”

Amina u përkul për t’ia puthur dorën. Kur iu afrua e vuri re që gishtat e dorës të Zylejhasë ishin të kthyer nga brenda. Duart ia kishin lidhur me kordele të vogla shumëngjyrëshe, në mënyrë që të mos deformoheshin plotësisht... Amina u habit dhe nuk dinte se çfarë të bënte. Zonja Zylejha i tha:

“Ato janë unazat e mia të fejesës, a u habite? Hajde të të puth!..”

Amina e përqafoi. Zylejhaja mbante një erë shumë të mirë. Aminës i erdhi në mend një kushërirë e veta që ishte e paralizuar, ajo mbante erë ilaçesh dhe ankohej gjatë gjithë kohës. Ajo nuk i lejonte që ta preknin, jo më ta përqafonin. Një sëmundje e njëjtë, por dy mënyra krejt të ndryshme sjell-

jesh...

Zylejhaja filloi të fliste përsëri me zërin e saj të ëmbël:

“Uluni përballë meje, sepse kam dëshirë që t’ju shikoj sytë. Natën kur jam duke bërë dua gjithmonë më vijnë në mendje sytë dhe mendoj: ‘O Allahu im, je Ti ai që m’i kujton sytë; kjo do të thotë që dëshiron t’ua plotësosh dëshirën e zemrës së tyre dhe kërkon që unë të bëj dua për ta.’

Mësuesja Saxhide dhe Amina u ulën tek kanepeja që ndodhej tek këmbët e shtratit. Sa kishin filluar të bisedonin, kur ra zilja. Zonja Zylejha tha:

“Do të jenë vajzat nga gjimnazi, që kishin dëshirë të vinin për vizitë...”

Në dhomë u futën rreth njëzet veta të moshës 17-18 vjeçe. Teksa Amina po mendonte se si do t’i nxinte të gjithë ato njerëz një dhomë aq e vogël, Zylejhaja interesohej për secilën prej tyre, i pyeste për emrat dhe i përqafohte me radhë. Pas përhëndetjes vajzat u ulën. Dukej qartë se edhe ato vinin për herë të parë. Amina po qëndronte në qetësi duke ndjekur zhvillimin e ngjarjes.

Zonja Zylejha pyeti :

“Ju falënderoj shumë që erdhët të më vizitoni. Sa të bukura që jeni, Allahu ju paska krijuar të gjithave shumë të bukura! Për çfarë keni dëshirë që t’ju flas?”

Njëra nga vajzat iu përgjigj me zë të ultë:

“E dashur Zylejha, një mësuesja jonë na ka folur për ju. Sa vjeçe keni qenë kur ju ka ndodhur aksidenti, si ia arritët ta përballoni? Si e keni gjetur çelësin e lumturisë?”

Zonja Zylejha i dha këtë përgjigje:

“Kur isha shtatëmbëdhjetë vjeçe pata një aksident, si rezultat i të cilit u paralizova nga qafa e poshtë. Nuk kam qejf të flas për këtë gjë, sepse mund t’u shkaktoj mërzë njerëzve të tjerë, pasi shkaktari i atij aksidenti ishte një fëmijë i vogël. Në fakt duhet të them që ai ishte mjeti, sepse sigurisht që ky ishte një caktim i Zotit!.. E ardhmja ime ishte e përcaktuar të ishte e tillë dhe që kjo të përmbushej dikush duhet të bëhej shkak, prandaj ai fëmijë i vogël nuk duhet të ndjejë faj!.. Sikur të mos ishte ai, do të ishte një njeri tjetër. Le të themi që ky ishte vetëm një aksident, për më tepër që unë nuk dua që dikush të mërzitet për fajin tim. Duhet ta kuptojmë që fati ynë është shkruar që përpara lindjes sonë. Çdo gjë që na ndodh është për të mirën tonë. Allahu donte që unë të qëndroja në këtë shtrat dhe unë jam e kënaqur nga kjo gjendje.

Unë deri në momentin e aksidentit kam qenë një myslimane që bëja përpjekje për të ndjekur rregullat e fesë sonë, por pas atij çasti lindi një

dashuri shumë e madhe mes meje dhe Allahut, jeta ime filloi të ishte më e bukur!..

Tetë vitet më të bukura të jetës sime i kalova në spital pa lëvizur. A është e mundur të qëndrosh në spital për tetë vjet? Vite që i kalova e shtrirë në një shtrat, pa lëvizur dhe me sytë që shihnin veç tavanin... Nuk mund të haja as ushqimet e mia të preferuara; duke qenë se rrija shtrirë gjatë gjithë kohës, asgjë nuk më kalonte në stomak.

Në qoftë se doni ta kuptoni më mirë gjendjen e teze Zylejhasë, kur të shkoni në shtëpi qëndroni shtrirë në një shtrat pa jastëk. Edhe nëse dërsitni nuk mund të fshiheni, edhe nëse doni të kruheni nuk mund ta bëni dot... Nuk është diçka e lehtë! Është e çuditshme, por Allahu nuk bëri asnjëherë që unë të thosha: ‘Pse unë jam këtu, pse më ndodhi mua?’ Allahu nuk lejoi që unë të ankoheja duke thënë: ‘Pse?!’ Nuk po i them këto fjalë që ju të ndjeni mëshirë për mua, por mendoj që duhet dikush të qëndrojë i shtrirë, në mënyrë që të tjerët ta marrin shembull dhe të jenë falënderues!

Duaja ime e përhershme ishte kjo:

‘O Allahu im, unë jam duke qëndruar e shtrirë; të lutem bëj që dikush të më shikojë dhe të jetë mirënjohës për gjendjen e vet!.. Unë nuk mund të bëj asgjë për Ty, por të paktën le të jem shkak që njerëzit e tjerë të falënderojnë Ty!’

Motra ime më thotë gjithmonë: “Gjatë gjithë jetës ti ke dhënë.” Ajo është një ndjenjë shumë e bukur, le të japim gjithmonë për hir të Allahut.

Si rezultat i këtij aksidenti, unë përfitova shumë gjëra pozitive. Një ditë doktori im i vendosi raftet e vogla njëra mbi tjetrën. E çuditur e pyeta:

“Çfarë po bëni?”

“Ti do të jesh mërëzitur shumë, prandaj po të vendos një televizion mbi këto raftet.”

Ai po e bënte atë gjë për të mirën time, që të kaloja kohën duke shikuar televizion.

“Nuk ka nevojë.”- i thashë. Me të vërtetë që nuk ishte aspak e nevojshme, sepse mua më mjaftonin pamjet që më afronte Zoti im. Në momentin kur i nënshtrohesh përcaktimit të Zotit, Ai ju ofron gjëra pa fund. Zylejhaja ishte gati të jepte gjithçka për të përfituar nga këto të mira. Sikur ju të ishit në vendit tim dhe të shikonit ato që shikoj unë, nuk do ta ndryshoni as botën me këtë bekim. Allahu bëri që unë të edukoj egon time. Kur isha në spital e besoja se isha bërë me të vërtetë një besimtare e devotshme. Kam qëndruar me sy që fiksonin tavanin me muaj të tërë. Njerëzit mendonin se unë isha vetëm duke shikuar tavanin. Po ju them me sinqeritetin më të madh se kur zemra e njeriut është bashkë me Zotin dhe e kalon gjithë jetën duke e kujtuar Atë; në një tavan të thjeshtë mund të shikohen gjëra nga më të bukurat që një njeri i



thjeshtë nuk është në gjendje as t'i imagjinojë. Ah sikur ta gjeja edhe një herë atë tavan...

Çfarë mësuam nga kjo ngjarje; mësuam që të bëjmë durim dhe na tregoi se sa vlerë kanë gjërat që fitojmë si dëmshtëpërlim i atyre që humbasim. Unë gjithashtu kuptova rëndësinë e madhe të duarve dhe të këmbëve.

Disa ditë më përpara një mysafire më tha:

“Ne kemi një shtëpi me pamje nga deti. Është shumë e bukur dhe kemi dëshirë që t’juja bëjmë dhuratë. Ajo është shtëpi goxha e madhe dhe mund të prisni më shumë njerëz!”

Unë thashë:

“Allahu im, çfarë po kërkon t’i thuash Zylejhasë? A mos do të thuash që tashmë nuk do të mund ta shikoj më Xhenetin? Prandaj dëshiron të më dhurosh mua një pamje me det? Unë nuk dua të ndahem nga Ti. Çfarë pune kam unë me detin? Unë të zgjedh Ty. Ti je Xheneti im, o Allah!”

Të gjitha mysafiret po e dëgjonin me sy të përbotur. Amina ishte emocionuar shumë. E dëgjonte dhe mendonte për gjendjen e saj; lotët i rrjedhin lumë. Donte të qante me zë të lartë por po përpiquej që ta zotëronte veten.

Një nga vajzat pyeti:

“Çfarë është Xheneti?”

Zonja Zylejha filloi t’i përgjigjej pyetjes dhe përsëri të gjithë po e dëgjonin me vëmendje:

“I kujt është Xheneti sipas jush? A e keni menduar se kush janë ata që mund të futen në Xhenet? A kemi të gjithë të drejtë që të futemi në Xhenet? Pse të marrim rrugën e Xhehenemit? Zoti ynë është shumë i mëshirshëm... Ai na ka dërguar një Libër të mrekullueshëm dhe na ka thënë që nëse i bëjmë disa gjëra dhe qëndrojmë larg disa gjërave të tjera, do të mund të futemi në Xhenet. Nuk është mjaftuar me kaq. Duke qenë se Allahu na do, ka dërguar dhe një shembull të gjallë të rregullave që duhen ndjekur... Na ka dërguar njeriun e Vet më të dashur. Ju këshilloj që të lexoni sa më shumë libra që flasin për jetën e Resulullahut. Në një libër unë kam lexuar këtë fjali: ‘Në jetën e Resulullahut ka pasur shumë luftëra.’ Për mendimin tim kjo nuk e përshkruan mirë jetën e Resulullahut. Një pjesë e vogël e jetës së tij ka kaluar në luftë kurse pjesa tjetër e saj i ka kaluar duke qenë afër ymetin të vet... Ai ka qenë njeriu bujar që ka ndihmuar këdo që ka pasur nevojë për ndihmë... Ai ka qenë njeriu më i lartë dhe njeriu më i dashur i Allahut... Si çdo epokë tjetër edhe koha e Resulullahut ka pasur luftërat e veta... Në çdo kohë ka pasur dhe do të ketë njerëz të mirë dhe të këqij... Përpjekjet dhe diskutimet mes këtyre dy grupeve do të jenë gjithmonë aktuale. Për më tepër që njeriu është në një luftë të vazhdueshme me egon e vet... Në qoftë

se dëshironi të jetoni si njerëz, duhet ta merrni si shembull Resulullahun në çdo aspekt!

Shembulli i Resulullahut është i përshtatshëm për të gjitha kohërat. Kur ndodhi Miraxhi, Pejgamberi ynë nuk bëri vetëm një udhëtim nga një vend në një tjetër; Ai bëri edhe një udhëtim në kohë... Ai i shikoi të gjitha kohërat... A mund ta mendoni madhështinë e kësaj? Të shikosh dhe të jetosh të gjitha kohërat, ato të kaluarat dhe ato që do të vijnë. Ai u takua me Allahun. Ne kemi një Pejgamber shumë të veçantë, qoftë falënderuar Allahu!

Kjo ishte ajo që më ka mbajtur në jetë! Do të gënjeja në qoftë se do të thosha që këto gjëra i kam lexuar nga librat, sepse unë nuk kisha duart që të mbaja librin... Sikur të më ndihmojë dikush, do të më bien syzet dhe do të kem shumë probleme të tjera prandaj është e vështirë. Unë nuk lexoj dot libra. Më mjaftojnë gjërat që m’i shfaq Allahu...

Çfarë pret Allahu përballë kësaj dhurate të madhe që na ka dhënë? A dëshiron Ai që të bëjmë përgatitje për Xhenet? A keni ndonjë mendim? Unë e kam shumë të vështirë që t’ju them që të falni namaz. Më duket sikur po ju fyej po t’ju them atë fjalë... Nuk mund t’ia them një gjë të tillë një njeriu besimtar që e dëgjon zërin e ezanit pesë herë në ditë!..

“Për kë këndon ezani?” A këndon për gjyshen dhe gjyshin tim?

Nuk ka asgjë më të keqe për një mysliman se mungesa e namazit në jetën e tij. Mendoni pak për gjërat me të cilën e harxhoni kohën tuaj para se të ankoheni se jeni shumë të zënë dhe nuk keni kohë...

Në qoftë se unë do të kërkoja diçka prej jush, diçka për të cilën kam shumë nevojë; a do të ma jepni? Në qoftë se ju them që më ka marr uria ose që kam etje; a do të më jepni ushqim apo ujë?

Duke thënë këto fjalë motër Zylejhaja qante me dënësë, lotët e saj i fshinte mësuesja Hatixhe, por dukej sikur nuk ia arrinte t’i fshinte të gjithë lotët e derdhura.

“Sikur t’ju them që kam nevojë për t’u larë a do të më ndihmoni? Po sikur t’ju kërkoja diçka për botën e përtejme? Sikur t’ju kërkoja t’i bënit këto gjëra pesë herë në ditë a do t’i bëni? Unë kam shumë nevojë për të reja si ju që të më ndihmojnë të shlyej mëkatet e mia... Ju do të dilni të fituara nga të gjitha këto, por do të shpërblehem edhe unë. A do të më ndihmoni që të shpërblehem? Unë e ndjej që ma dhatë fjalën. Lotët tuaja e tregojnë këtë gjë më së miri...”

Amina e kuptoi që edhe vajzat e tjera që po dëgjonin e falnin namazin ashtu si vetë ajo, pa përkushtimin e nevojshëm.

“Kam një kërkesë për vajzat që e falin namazin. A e dini cila është gjëja për të cilën ndjej më shumë mall? Më mungon sexhdja, më vjen shumë keq që tashmë nuk mund ta ul kokën për t’iu lutur Allahut... Vajza të dashura, në momentin kur koka juaj do të mbështetet në tokë a mund të thoni: ‘O Allah, le të jetë balli im, balli i motër Zylejhasë.’ A mund ta bëni për mua këtë gjë? Ju e keni shumë të lehtë që të arrini diçka që unë e kam të pamundur!.. Ju lutem mos e privoni veten nga kjo kënaqësi!, O Allah, të lutem më fal mua, sepse kjo nuk është ankesë por vetëm mall...”

Nuk kam mall për asgjë tjetër as për të ecur, as për të shëtitur, as për asgjë tjetër, unë ndjej vetëm mungesën e sexhdes.

Zonja Zylejha vazhdonte të qante pa pushim. Ajo fliste dhe nuk reshtte së derdhuri lot.

“Disa ditë më përpara shikova një ëndërr. Sa mirë që ekzistojnë ëndrrat, sepse nuk ka mënyrë tjetër për ta shikuar atë botë... Isha në një vend të cilit nuk mund t’i vendos asnjë përcaktim... Isha para Zotit tim. Shikojta nga ana e majtë dhe vëreja njerëz të njohur, hidhja sytë nga e djathta dhe shikimi im përsëri rastiste në njerëz të njohur... Kishte shumë njerëz dhe të gjithë së bashku ishim duke falur namaz. Mbizotëronte një qetësi e papërshkrueshme. A e keni parasysh lumturinë e faljes së namazit, edhe kjo ishte një ndjenjë e ngjashme. Mendoj se sikur ta perceptonim mirë se përpara kujt jemi duke qëndruar do të fitonim kënaqësi të pafund nga çdo namaz...”

Të gjitha vajzat e pranishme u zotuan se do të përmbushnin kërkesën e motrës Zylejha. Në dhomë mbizotëronte një atmosferë e veçantë dhe secila kishte humbur në një botë të re dhe të bukur.

Zonja Zylejha vazhdoi të fliste:

“Kemi qarë shumë, tani le të qeshim pak...”

Fjalët e saj ndërprejnë ngashërimet e vajzave të cilat filluan të buzëqeshnin. Njëra nga ato i tha:

“Motër e dashur, ne u kënaqëm shumë nga kjo vizitë, a mund të vijmë edhe herë të tjera?”

“Sigurisht, bijat e mia. Mund të vini sa herë që të keni dëshirë.”

Një vajzë tjetër i tha:

“E dashur motër, a mund të bëjmë një fotografi me ju?”

Vajzat u larguan duke marrë si kujtim një fotografi të asaj dite aq të bukur.

Zonja Zylejha iu drejtua Aminës:

“Bija ime, ke qarë shumë; cili është problemi yt?”

Kur dëgjoji këto fjalë, Amina nuk mundi t’u bënte më ballë lotëve që i kishin mbetur në grykë. Vetëm qante pa mundur që të ndalohej. Motra Zylejha i tha:

“Qaj bija ime. Loti është ilaç. Qaj bija ime, sepse loti është mëshirë. Loti është shpresa për falje. Loti është shërim.”

Zylejhaja e ndryshoi tonin e zërit dhe vazhdoi:

“Vajza ime e bukur... Në jetën e çdo njeriu ka momente në të cilat ndodhet në vështirësi të madhe. Shumica e njerëzve në një çast të vështirë zgjedhin rrugën më të lehtë: rebelimin ndaj Allahut... Këta njerëz nuk e kuptojnë se puna më me mend që mund të bëhet në këtë rast është nxjerrja e mësimeve prej fatkeqësisë. Me sa po shoh, ti je një njeri që ke pasur shumë përvoja të këqija në jetë. Mos ki frikë, sepse të gjitha këto do të zhduken, sepse në këtë jetë asgjë nuk është e pafund.

Pafundësia është diçka që i takon vetëm Allahut. Ti duhet të merakosesh vetëm për një gjë: mendo për mësimet dhe përvojat e mira që do të nxjerrësh nga fatkeqësia të cilën po e përjeton në këto momente!..”

Amina filloi të fliste me ndalesa:

“Motër Zylejha... Unë nuk shqetësohem për problemet e kësaj jete, un mërzitem për jetën time e cila po shkon bosh. E gjithë fëmijëria dhe rinia ime ka kaluar pa asnjë gjë të mirë. Kur shoqja ime më e mirë vdiq, unë u kujtova për vdekjen. Në atë moment unë u përballa me vërtetësinë e jetës. Në atë moment Allahu bëri të mundur takimin tim me motër Saxhiden. Ajo mbajti dorën time dhe më qëndroi pranë në çastet e mia më të vështira. Nuk pata nevojë të luftoja e vetme me problemet e mia. Nga njëra anë kisha familjen, shoqërinë dhe egon time që më ftonin në një rrugë të gabuar; nga ana tjetër kisha motër Saxhiden prej së cilës merrja forcë për t’i përballuar këto tundime. Në mësimet e saj gjeta trimëri dhe guxim. Tani Zoti më dha kënaqësinë që të njihem me ju. Nuk di se çfarë të them. Në qoftë se më jepni leje, dua të bëhem një nga shërbyeset tuaja.”

“Çfarë është ajo fjalë bija ime, si mund të bëhesh shërbyesja ime... Ti hajde për vizitë sa herë që të kesh dëshirë. Mund të qëndrosh këtu sa të duash, por nuk ke nevojë që të jesh shërbyesja ime, ti duhet të bëhesh shërbyesja e rrugës së drejtë. Në qoftë se vepron kështu, do të më lumturosh edhe mua.”





Fëmija dhe shoqëria

— Tuba Sokmen —

Miqtë tanë të vërtetë janë ata njerëz që vijnë të parët kur ne kemi nevojë... Ata janë pranë nesh kur qeshim edhe kur qajmë... Ata janë njerëzit për dashurinë e të cilëve jemi të bindur edhe kur janë larg nesh; edhe malli për ta është i bukur dhe i çmuar... Kur ua shtrijmë dorën për ndihmë, ata vijnë me vrap, pa prituri asgjë në këmbim... Jeta është më e bukur me ta; uji që pimë dhe buka që hamë janë më të ëmbla... Vetëm qenia e tyre na jep siguri...

Ndjenjat e bukura që kemi për miqtë tanë dhe themelet e miqësisë tanë kanë lëshuar rrënjë që në moshë të vogël... Kur nënat kanë qëndruar me gratë e lagjes për të biseduar, edhe fëmijët e tyre kanë zënë shoqëri me njëri-tjetrin. Duhet ta kuptojmë që të gjitha rregullat që zbatojmë sot me shoqërinë tonë i kanë themelet tek loja shtëpiash dhe tek lojërat me top. Ne kemi mësuar t'i duam dhe t'i respektojmë shokët tanë kur vrapojmë pas një topi në lagje. Duke komunikuar me miqtë tanë kemi mësuar se çfarë është: e drejta, e gabuara dhe të gjitha rregullat e tjera të jetës.

Miqësia e fëmijëve të sotëm është pak e ngatërruar... Sa keq që kushtet e jetesës dhe ambienti shoqëror ndryshojnë shumë shpejt. Në kohët e sotme familjet janë zvogëluar, kurse njerëzit largohen gjithmonë e më shumë nga njëri-tjetri. Njerëzit janë të detyruar të punojnë më shumë

dhe koha rrëshqet prej nesh ashtu siç ndodh me rërën kur e marrim në dorë. Në mes të kësaj jete aktive e kemi të vështirë të gjejmë kohë për miqtë tanë. Shumicën e kohës ne vetëm u telefonojmë kushërinjve dhe miqve tanë, në mënyrë që të mos harxhojmë kohë. Nuk e kuptojmë dot që në këtë mënyrë ne po i largojmë edhe fëmijët nga njëri-tjetri dhe nuk u japim atyre mundësi për të krijuar shoqëri të sigurt. Për fëmijët e sotëm argëtimi ka vetëm një kuptim: kompjuteri dhe televizioni... Edhe në ambientet e hapura, fëmijët preferojnë të luajnë me telefonat e prindërve, në vend që të vrapojnë pas njëri-tjetrit.

Duart e tyre të vogla dhe mendjet e tyre të pastra janë ndotur nga ekranet e mjeteve digjitale; këta fëmijë, që nuk e vëzhgojnë ambientin që i rrethon, kur të rriten si do të mund t'i kuptojnë ndjenjat e njerëzve? Si do ta kuptojnë gëzimin që të jep ndarja e gjërave me njerëzit e tjerë? Si do të mësojnë këta fëmijë: faljen, humbjen dhe fitoren? Fëmijë që nuk kanë eksperiencën e lojërave në grup, si do të mësojnë të bashkëpunojnë me kolegët e tyre në të ardhmen? Ndjenjat që u dhurohen nga lojërat në kompjuter a do të mund t'i përgatisin për jetën e vërtetë?

Mënyra e dëfrimit, miqësia e krijuar dhe lojërat janë ato që ndikojnë direkt në formimin e karakterit të një njeriu. Fatkeqësisht brezi i sotëm i



fëmijëve e kalon të gjithë fëmijërinë para ekranit të televizionit dhe nuk arrin të bëjë përgatitje për jetën e vërtetë. Një shkollim i mirë dhe ushqimi i mirë nuk janë të mjaftueshëm për edukimin e duhur të një fëmije!... Fëmija i cili nuk ka shokë me të cilët mund ta masë forcën e vet, nuk arrin ta kuptojë ndjenjën e suksesit. Një fëmijë të cilit i mjafton shtypja e një butoni për të filluar një lojë të re, nuk arrin ta mësojë as se çfarë është llastimi.

Për shkak të lojërave në kompjuter dhe zakonit të të shikuarit televizion, mësuesit në shkollë ankohen nga mungesa e vëmendjes së fëmijëve, kurse prindërit ankohen nga ndjenja e egoizmit që vihet re tek fëmijët.

Trupi i fëmijës, gjuha dhe mendja e tij zhvillohen njëllor si ndjenjat, që nga lindja e fëmijëve. Për të arritur një zhvillim të rregullt dhe të ekuilibruar është e rëndësishme që të krijohen ambiente të duhura për fëmijët. Për shembull: një fëmijë i moshës tre vjeçare është gati për të mësuar të ndajë lojërat e veta me fëmijët e tjerë; por në qoftë se atij nuk i krijohen mundësitë për të qëndruar me fëmijë të tjerë do të vihet re një vonesë në mësimin e këtij veprimi. Të gjitha reflekset duhet të mësohen në një mënyrë zinxhir, vonesa në të mësuarit e njëres prej tyre bën që të lindin probleme.

Tek fëmijët të cilëve u krijohet një ambient shoqëror, vihet re perceptimi i shpejtë i ndjenjave miqësore. Fëmijët e vegjël janë të prirë për të zgjedhur shokë të së njëjtës moshë dhe me të cilët mund të luajnë të njëjtat lojëra. Në një farë mënyre

fëmijët mësohen që të bëjnë gjëra të dobishme për jetën e tyre. Me kalimin e viteve fëmijët fillojnë që të ndryshojnë kriteret në zgjedhjen e shokëve; fillojnë të fitojnë rëndësi vlera si: besnikëria, drejtësia, mirëkuptimi dhe besimi. Fëmija i kërkon këto vlera tek shokët e tij dhe mundohet që t'i ndreqë anët e këqija të shokëve të vet. Në këtë mënyrë, kjo miqësi e krijuar në bazë të dobive reciproke fillon të bëhet më e thellë dhe kompakte. Fëmijët që nuk krijojnë shoqëri në moshën e fëmijërisë janë të prirë që në moshë madhore të mundohen që t'i krijojnë shoqëritë në bazë interesi; prandaj nuk arrijnë që të krijojnë shoqëri të qëndrueshme.

Për çdo grupmoshë ekzistojnë probleme të caktuara. Fëmija ka nevojë që këto probleme t'i zgjidhë vetë, sepse kjo do ta ndihmojë shumë në jetën e vet në të ardhmen dhe do të ndihmojë zhvillimin e fëmijës. Mos të harrojmë se fëmijët diskutojnë shumë shpesh me njëri-tjetrin, por nga ana tjetër ata pajtohen shumë shpejt. Prindërit duhet t'i trajtojnë me maturi këto gjëra dhe t'i ndihmojnë fëmijët që të gjejnë rrugëdalje; një mënyrë e tillë e të vepruarit do të ndihmojë në zhvillimin e fëmijës.

Sado që nëna dhe babai të jenë njerëz të mrekullueshëm, ata nuk mund ta zënë kurrë vendin e shokëve të një fëmije dhe nuk do të mund ta ndihmojnë fëmijën që të fitojë gjërat që fiton nga shoqëria. Le të bëjmë sa më shumë dua që fëmijët tanë të krijojnë shoqëri me njerëz të mirë që do t'i ndihmojnë ta rrisin cilësinë e jetës dhe le të krijojmë kushtet që fëmijët tonë të rriten në një ambient të shëndetshëm.



9 USHQIME

kundëralergjike

Lehtësoni simptomat dhe pakësoni sulmet e alergjisë duke shtuar në dietën tuaj këto ushqime.

SHAFRANI I INDISË

Shafrani i Indisë njihet për përmbajtjen e lartë në antioksidues dhe antiinflamator. Shtimi i një lugë çaji pluhur të shafranit të Indisë në çajin ose gatim mund t'ju ndihmojë ndaj reaksionit të alergjisë. Konsultohuni me një doktor për të marrë suplemente të shafranit të Indisë.

MOLLA

Forconi sistemin imunitar me konsumimin e një molle në ditë. Molla përmban flavonoide që mbrojnë trupin nga alergjenët dhe limitojnë prodhimin e histaminës. Shtoni në omëletën tuaj copëza molle, ose merrni me vete një mollë për konsumim të shpejtë të saj.

HU DHRA

Një tjetër ushqim i pasur me oksidantë, antiinflamator dhe vetitë antibiotike. Hudhra mund të ndalojë reagimin alergjik dhe pezmatimin në trup. Konsumoni një thelb hudhër në mëngjes për të luftuar

alergjitë dhe për të shtuar energjitë.

LIMONI

Limoni është i pasur me vitaminën C, e cila ndihmon në sistemin imunitar. Limoni është ideal për luftimin e alergjisë për shkak të përmbajtjes në vitaminë C dhe antioksidues. Shtoni në gotën me ujë pak limon për detoksifikimin e trupit dhe për përmirësimin e sistemit tretës.

ÇAJI JESHIL

Kur flasim për çajin jeshil, ka një listë të madhe me përfitime për shëndetin. Përmirëson sistemin imunitar, ndihmon me metabolizmin, detoksifikon trupin dhe parandalon reaksionet alergjike. Konsumimi i çajit jeshil çdo ditë ndihmon në parandalimin e reaksionit alergjik, për ta forcuar efektin e saj shtoni limon ose mjaltë në çaj.

SALMONI


Salmoni është një nga ushqimet me burimin më të lartë të acideve yndyrore omega 3. Omega 3 lufton inflamacionin dhe lehtëson simptomat e alergjisë. Salmoni përmirëson funksionin e mushkërive. Kjo është shumë e mirë për të gjithë ata që vuajnë nga astma ose i ftohti. Konsumoni të paktën 2 racione salmon ose çdo produkt të peshkut të pasur me omega 3 për një javë.

PATATJA E ËMBËL

Patatja e ëmbël përmban kalium, vitaminë B6, magnez dhe beta karoten. Këto lëndë ushqyese ulin inflamacionin dhe lehtësojnë simptomat e alergjisë. Konsumimi i gjysmës së patates së ëmbël rregullisht ndikon në përmirësimin e sistemit të imunitetit dhe ndalon krizat e alergjisë.

XHENXHEFIL

Xhenxhefili përmban shumë vlera për



shëndetin, ai përmirëson sistemin tretës dhe balancon nivelin e pehashit. Ai mund të veprojë dhe si një antialergjik. Ndalon formimin e mukozës dhe parandalon bllokimin e hundëve. Pini çaj xhenxhefil për të parandaluar alergjitë.

FARAT E LIRIT

Farat e lirit janë të pasura me omega 3 dhe selen, të cilat janë të njohura për parandalimin e reaksioneve alergjike. Shtoni sallatës ose kosit një lugë gjelle fara liri.

LËNGU I GJELBËR

për pastrimin e gjakut dhe gjithë organizmit

Ushqimet dhe pijet e gjelbra janë shumë (dhe nuk e nënvizojmë dot mjaftueshëm) të rëndësishëm dhe ushqyes për shëndetin e organizmit.

Ardhja e pranverës shoqërohet me rreshta shumëngjyrëshe në tezgat e fshatarëve, të cilat janë të mbushura plot me barishte, fruta e perime.

Ndër barishtet më të mira për shëndetin është padyshim pazia.

Vlerat shëndetësore të pazisë janë me të vërtetë të shkëlqyera.

Në to përfshihet aftësia për të rregulluar nivelet e sheqerit në gjak, parandaluar radikalet e lira, për-

mirësuar tretjen, forcuar sistemin imunitar, për të ulur temperaturën dhe luftuar inflamacionin.

Kjo barishte është e shkëlqyer për uljen e tensionit të gjakut, parandaluar sëmundjet e zemrës, rritur dendësinë kockore, detoksifikuar organizmin dhe forcuar shëndetin e trurit.

Pazia është një burim fantastik vitaminash, ushqyesish dhe përbërësish organikë që përfshijnë vitaminën K, C, A, E, riboflavinën dhe vitaminën B6.

Sa i përket mineraleve, ajo përmban magnez, mangan, kalium, hekur, natrium dhe bakër.

Përveç fibrës dietike, pazia përmban edhe antioksidantë, fitonutrientë dhe enzima të cilat janë unike dhe shumë të mira për shëndetin.

Konsumi i rregullt i pazisë mund të duket sikur kërkon shumë fantazi në kuzhinë, por nuk është aspak e vërtetë.

Pazia mund të kombinohet shumë mirë me luleradhiqen, majdanozin, selinonë, mollën, kastravecën e shumë të tjera për marrjen e një lëngu të shkëlqyer për trupin dhe trurin.

SI TË PËRGATISNI LËNGUN E PAZISË, MAJDANOZIT DHE LULERRADHIQES.

Për këtë çaj ju nevojiten:

2-3 gjethe pazi,

Një grusht me luleradhiqe,

Një tufë e vogël majdanoz,

4-5 kërcenj selinoje,

1 kastravec,

1 mollë jeshile,

Gjysëm limoni

Një copë e vogël xhenxhefil.

PËRGATITJA E LËNGUT

Për përgatitjen e këtij lëngu, ekspertët rekomandojnë që në shtrydhëse të fusni barishtet dhe erëzat të para e më pas frutat dhe perimet më të forta.

Lëngu duhet pirë menjëherë sa është i freskët.

Ai është shumë i shëndetshëm, sidomos në kohë virozash.

Ky lëng i jep fuqi imunitetit, përmirëson çarkullimin e gjakut, mbron rrugët e frymëmarrjes dhe për më tepër përmirëson ndjeshëm tretjen.

Mund ta konsumoni disa herë në javë.



GRAPHENE

GRAFINA

NJË MATERIAL I RI ME AFTËSI TË RRALLA

Me trashësinë e një atomi, grafina është një prej atyre materialeve të çuditshme që thuhet se do të ndryshojnë të ardhmen. Shkencëtarët thonë se aktualisht e ardhmja mund të ketë mbërritur pasi mundësitë që ofron materiali i quajtur grafinë po vlerësohen si mjaft të rëndësishme për rrjetet e shpejta dhe efikase 5G dhe për të ardhmen e telekomunikacionit në përgjithësi.

Kjo thurje gjashtëkëndëshe e formuar nga atomet e karbonit quhet grafinë dhe ka trashësinë e një atomi, por është më e fortë se çeliku. Është përçues i elektricitetit, efikas për nxehtësinë dhe po vlerësohet për vetitë e rralla që ka.

Kostya Novoselov, fitues i Çmimit Nobël për punën e tij me grafënë, thotë se telekomunikacioni mund të jetë një fushë e mirë përdorimi pasi materiali është tërësisht transparent dhe mund të transmetojë të dhëna me shpejtësi të madhe nëpërmjet qarqeve elektrike dhe me shumë efikasitet.

“Ajo mundëson dërgimin e përpunimit të sinjalit në qendrat optike. Përveç grafines nuk besoj se ka materiale të tjera që mund ta bëjnë këtë. Pra realizon dërgimin e sinjalit me të njëjtën shpejtësi. Përdorimi në telekomunikacion është ndoshta më i miri dhe njëkohësisht më i realizueshmi”, thotë Novoselov.

Materiali i lehtë mund të përdoret në çdo fushë

që nga këpucët, rrobat dhe makinat duke i bërë ato më rezistente, të përkulshme dhe inteligjente.

Aftësia e grafines për të përçuar të dhëna me shpejtësi do të bëjë të mundur edhe rrjetet shumë të shpejta 5G që duken në horizont.

“Fillimisht u përdor si përbërës në produktet sportive. Tani po integrohet tek makinat e avancuara dhe aktualisht po shohim se po përdoret edhe për produktet elektronike. Mendoj se po zhvillohet me një ritëm të mirë si përbërës për materiale të reja”, është shprehur fituesi i Çmimit Nobël Kostya Novoselov.

Ky material po e bën të mundur që edhe panelet diellore të jenë më efikase dhe po ndihmon në përparimin e elektronikës inteligjente. Por edhe vetë njeriu mund të përfitojë nga ky material, *materiali mund të ketë përdorim në fushën bioteknologjike apo në membrana. Por kërkohet më shumë kohë që idetë të materializohen.*

Qarqet elektronike me këtë material janë aq të mira dhe të shpejta sa që një sondë e hollë sa një atom mund të lexojë dhe masë aktivitetet e trurit të një pacienti dhe mund të dërgojë të dhënat tek mjeku apo t'i transmetojë ato në telefon në rast emergjence.

TË SHPËTOJMË BLETËT



Një nga problemet e vazhdueshme dhe më shqetësuese në bujqësinë moderne si në Shqipëri, ashtu edhe në botë është përdorimi i pesticideve, të lejuara ose jo, për të mbrojtur të mbjellat nga insektet apo dëmtimet. Ekspertët thonë se përdorimi i tepërt i këtyre pesticideve nuk dëmton vetëm tokën dhe ujin, por gjithashtu vret shumë nga organizmat e dobishëm prej të cilave varet edhe cilësia e të mbjellave. Një ekip studiuesish Evropianë ka zbuluar se pesticidet luajnë një rol kryesor, në mos më të rëndësishmin në zhdukjen e bletëve, duke hedhur kështu dritë në misterin e vdekjes së kolonive të kësaj specije që ndihmon ekzistencën e njeriut prej mijëra vitesh. Sipas ekspertëve shumë prej bletëve të vdekura së fundmi janë helmuar nga doza vdekjeprurëse të shumë pesticideve të rrezikshme, çka përbën një hap shumë të rëndësishëm për përpjekjet për t'i dhënë fund këtij fenomeni. Nëse dihet shkaku, gjendet dhe zgjidhja. Studimi i publikuar në Journal of Chromatography rrëfen se shkencëtarët kanë zbuluar se bletët po helmohen në mënyrë të frikshme nga pesticidet e përdorura nga njeriu. Shkencëtarët analizuan një kampion mostrash me 74 bletë të helmuara. Në bletët e vdekura u gjetën gjurmët e 57 pesticideve, madje shumë prej të cilave të lejuara për përdorim në Bashkimin Europian, siç janë chlorpyrifos në 38 raste dhe dimethoate në 30 raste. Ndërkohë gjurmët e pesticideve të tjera si klotianidina, në grupin e neonicotinoideve, të ndaluara në Bashkimin Europian u gjetën në 22 bletë të helmuara nga i njëjti kampion i analizuar. Edhe në nivele të ulëta, pesticidet dobësojnë sistemin mbrojtës të bletëve, duke lejuar parazitë dhe viruse të ndryshëm të infektojnë koloni të tëra. Një raport i Njësisë së Kombeve të Bashkuara për Shkencën, Biodiversitetin dhe Ekosistemin ka dhënë alarmin se aktivitetet e njeriut po shtojnë drejt zhdukjes mbi 40% të specieve të ndryshme përfshirë bletët, duke vënë në rrezik mbi 75% të furnizimit të botës me ushqim. Lajmi mbi rrezikun në rritje të pesticideve tek bletët është shumë i rëndësishëm në identifikimin e pesticideve dhe kimikateve të veçanta që po shtojnë bletët drejt kolapsit. Nivelet e kolapsit të kolonive të bletëve ka arritur në mbi 30% në Evropë dhe mbi 40% në Shtetet e Bashkuara. Një grup ekspertësh nga Departamenti Amerikan i Bujqësisë ka konfirmuar, në fakt, atë që bletarët kanë thënë prej vitesh: Edhe kur përdoren sipas ligjit, pesticidet e përdorura më gjerësisht në botë janë mjaft toksike për bletët. Studimet konfirmojnë luftën e vazhdueshme ndaj grupit të insekticideve quajtur neonicotinoide, të cilat janë klasifikuar shpesh si një nga shkaqet e vdekjes së bletëve dhe insekteve të tjera pjalmuese. Një tip insekticidi i quajtur klotianidina, është përdorur shumë për të mbrojtur misrin dhe

sojën në SHBA. Fermerët e përdorin atë duke e futur në tokë, si një parandalues për të mbrojtur farat nga insektet. Por kur bima rritet, toksina rritet bashkë me të, duke e bërë të gjithë bimën helmuese. Shqetësuese mbetet situata në Shqipëri ku përdorimi i insekticideve sidomos vitet e fundit ka shfarosur një përqindje mjaft të lartë të kolonive të bletëve ekzistuese. AgroWeb.org pyeti 5 bletërritës në zona të ndryshme gjeografike të Shqipërisë dhe të gjithë kanë vërejtur humbje të vazhdueshme vit pas viti të numrit të bletëve dhe zvogëlimi i sasisë së bletëve është kthyer në një situatë të zakonshme dhe shumë problematike për bletërritësit.

Shtatë produktet që do të zhdukeshin si pasojë e vdekjes së bletëve:

1. Mjalti. Është një antioksidant mjaft i shijshëm, anti bakterial dhe kurues për shumë probleme shëndetësore. Por nëse bletët do të zhdukeshin do na duhej t'i themi lamtumirë mjaltit.

2. Ilaçet. Shumë prej vitaminave apo ilaçeve që përdorim për azmën apo edhe për ulur temperaturën apo kundër pagjumësisë, kanë në përbërjen e tyre një material të prodhuar ekskluzivisht nga bletët.

3. Djathi, është pjesë e rëndësishme e tryezave tona. Por a e dini se shumë prej djathërave të preferuar të njerëzimit varen shumë nga dylli i bletës? Me zhdukjen e bletëve ikën edhe kosi si edhe 50% e nënprodukteve të qumështit.

4. Frutat janë të rëndësishme për dietën tonë ushqimore. Ato janë të pasura me vitamina dhe vlera shëndetësore, por boronica, rrushi, pjeshkët, kumbullat, limonët, mandarinat, stafidhet dhe boronicat e kuqe janë të gjitha në varësi totale të pllenimit të bletëve.

5. Kafeja. Bletët janë shumë të rëndësishme në prodhimin e kafes. Lulet e kafes prodhojnë nektar të ëmbël të një cilësie shumë të lartë dhe procesi i pllenimit të kafes e rrit cilësinë e saj. Nëse nuk ka bletë, nuk ka as kafe!

6. Lulet. Ju pëlqen t'ju dhurojnë lule? Epo silluni mirë me bletët sepse ato ndihmojnë lulet të përfuldojnë me sukses procesin e fertilizimit që është i nevojshëm për çeljen e tyre.

7. Veshjet e pambukut. Të gjithë e dimë rëndësinë e veshjeve, fundja nuk mund të dalim nga shtëpia pa rroba. Por nëse bletët zhduken, thuajti lamtumirë veshjeve të pambukut, sepse bletët janë shumë të rëndësishme për pjalmimin e bimës së pambukut.



“Muaji i Ramazanit
është ai, në të cilin
ka zbritur Kurani,
që është udhërrëfyes
për njerëzit,
plot me shenja të qarta
për rrugën e drejtë
dhe dallues
(i së mirës nga e keqja)...”

(Bekare, 185)